

Mevlana Xhelaledin Rumi (1207-1273)

A Jeni Hutuar?

Mevlana dhe Batuta

Verbërimi Shpirtëror

Tolerance dhe e Drejta Fetare

Komentimi i Sures "Tekathur"

Dashuria ndaj Pjesëtarëve të Families Profetike (Ehl-i Beyt)

MEVLANA
dhe TOLERANCA

Viti: II Numri: 8

Korrik-Gusht-Shtator 2007

Xhumadul Uhra-Rexhep-Shaban 1428

Boton

PROGRESI SH.p.k.

Shkodër / Shqipëri

Përkthyes:

Ermal Nurja

Ali Bardhi

Artur Tagani

Alban Kali

Adem Pizga

Evans Drishti

Zymer Ramadani

Naim Drijaj

Redaktorë gjuhësor-letrar:

Ermira Alija

Brikena Smajli

Gentijana Dizdari

Diana Bilali

Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi

Shkodër

Tel: (+355) 0692076768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Dizenjo - Grafik:

Ali KAYA

Bledar XAMA

Ngjyra: World Graphics

Tel: +90 216 326 22 14

Adresa e përfaqësisë në Kosovë:

SH. E. A. VËSHTRIMI

Tel: +377 44 368 925

Për artikuj:

e-mail: etika@revistaetika.com

editor@revistaetika.com

reklam@revistaetika.com

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

Të dashur lexues...

Këtë numër të revistës Etika kemi vendosur që t'ia kushtojmë personalitetit të lartë mistik Mevlana Xhelaledin Rumiut (1207-1273) dhe mesazheve të thella të përshtirshme që ai i la trashëgimi botës së mendimit islam. Ky vit është caktuar edhe nga UNESCO-ja si viti i Mevlanasë, me rastin e 800 vjetorit të ditëlindjes së tij. Ndërsa perëndimi sheh tek ky personalitet dimensionet e thella të tolerancës dhe mirëkuptimit, dëshira jonë është që nëpërmjet artikujve të këtij numri të nënvizojmë faktin se ato dimensione kanë një mbështetje solide tek fryma e mësimave Kur'anore dhe traditës Profetike. Do të dëshironim që me këtë rast në faqen e editorialit të ndanim sëbashku me lexuesin tonë rreshtat e kartës së shkruar prej njërit nga figurat më të rëndësishme të mendimit akademik islam Prof. Dr. Muhammed Hamidullahut:

"Mënyra se si jam rritur dhe përgatitur unë është racionale. Kërkimet dhe studimet juridike m'i kanë hedhur poshtë të gjitha gjërat e papërshtirshme e të pavërtetuara në mënyrë bindëse. Pa dyshim, unë i kryej detyrat islame si namazi, agjërimi, etj., jo për shkaqe mistike, por juridike.

Dhe them me vete:

"Allahu është Zoti im, është Zotëria im. Ai më ka urdhëruar për t'i kryer këto. Pra, më duhet t'i kryej. Veç kësaj, të drejtat dhe detyrat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Allahu m'i ka urdhëruar këto me qëllim që të përfitoj prej tyre. Atëherë, unë e kam për detyrë që ta falënderoj Atë!"

Qysh nga koha kur fillova të jetoj në shoqërinë perëndimore, në një mjedis të tillë si Parisi, nisa të shoh me habi se ajo që i shtyn të krishterët ta pranojnë Islamin, nuk janë diskutimet e dijetarëve të fikhut dhe të kelimave, por mistikë të tillë si Ibn Arabiu dhe Mevlanai. Mbi këtë çështje, edhe unë formova përvojën time personale. Kur më kërkohet shpjegimi i një çështjeje islame, përgjigjja ime e mbështetur në argumente racionale, domethënë, në arsyen, nuk e kënaqte personin që bënte pyetjen, kurse shpjegimi mistik nuk vononte të jepte fryt. Kështu, me kohë, unë e humba forcën ndikuese dhe tani besoj që të paktën në Europë dhe Afrikë, ajo që do t'i shërbejë Islamit nuk është arsyeja, as shpata, por zemra, domethënë, tasavvufi!

Pas kësaj përvoje fillova të studioj disa vepra të shkruara mbi tasavvufin. Kjo ma hapi syrin e zemrës. Dhe e kuptova se tasavvufi dhe rruga e mistikëve të mëdhenj islamë në kohën e Profetit (a.s.) që jo marrja me fjalë dhe as preokupimi me gjëra të pakuptimta, por ecja në rrugën më të shkurtër që shkon nga njeriu te Zoti, kërkimi i rrugës së zhvillimit të personalitetit.

Njeriu kërkon shkaqet e detyrave që i ngarkohen. Shpjegimet materiale në fushën shpirtërore na largojnë ne nga synimi; vetëm shpjegimet moralo-shpirtërore janë ato që e kënaqin njeriun!"

Në këtë numër do të lexoni:

Verbërimi shpirtëror Ali Riza TEMEL	3
Dielli i jetës, durimi Prof. Dr. Jashar KANDEMIR	6
Muslimani i mirë Ahmet Tashgetiren	8
Llogaria dyzetvjeçare Zymer RAMADANI	11
A jeni hutuar? Prof. Dr. Ismanil Lutfi ÇAKAN	14
Dashuri pa e parë kurrë Nexhmije Robaj	16
Të takohesh me profetët Aisa KOKICI	17
Toleranca dhe e drejta fetare Zymer RAMADANI	20
Tasavvuf do të thotë të jetosh në gjurmët e Profetit (a.s.) Naim DRIJAJ	22
Prezantim i librit "Mistika Islame" Ali Bardhi	25
Toleranca dhe dialogu ndërnjerëzor e ndërfetar në mësimet Islame Mr. Xhabir HAMITI	27
Dashuria ndaj pjesëtarëve të Familjes Profetike (Ehl-i bejt) Osman Nuri TOPBASH	31
Mevlana Xhelaledin Rumi (1207-1273) Ilda CANJA	39
Mevlana, udhërrëfyesi i dashurisë Rabia Christine BRODBECK	41
Udhëtim me Mevlananë për në thellësitë e Kur'anit Arben Adem PIZGA	44
Mevlana dhe batuta Fatmir Sulaj	46
E rëndësishme është dashuria dhe zemërgjerësia A. Yasin DEMIRCI	50
Komentimi i sures Tekathur Mr. Gëzim DUNGAJ	51
E pamposhtura Havva binti Zejd Elvira PUKA	53
Medreseja e Madhe e Gjakovës në 300 vjetorin e saj Pleurat ef. Krasniqi	54
Shëndeti & Familja Naim Drijaj	57
Shkrimet otomane Ermal Nurja	59
Aktualitet Arjan Ymeraj	61
Teknologji Ali Bardhi	63




11



14



27



46



57



VERBERIMI SHPIRTEROR

Ali Riza TEMEL

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë që të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë?”

Në të vërtetë, sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharorë.” {Sureja Haxhah, 46}

Natyrisht, feja isame ua lehtëson përgjegjësitë atyre që kanë lindur të verbër, apo që e kanë humbur shikimin si pasojë e ndonjë ngjarjeje të mëvonshme. Lutjet dhe rënkimet e tyre mbërrijnë shpejt në Fronin Hyjnor. Duhet kushtuar shumë kujdes që të mos i mërzisim ata. Një vrenjtje e vetullave apo e fytyrës kundrejt tyre, sjell një qortim hyjnor, pa le të torturohen ata. Ndërkohë që Profeti (s.a.s.) po u fliste disa mushrikëve mekas, vjen sahabi i verbër **Abdullah bin**

Ummu Mektumi dhe i thotë: “Udhëzomë!”.

Nëse do bëjnë durim ata që Allahu i ka sprovuar me verbërinë, kjo për shkak që t’u bëhen shembull atyre që nuk e kanë një problem të tillë, të verbërve do u dhurohen shpërblime të mëdha. Lidhur me këtë, Profeti ynë (s.a.s.) duke përcjellë fjalët e Zotit të Lartmadhërishëm, thotë kështu: “*Duke ia marrë dy të dashurit e tij (sytë), e sprovvoj robin tim. Nëse ai bën durim, si shpërblim të dy syve Unë i dhuroj xhennetin.*” [Rijadu’s-salihin, nr. i hadithit: 34]

Verbërimi që nuk fiton mëshirën, por zemërimin, është **verbërimi shpirtëror**. Për shkak se nuk është Allahu ai që e ka verbëruar shpirtin. Ne e dimë që secili është krijuar me vetinë e të kuptuarit, shikuarit dhe besuarit

shpirtërisht. **Vulosja e zemrave** është pasojë e atyre shpirtërave që janë errësuar me gjynahe duke e pasur potencialin për t’i njohur të vërtetat.

Ja si shpjegohet në Kur’an kjo e vërtetë:

“**Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që i punuan, zemrat e tyre ua mbuluan.**” {Sureja Mutaffifin, 14}

Verbërimi që i bën njeriu zemrës së tij, është sikur të fikë dritën që ndriçon rrugën e tij. Mohuesi është ai që fik dritën në errësirë. Në fakt, edhe vetë fjala “kafir” (shqip: “mohues”) e ka kuptimin të errësosh, të mbulosh. I vetmi i verbër që s’ka shpëtim është mohuesi, sepse ai e zgjedh me dëshirë dhe me insistim mohimin, verbërimin si një urith, si një mi që zgjedh

errësirën, si një lakuriq nate që shqetësohet nga ndriçimi.

I shpall pra, luftë dritës. Allahu duke sjellë profetë dhe libra hyjnorë, dëshiron t'i nxjerrë nga errësira e mohimit në dritën e besimit robtë e tij. Kurse ata për shkak se janë të verbër, në vend të udhëzimit, zgjedhin humbjen. Është e pamundur të ndreqen ata. "E as që mund t'i largosh të verbërit shpirtërisht nga humbja e tyre" {Sureja Neml, 81} **Ka prej tyre që të shikojnë ty. A mund ta udhëzosh ti të verbërin, kur ata nuk shohin të vërtetën?** {Sureja Junus, 43}

Verbërimi më i frikshëm, është i atij që nuk dëshiron të shikojë. Hz. Muhammedin (s.a.s.) e panë si Ebu Xhehli ashtu edhe Hz. Ebu Bekri. Mirëpo Hz. Ebu Bekri duke e parë syrin e zemrës, u bë **Siddik**, ndërsa Ebu Xhehli ngaqë fiku dritën që kishte në zemër, u bë **zindik** (ateist).

Janë disa faktorë që ia verbojnë njeriut syrin e zemrës; më kryesorët janë: smira, urrejtja, dashuria e tepruar, etj.

Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë: "**Të dashurosh diçka tepër, të verbon**". E njëjtë është edhe urrejtja e tepruar. Ashtu sikur thotë edhe Imam Gazaliu, njeriu ekzagjeron në dy gjëra: **Kur dashuron dikë, syri nuk i sheh ndonjë defekt tek ajo dhe kur nuk e**



dashuron atë, syri i tij nuk sheh ndonjë gjë të vlefshme tek ajo.

Gjithashtu edhe mburrja, mendjemadhësia, pasuria, fama dhe epshi janë shkaktarë të verbimit shpirtëror. Hija e mendjemadhësisë mbulon sipërfaqen e së vërtetës. Dëshirat e tepërta u vënë perde syve. Ashtu siç thotë dhe Mevlanai, njeriu nuk dehet vetëm me raki e me verë, të gjitha ndjenjat e shpirtit lidhin sytë e veshët. Dehja e verës kalon për një kohë të shkurtër. Mirëpo dehja dhe verbërimi që të shkakton **gafleti** dhe epshi vazhdon gjatë tërë jetës. Syri i njerëzve të tillë u hapet në momentin e vdek-

jes ku i thuhet: "**Ti ishe në një huti nga kjo (ditë) e Ne ta tërhoqëm perdën tënde dhe tash ti sheh shumë mprehtë.**" {Sureja Kaf, 22} Pasi të hiqet perdja e gajbit, shikimi nuk ka aspak dobi. Të pranosh atë që është e dukshme nuk quhet besim. Të pranosh gajbin me syrin e zemrës është besim. Në krye të sures Bekara kur përkufizohen të devotshmit, u thuhet: "**besojnë në gajb**". Gajbi mund të shihet vetëm me anë të syrit të zemrës.

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, çdo zemër që nga krijimi e ka aftësinë që ta reflektojë ndriçimin si një pasqyrë e shndritshme. Aftësia për të besuar është

e fshehur në zemra, si zjarri që është i fshehur në gurin e çakmakut. Mirëpo është një vjedhës që ia ka fikur dritën në zemër mohuesit. Këtë vjedhës Mevlana me një alegori të bukur e shpjegon kështu:

“Një njeri natën dëgjoi ca hapa..Mori çakmakun në dorë për të ndezur dritën. Ndërkohë vjen edhe vjedhësi dhe ulet përballë të zotit të shtëpisë. Sa herë që i zoti i shtëpisë e ndizte çakmakun, vjedhësi ia fikte. Vjedhësi e shtypte sipër çakmakun që të fikej, kurse i zoti i shtëpisë mendonte se çakmaku fikej vetë, nuk e shihte vjedhësin.”

Me siguri është lagur ky çakmak që sapo e ndez fiket, – mendonte i zoti i shtëpisë -, ngaqë ishte errësirë e plotë dhe nuk e shihte vjedhësin që i qëndronte përballë e që ia fikte çakmakun. Edhe në zemrën e atij që mohon të vërtetën, gjendet një fikës i dritës, por ngaqë është i verbër nuk e vëren. Një zemër që di, që dëgjon, si mundet vallë të mos e dijë se, nëse ka diçka që lëviz është dikush që e ka lëvizur atë? Si mundet vallë që nuk thua “si shkon e si vjen nata me ditën pa pasur një pronar të tyrin?”

O i mjerë, sillesh rreth e qark gjërave që i arrin mendja, pa eja e vështro një herë edhe këto gjëra të pakapshme nga mendja jote. Pa më thua, a është më logjike të pranosh se shtëpia ka një ndërtues, një mjeshtër, apo të mendosh se shtëpia është bërë pa ndërtues e pa mjeshtër? Një

vepër artistike është rezultat i një njeriu të verbër e të paaftë, apo i një njeriu që shikon, që është profesionist e që ka ndjenja? Kjo botë është një kurth. Dëshirat tona janë si ushqimi që vendoset në kurth.

Ai që sheh me smirë nuk mund të shoh të vërtetën. Njerëzit shohin andej nga i drejtojnë dëshirat dhe epshet, kërkojnë atë që duan të shohin. Shumherë nuk e gjejnë atë që kërkojnë. Edhe në e e gjejnë, e humbasin sado vonë. Ah sikur të kërkonin gjëra që nuk i humbasin! Ah sikur të shihnin drejt Atij që i ka dhënë sytë! Ah sikur të ecnin drejt Atij që i ka dhënë këmbët!

Të gjithë janë zhytur në imagjinatë dhe janë bërë pre të imagjinatës. Me shpresën për të gjetur gur të çmueshëm, rrënojnë vend e pa vend. Por në fakt, thesari është brenda tyre. Me vrapimin e tyre jashtë, gjithnjë largohen nga gjallesa e vërtetë e nga personaliteti i tyre. Ata që e kanë të mbyllur dritaren e zemrës, as nuk shohin të tjerët e as veten e tyre. Sa e sa të marrë, pa bastun në dorë e pa pasur udhërrëfyes, si të verbër duke vrapuar ranë në kurthin e botës. Vlera e njeriut matet me atë që ka vënë si objektiv për të kërkuar. Atë që ka humbur brenda është marrëzi ta kërkosh jashtë.”

Ashtu siç thotë dhe Mevlana, “ Pse vrapon pas botës si i marrosur, ajo që kërkon nuk gjendet jashtë vetes tënde. Një çezmë brenda shtëpisë

tënde është më e mirë se lumi që ndodhet jashtë. E dashura i ka ardhur në shtëpi dhe i zoti i shtëpisë e kërkon atë jashtë si i çmendur.

Kur syri i zemrës është i verbër, atëherë çdo gjë bëhet errësirë. Edisoni madje, që ka zbuluar elektrikun, thotë se elektrikun kryesor prodhohet në tribunën e shpirtit. Atij që nuk është ndriçuar brenda, edhe nëse të verbon ndriçimi i jashtëm i tij, s’ka dobi. Njeriu edhe nëse është brenda në ujë, nëse nuk hyn ujë brenda tij, vdes nga etja.

Nëse dëshirojmë t’i gjejmë ato që kemi humbur për hir të njerëzimit duhet të ndezim dritën me zjarrin e besimit. Fjalët tona po i përfundojmë me këto shprehje të njërës prej burimeve të ndriçimit, Mevlanasë:

“Njëri humbi devenë në fushë. U shtri në njërën anë të rrugës i mërziur. Ra errësira e natës, nuk shihej asgjë. U zgjua me brengë në zemër. Mirëpo, ç’të shohë! Nën dritën e hënës diku tutje, dukej deveja e tij. I rodhën lotë gëzimi. Allahu im! Shtomë dritën në këtë botë që t’i vinë mend në kokë njeriut e ta gjejë njerëzimin që e ka humbur. Amin!”.

DIELLI I JETES, DURIMI

Prof. Dr. Jashar KANDEMIR

Pra është ai, i cili nuk vep-
ron me ngut dhe mërzi.

Ja pra, Sabur dhe Halim
është Zoti ynë.

Në Kur'an në më shumë
se nëntëdhjetë vende flitet për
durimin.

Ai dëshiron që edhe ne të
jemi të durueshëm.

Për ata që durojnë ka
xhennet.

Kështu na e këshillon du-
rimin Zoti ynë i Lartë:

“Besimtarë! Bëhuni të du-
rueshëm; lini mbrapa armiqtë
tuaj në durim.” (Al-i Imran
3/200)

“Duron! Pasi Allahu është
me ata që durojnë” (Enfal 8/46)

“Është më në dobi për ju
që të duroni” (Nisa 4/25)

“Duro!”

Ai që të jep fuqinë dhe
forcën për t'i qëndruar vësh-

tirësive është vetëm Allahu”
(Nahl 16/127)

“Duro!”

Pasi ata që do të durojnë,
më në fund janë fitimtarë”
(Hud 11/49)

“Shpërblimet ndaj atyre
që durojnë do të jepen pa llo-
gari” (Zumer 39/10)

Gjithashtu sipas asaj që
na njofton Allahu ynë i Lartë,

Të lumturve që do të hyj-
në në xhennet melekët do t'u
thonë:

“Paqja qoftë mbi ju që du-
ruat”.

Sa përfundim i kënaq-
shëm i jetës së kësaj bote është
ky! (Ra'd 13/24)

Neve na u këshillua durimi.

Pejgamberi ynë Muham-
medi (a.s) e mësoi durimin
nga Zoti që është Sabur.

Ai përballoi me mijëra
vështirësi gjatë kohës që jetoi.

Ai na tha se jeta është e
përbërë nga vështirësitë.

Ai na mësoi se rezistimi
ndaj vështirësive është më i
mirë se sa një jetë pa vështi-
rësi.

Një sahabi që nuk shihte,
një ditë erdhi pranë profetit
Muhammed (a.s) dhe tha:

- Bëji dua Allahut që të
më shërojë mua.

Pejgamberi i tha:

- Nëse dëshiron, i bëj dua,
por është më mirë për ty të
durosh për hallin tënd.

Por personi zgjodhi shëri-
min në vend të durimit, ndër-
sa i Dërguari i Allahut i mësoi
atij duanë që do të lexonte për
t'u shëruar. (Tirmidhi, De'a-
vat 119)

Në çdo periudhë kanë
qenë të ndryshme veprimet
apo sjelljet e njerëzve në lidh-
je me shërimin sa më shpejt



(Bakara 2 / 153)

të jetë e mundur ose durimin ndaj hallit që kanë.

Një ditë një grua e shëndetshme dhe me lëkurë të zezë vjen pranë Profetit dhe i thotë:

- Mua më ka kapur sëmundja e epilepsisë. Atëherë më hapet veshja.

Ju lutem bëni dua Allahut të shërohem.

Pejgamberi ynë i tha:

- Nëse thua po duroj, për ty ka xhennet, por nëse këmbëngul që të shërohesh, unë i bëj dua Allahut për shërim.

Më pas zonja tha:

- Unë do të duroj ndaj sëmundjes sime, por kur më kap epilepsia më hapet veshja.

Bëni dua që të mos më hapet.

Pejgamberi (a.s) bëri dua për moshapjen e veshjes. (Buhari, Merda 6; Muslim, Birr, 54)

Mirësia më e dobishme

Cila është mirësia më e madhe që na ka dhuruar Allahu?

Pasuria?

Bukuria?

Forca, fuqia?..

Asnjëra nuk është.

Allahu i Lartë thotë se do të vazhdojë t'i provojë robtë e vet me vështirësi derisa të nxjerrë në pah ata që durojnë.

Ndërsa ne me një mendim injorant, rrimë e themi:

“Zoti im, çfarë gjynahesh kam unë që nuk m'i pakëson hallet e mia?”

Pejgamberi ynë këtë e ka shprehur kështu:

“Askujt nuk i është dhënë mirësi më e madhe dhe më e dobishme se sa sabri”.

(Buhari, Zekat 50, Rikak 20; Muslim, Zekat 124).

Sipas asaj që thekson pejgamberi ynë i dashur, hallet dhe vështirësitë që përjetojmë janë mirësi.

Pasi “Allahu Teala, u jep vështirësi atyre që do”.

(Tirmidhi, Zuhd 56, Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 427-29).

Gjithashtu sipas asaj që urdhëron e thotë Pejgamberi (a.s) vështirësitë më të mëdha u ndodhin pejgamberëve.

Dikush nëse është shumë fetar, ka halle më shumë, nëse është pak fetar, ka më pak halle.

Allahu Teala nuk i pakëson vështirësitë e robit përderisa të mos ta pastrojë mirë nga gjynahet.

(Muslim, Fiten 23; Tirmidhi, Zuhd 57)

Allahu i Lartë thotë se do të vazhdojë t'i provojë robtë e vet me vështirësi derisa të nxjerrë në pah ata që durojnë.

(Muhammed 47/31).

Ndërsa ne me një mendim injorant, rrimë e themi:

“Zoti im, çfarë gjynahesh kam unë që nuk m'i pakëson hallet e mia?”

Ne pandehim se hallet dhe vështirësitë ndodhin vetëm për gjynahçarët.

Ka edhe diçka të rëndësishme që duhet të dimë për durimin.

Atë Pejgamberi (a.s) e shpreh kështu:

“Sabri është dritë, ndriçim” (Muslim, Taharet 1)

Pra durimi, është burim drite njëlloj sikurse dielli, vetë drita prodhon dhe ndriçon rrugën e njeriut që duron dhe zbukuron jetën e tij.

Durimi, mbi çdo punë.

Ne nuk e dimë se ç'është durimi.

Mendojmë se është thjesht përballim i vështirësive që na ndodhin, kurse në fakt durimi nuk është thjesht vetëm re-

zistim i dhimbjeve dhe vështirësive.

Durimi është një gjë që pushton të gjithë jetën tonë.

P.sh.: të fitosh luftën dhe të mundësh armikun duke u përballur me vështirësitë e luftës, është e mundur vetëm me durim, Por ne kësaj nuk i themi durim; ne atë e quajmë heroizëm, kurajo, guxim.

Nga ana tjetër, nefsi ynë kërkon të jetojë me plot dëshira, por ne mbajmë qëndrim ndaj këtyre kërkesave dhe durojmë, ose ne kësaj qëndrese nuk i themi sabër por zuhd.

Nefsi ynë i pëlqen edhe dëshirat e ndaluara, por ne mbajmë qëndrim edhe ndaj atyre pasi feja jonë i ka ndaluar, por ne edhe kësaj nuk i themi sabër por ndershmëri morale.

Ka edhe zemërim, inat;

Një zemërim më i ëmbël se mjalti.

Është një punë e vështirë të përballosh zemërimin.

Ne këtij durimi të heronjve që frenojnë zemërimin i themi hilim.

Pra ato mirësi që ne u themi sabër nuk janë as këta. Njëri na e lë amanet të fshehtë e tij.

Vjen koha që na digjet shpirti ta mbajmë të fshehtë atë të fshehtë.

Ne dëshirojmë ta ndajmë me dikë atë të fshehtë, por ajo që na takon ne, ta mbrojmë atë amanet duke e bërë zemrën varr të fshehtë.

Domethënë edhe të ruash një të fshehtë është një punë që kërkon durim.

Edhe të qenët syngopur, edhe të mjaftuarit me pak, e marrin forcën nga durimi.

Edhe rezistimi i nefsit ndaj dëshirave të ngrënies dhe pirjes është një punë që kërkon durim.

Siç shihet, për të jetuar si mysliman, është e nevojshme të frenosh dëshirat e panumërta të nefsit, t'i bësh ballë atyre dhe të durosh.

Është e pamundur të arrish të mrekullueshmen pa duruar.

Sa të lumtur janë ata që e arrijnë qëllimin e tyre në sajë të durimit.

Heronjtë...

Zahidët...

Ata që jetojnë me nder...

Ata që janë zotërues të hilmit...

Ata që dinë të fshehin të fshehtat...

Ata që mjaftohen me pak...

Paqja qoftë mbi ta...

Muslimani i mirë

Ahmet Tashgetiren

Në mënyrë të veçantë në ditët tona, në kohën tonë, kur njeriu po përjeton zhgënjimet më të thella, një mysliman i mirë është një fole strehimi, një shtyllë hyjnore për universin...

Njeriu ka gjithmonë nevojë për njerëzit që jetojnë me vlerat që nuk nuk njohin kohë e vend (pra që nuk plaken).

Njeriu në cilindo segment të jetës që të jetë detyrimi i tij më i rëndësishëm, detyrimi i tij parësor është të mirë-organizojë raportin e tij me Zotin. I ri ose i vjetër, femër ose mashkull, administrator (shëf) ose nëpunës, punëdhënës ose punëtor, nënë baba, fëmijë... Asnjë hapësirë (segment, pjesë) e jetës nuk mund të organizohet duke lënë mënjana marrëdhënien tonë me Zotin. Të qenurit njeri e bën të detyrueshme këtë. Cilësia

njerëzore lidhet në mënyrë të drejtpëdrejtë me këtë.

Ky do të ishte edhe myslimanizmi.

Një njeri i mirë, është në të njëjtën kohë edhe një mysliman i mirë.

Sot bota myslimane ka nevojë të domosdoshme që :

- Të jemi myslimanë të mirë. Duhet ta jetojmë islamin mirë dhe në mesin e shoqërisë duhet të ketë myslimanë të mirë.

Në të vërtetë Islami është i bukur.

Ai (islami) ka ardhur nga El Xhemili (I Bukuri). Janë parimet e Atij që e do të bukurën.

Islami është i bukur, por jo çdo mysliman që dëshmon se është i tillë stoliset me bukuritë apo mirësitë e Islamit me të njëjtën dozë (nivel). Ndonjëherë të metat e njerëzve hedhin hije edhe mbi Islamin prej ku lind edhe mendimi se problemi qëndron në bukurinë e tij.

Prandaj kur themi se kemi nevojë për myslimanë të mirë që reflektojnë bukurinë e Islamit në shoqëri nuk gabojmë.

Në mënyrë të veçantë në ditët tona, në kohën tonë, kur njeriu po përjeton zhgënjimet më të thella, një mysliman i mirë është një fole strehimi,

një shtyllë hyjnore për universin...

Njeriu ka gjithmonë nevojë për njerëzit që jetojnë me vlerat që nuk nuk njohin kohë e vend (pra që nuk plaken).

Shih zemrën, rregulloje atë.

Shih veprimet e tua, përmirësoji ato.

Shih vizionin tënd mbi dynjanë e ahiretin, thelloje atë.

Shih gjurmët tuaja, ndreq hapin.

Feja është përkufizuar si "Lartësim i urdhërave të Allahut, mëshirë ndaj krijesave të Tij".

Të jesh i vetëdijëshëm për urdhërat e Allahut e t'i lartësosh ato do të thotë të perceptosh shumë mirë tendencën tënde drejt gabimit e protestës ndaj Atij.

Njeriu i pajisur me këtë forcë perceptimi shpëton nga mashtruesi më i madh i njeriut nga krenaria ose nga adhurimi i egos së tij. Punën e tij e lidh me Krijuesin e Tij, sepse fe do të thotë përulje ndaj Zotit, lidhje e plotë me Të.

Nëse kjo do të ishte edhe filozofia e jetës suaj atëherë do të arrini shumë shpejt në botën e mëshirës ndaj çdo krijese.

Ja pra ky do të ishte myslimani i mirë.

↓

9

Njeriu i Zotit.
Njeriu i shpirtit.
Njeriu i dashurisë.
Njeriu i mëshirës.
Miku i Zotit.

Unë them që në çdo vend duhet të ndodhet një njeri i tillë.

Një lloj shtylle, ku mund të mbështetemi në rast vështirësish.

Një lloj kandili, kur njerëzit ta shohin t'u ndriçohet shpirti, t'u zgjohet dëshira për pastrim (të brendshëm), t'u kujtohet njeriu që do Zoti, t'u kujtohet Zoti.

Sot në nivel botëror ka nevojë për kandila, sepse është terruar shpirti njerëzor. Njeriu është larguar nga atmosfera shpirtërore dhe errësirat pushtuan shpirtin njerëzor.

Viti 2007 është cilësuar si viti i Mevlanës.

E gjithë bota është duke thirrur një mik të Zotit..., për t'ia ndriçuar zemrën.

"Eja, eja, eja ! - thoshte Mevlana... Çfarëdo që të jesh eja, tempulli ynë nuk është tempulli i pesimizmit."

Tani atij e gjithë bota i thotë eja, eja...duke e njohur si një mysliman të mirë.

Ai kandil u dogj në dritën e Muhamedit (a.s.).

Ai kandil u ushqye me nurin e Kur'anit për vite me radhë.

Drita e Muhamedit (a.s.), si Mevlanën, ka ndriçuar me mijëra shpirtëra gjatë shekujve...

Mevlana, Mevlana...
Sa më shumë Mevlana...!

Nga lindja në perëndim...si një rreze drite universale...

Duke e mbajtur botën e Muhamedit ndër duar, në zemër..., duke e mbajtur dritën e pavdekshme të Kur'anit... E nisi udhëtimin nga Mekke-ja e Medine-ja, çelën lulet në Semerkand, Belht, Buhara, Bagdat...

E nisi udhëtimin nga Semerkandi, çelën lulet në Konja, Yozgad, Stamboll...

Mori rrugën nga Bagdati, çelën lulet në Kurtub, Andaluzi, Europë-Amerikë...

Në qoftë se keni në zem-

***"Dua dhe adhurim
do të thotë të qëndrosh bashkë me Zotin. Për atë që qëndron me Zotin si jeta ashtu edhe vdekja janë të bukura."***

rën tuaj një kandil, drita e tij shpërndahet nga njëri shtet në tjetrin, nga zemra në zemër...

Myslman i mirë.

Mik i Zotit

Njeri shpirti (shpirtëror)

Një fizionomi që kur e shikojmë themi " Ky duhet të jetë miku i Zotit ".

Nga Mevlana:

"O kokë, me urdhërin e Tij u bëre e tillë, o këmbë me bujarinë eTij këmbë u bëre.

Me mendjemadhësinë tënde si mundet me mendje të protestosh dhe me dembelizëm të tërhiqesh këmbët..."

"O kokë në goftë se të duhen qiejt duhet të prekësh dheun..."

"Ai që për Allahun bëhet dhe, engjëjt në sexhde i bien atij. Atij që i bëhet rob Allahut qiejt rob i bëhen..."

"Papistëritë e brendshme jo uji por lotët i pastrojnë".

"Çfarë është kjo dynja? Të jesh indiferent ndaj të Hikut."

"Çfarë është drejtësia? Ujitja e frutave të një peme.

Po padrejtësia çfarë është? Ujitja e gjembave "

"Nëse do të lëshosh rreze sa një dritë duhet të lash unin tënd që natës i ngjan.

"Dua dhe adhurim do të thotë të qëndrosh bashkë me Zotin. Për atë që qëndron me Zotin si jeta ashtu edhe vdekja janë të bukura. "

"Të kërkosh diçka aty ku ajo s'ndodhet do të thotë mos ta kërkosh fare atë. "

"Në periudhën e shëndetshme të bollëkut secili të bëhet mik, kurse në periudhën e vështirësive a ka mik tjetër përveç Allahut? "

"Procesi i lindjes për gruan shtatzënë është vuajtje madhe, kurse për foshnjën që do të lind shpëtim nga pranget e një burgu. "

"Më dhimben njerëzit që bartin dhimbjen e imanit të mangët, pasi dhimbjet e tyre nuk kanë ilaç. "

LLOGARIA DYZETVJEÇARE

Zymer RAMADANI



Urdhëresa e Pejgamberit: “Llogariteni veten tuaj para se të llogariteni nga Allahu” drejtuar ymmetit mysliman është diçka e veçantë. Ajeti, i cili gjendet në suren Ahkaf, i cili, në të njëjtën kohë, u bën të ditur dhe përkujton njerëzve ditën e llogarisë, që jetën e tyre ta kalojnë në adhurim dhe duke bërë llogarinë e saj:

“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin

në moshën e burrisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!”¹

Në mesin e ajeteve, të cilat e paralajmërojnë dhe i bëjnë të ditur njeriut për çështjet e jetës, ky ajet ka një këshillë të veçantë, sepse i mëson njeriut që në të ardhme të ecë me hapa të

drejtë dhe të sigurtë. Përveç kësaj, ajeti i tregon njeriut se edhe pasi ta arrijë moshën dyzetvjeçare, ai përsëri është i dobët, sikurse që ishte në kraharorin e s’ëmës më herët, dhe në këtë moshë ndoshta atij i bën të ditur etapën e parë të krijimit. Sikurse po i drejtohet edhe në këtë mënyrë që njeriu le të vëzhgojë se në ç’mënyrë dhe nëpërmjet kujt ka ardhur në këtë sipërfaqe. Përveç kësaj, sa shumë lutje mirësie duhen bërë për prindërit të cilët përjetuan aq shumë vështirësi për ty...

Pas këtyre, më mirë do ta kuptosh nëse kthen vëzhgimin prapa dhe mendon se nga erdhe dhe në ç’gjendje je tani dhe se do ta kuptosh më mirë gjendjen në të cilën je, kështu që do t’i falënderosh të gjithë ata të cilët kontribuan për ty, e falënderon edhe pronarin e vërtetë të mirësisë në emrin tënd dhe prindërve. Në këtë mënyrë do të kesh mundësi të parashikosh dhe të pararendosh se për kah do të vazhdosh rrugën dhe se ku do të arrish...

Ah, po që se njeriu një ditë do të ulej dhe do bënte

1 El-Ahkaf, 46/15

llogarinë e dyzet viteve... çfarë thua do të mendonte nëse do t'i përkujtonte të gjitha të bërat, thëniet dhe nëse do t'i peshonte në zemrën e tij të gjitha ato gjëra që i ka parë?

Sigurisht se do të mendonte gjëra të ngjashme me këto: "Jam një udhëtar dyzetvjeçar që ec në këtë fushë provimi. U përsos gjendja ime shpirtërore dhe mundësia ime fizike, dhe se tani unë jam në kohën kur është dërguar Pejgamberi (a.s.) me ligj nga Allahu. Tani duhet që të ec dhe të përcjell një drejtim të saktë. Atëherë më duhet që të nxjerr një llogari për sistemin e jetës sime të djeshme, të sotshme dhe të nesërme. Më duhet që të bëj llogarinë dyzetvjeçare... Ja pra, ky duhet të jetë qëllimi i ajetit...

Mendoj se një njeri, i cili ka shkelur moshën dyzetvjeçare, ka parë shumë gjëra të kësaj bote. Ai e ka përjetuar mundësinë se si të rritet një fëmijë. Duhet që atij t'i jetë rritur diapazoni i mendimeve dhe sjelljeve.

Ai nuk është më sikurse ishte para njëzet viteve. Ai tashmë nuk është në ato pasione të ngarkuara, sikurse ishte në të njëzetat apo tridhjetat. Me të vërtetë, mosha dyzetvjeçare tregon një kthesë dhe një formim fizik të rëndësishëm. Nje-

riu, i cili ka arritur në këtë moshë, duhet që të dijë ta peshojë dhe vlerësojë vepërën e tij. Pra, tashmë për të është koha të bëjë llogarinë se prej nga e ku ka ardhur dhe se nga do të vazhdojë.

Llogaria, caktimi, përcjellja e kohës në këtë botë, i është lënë në lirinë dhe dëshirën e tij. Mirëpo për ne është sekret vetëm fundi i kësaj bote. Atëherë, një njeri i cili arriti në këtë moshë, duhet që t'i drejtohet Krijuesit, t'i lutet Atij... duhet që të jetë mirënjohës dhe falënderues për mirësitë që i janë dhënë, pastaj të menduarit t'i hedhë në praktikë. Duhet që amanetin e besimit, të cilin e ka marrë nga gjyshërit ta përcjellë tek fëmijët... të vëzhgojë djathtas, majtas, para dhe mbrapa, sepse po qe se qëllimet nuk janë për hir dhe në emër të Allahut dhe po qe se nuk kihet në mendje ahireti, frikësohemi që këto mundime dhe iniciativa të marrin një drejtim tjetër dhe ta mashtrojnë njeriun.

Sipas një aspekti, jeta është një lloj tregtie... mund të themi se ditët tona janë duke kaluar duke bërë allishverishe. Kurse për ato allishverishe që nuk paguhen në atë çast, caktohet një afat i caktuar me muaj apo vite. Mirëpo Allahu, njeriut

i mundëson një afat gjatë gjithë jetës... ajeti, i cili u cek më lart që ka të bëjë me këtë çështje, po i mundëson njeriut që përsëri të kujtohet, kur t'i arrijë të dyzetat. Kur mendoj dhe kujtohem se a thua si mund ta kuptoj këtë ajet fisnik, më vjen në mendje një shembull i këntillë: Mundohem të parafytyroj një zog në kafaz dhe duke menduar se dynjaja përbëhet vetëm nga ajo që shoh aty... mirëpo një ditë ndodh që zogu të fluturojë nga kafazi, kështu që pas fluturimit e vëren çdo gjë nuk ishte siç e kishte mësuar dhe parë në kafaz, por zgjohet dhe e vëren të vërtetën. Më pas vëren dallimet në vendin ku fluturon apo ku vendoset. Kjo, do të ishte një natyrë e freskët apo një pastruese e ndyrësirës...?!

Ne mendojmë në atë mënyrë sa që ky ajet fisnik i përngjan shembullit të zogut në kafaz, duke i përkujtuar njeriut se një ditë do të zgjohet dhe do t'i vërejë të vërtetat. Edhe pse ndodhet jashtë kafazit, kur paraqitet nevoja, paralajmërohen sekretet e sprovës dhe të vërtetat që i kishte të errëta më herët. Pastaj thotë:

"Zgjohu para se të vijë koha që të fluturojë shpirti i zogut nga kafazi".

Duhet që të kujtojë edhe gjykimet e tjera në dyzetëshen..., se shkuan kaq dhe mbeten edhe kaq nga ymri që kemi. Kjo nuk është një periudhë e shkurtër, sa që nuk mund të dijë që pas kësaj kohe edhe sa të kanë mbetur. Ajo e vërtetë, e cila nuk ndryshon është se koha dyzetyjeçare që të është dhënë ty, është sikurse një pjesë apo copëz e përdorur. Çdo vit bëhet llogaria e bilancit nga menaxherët, kontrollohet fitimi dhe humbja, kështu që asnjë vit nuk e mbyllin pa i bërë këto llogari. Mena-xhimet, të cilat nuk mund ti bëjnë llogaritë e tyre saktësisht, nuk kanë mundësi që t'i vazhdojnë edhe më tej punët e tyre, ndoshta që nuk mund të ekzistojë fare për një kohë të gjatë...

Të gjitha ato aktivitete të bëra përmes bajrameve apo festave tjera, duhet të dijë që ti bëjë të gjitha llogaritë e tij një nga një në mënyrë apo edhe nëse jo këto, të paktën të bëjë një llogari në dyzetyjeçarën e tij.

Ai, i cili nuk e bën këtë llogari, si mund të bëjë llogarinë e gjithë jetës së tij të gjatë?

LEXO DHE MENDO!

Zemra dhe shpirti i besimtarit:

*“Besimtarët dhe besimtarët janë miq për njëritjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zeqatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë”.*²

Ky ajet sinjalizon një portret të një besimtari, kështu që:

Bashkëpunimi i tij me besimtarët në gjuhën arabe theksohet me termin *velijj*, që do të thotë ndihmës, mik apo person i dashur nga të gjithë besimtarët dhe nga Allahu. Specifika më e kristaltë e tij është urdhërimi, këshillimi në të mira dhe ndalimi nga e shëmtuara dhe e keqja. Qëllimi i tij është që e para nga këto të përhapet, kurse e dyta të zbritet në nivelin më të ulët. Në këtë mënyrë, ky person është aq shumë dashamir dhe zemërbujar sa që të gjithëve ua dëshiron të mirat.

Zotëron namazin dhe e fal atë me gjithë dëshirën e zemrës. Ai, me gjithë dëshirë e jep zekatin. Ai e di se shpirti dhe pasuria e tij janë të Allahut. Në këtë mënyrë ai dëshiron që çdo pa-

rim personal apo shoqëror ta kthejë në ibadet. Në gjërat dhe kriteret që Allahu dhe Pejgamberi kanë sjellë norma, ai i pranon me një zemërbutësi dhe në asnjë mënyrë nuk mundohet që në argumentet dhe normat e prera të mendojë diçka tjetër apo të mundohet të hulumtojë domethëniet e thella të tyre.

Ai person është i pajtuar me Allahun, vetveten dhe gjithë njerëzit e tjerë. Dëshira e tij thjesht është një copëz e trupit të tij. Zemra e tij është aq shumë e gjerë sa që mund të përmbledhë gjithë rrethin dhe gjithë njerëzimin. Çdo fatkeqësi së pari atë e shqetëson dhe i lëndon zemrën, kurse çdo gjë e lumtur e bën të lumtur edhe zemrën e tij. Ashtu siç zgjerohen dhe hapen harqe, kur hidhet guri në ujë... gjatë gjithë kohës që jeton edhe zemra e besimtarit në atë mënyrë zgjerohet dhe rreh. Ai i përhap frytet dhe flakën e tij plot dashuri dhe gëzim në rrethin e vet, sepse shembulli më i mirë në zemrën e tij është ai që e ka marrë nga i dashuri i Allahut Muhammedi (a.s.)



A jeni hutuar?

Prof. Dr. Ismail Lutfi ÇAKAN *

Në kapitullin e dytë me temë "Lidhja pas Kur'anit dhe Synetit" të librit Mishkatu'l-Mesabih, Xhabir b. Abdillahi transmeton se Umeri (r.a.) e ka pyetur Profetin (a.s.) se po dëgjojnë disa fjalë tërheqëse nga hebrenjtë dhe pyesin Pejgamberin (a.s.): "A mundemi të shkruajmë një pjesë të tyre?"

Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj kështu:

"Ju keni gjetur dyshime në fenë tuaj ashtu siç kishin gjetur çifutët dhe të krishterët para jush???"

A e konsideroni të mangët këtë fe? Me të vërtetë unë jua kam pastruar fenë nga dyshimet dhe paqartësitë duke jua shpjeguar haptazi dhe jua kam sjellë të pastër atë. Po të jetonte edhe Musai sot, do t'i lejohej të më pasonte mua."

Ngjarja dhe raportimet

↓
14

Kjo ngjarje e dhënë në pjesën e përmbajtjes dhe në pjesën përfundimtare të librit Mishka, është transmetuar edhe në librat e tjerë burimorë në mënyrë të detajuar dhe me pak ndryshime, por duke ruajtur gjithmonë orgjinalitetin dhe përmbajtjen e tij. Në ditët e sotme për ta kuptuar sa më mirë dhe në mënyrë sa më të drejtë duhet që t'i marrim parasysht transmetimet e dhëna më poshtë.

Thuhet se kur Umerit (r.a.) i ra në dorë një tekst i tillë, që është shkruar nga hebrenjtë, shkoi tek Profeti (a.s.) dhe kur ia lexoi këtë tekst, Ai iu përgjigj atij duke e qortuar pak a shumë si në transmetimet e mësipërme me këto fjalë: "Mos i pyesni hebrenjtë për asnjë temë. Për arsye se, meqë ata e kanë prishur veten e tyre, atëherë është e pamundur që ata t'ua tregojnë rrugën e vërtetë juve. Kështu që, ju ose e miratoni një të pavërtetë, ose e mohoni një të vërtetë."

Po ashtu, sipas një transmetimi tjetër (Darimi, Mukkadime, 39) në librin Mishka (Hadithin nr. 194) thuhet se Pejgamberi (a.s.) iu drejtua Umerit (r.a.) me

këto fjalë të qarta: "Betohem në Atë që në duart e Tij është shpirti im, edhe sikur Musai (a.s.) të ishte në mesin tuaj dhe ju të largoheshit nga unë dhe ta ndiqnit atë, ju do të ishit të devijuar nga rruga e vërtetë. Sikur të ishte Musai (a.s.) në kohën time, ai patjetër do të më ndiqte mua."

Në një transmetim të Imam Buhariut shohim që Abdullah b. Abbasi është frymëzuar nga paralajmërimet e bëra nga Profeti (a.s.) dhe pak pas ndërimit të jetës së Tij (a.s.), ai thotë kështu: "O mysliman! Për derisa libri i Zotit (xh.sh.) që i është zbritur Pejgamerit (a.s.), gjendet në duart tuaja dhe e lexoni me besim të plotë, si ka mundësi që shkoni tek hebrenjtë për t'i pyetur ata (në çështje sheriati)? Dijeni që si shkak i ardhjes së dijes, juve ju është ndaluar që t'i pyesni ata! Betohem në Allahun që nuk jemi dëshmitarë, se asnjëri nga ata nuk ka pyetur asnjë gjë në lidhje me Kur'anin!" (Buhari, Shehadet 29, Itisam 25, Tevhid 42)

Marrëdhëniet ndërfaqetare

Thelbi i hadithit na qartëson për marrëdhëniet ndërfaqetare, si rrjedhojë, fjalët si: "Feja e Zotit është një. Thelbi i feve është një dhe feja e ardhur më pas e shfuqizon të kaluarën", na shtojnë që t'i vlerësojmë dhe t'i kuptojmë më mirë në thelb ato. Për këtë arsye është e rëndësishme që të ndalemi dhe të shohim anët që ndryshojnë dhe që nuk ndryshojnë tek fetë.

Që nga fillimi, të gjitha fetë hyjnore na kanë njoftuar që bazat e fesë janë të njëjta. Për arsye se këto kanë të bëjnë me besimin (akiden). Duke qenë kështu, nuk mund të ketë ndarje dhe tjetërsim në besim (akide), sepse të gjithë Pejgamberët janë të dërguarit e Një Zoti. Për këtë arsye nuk mund të pranohet si e drejtë, shpjegimet që dikush prej tyre të predikojë Njëshmërinë e Allahut, ndërsa tjetri për trinitetin ose që Zoti i përket një race.

Mendimi i njëjtë i të gjithë lajmëtarëve mbi konceptin e besimit (akides), tregon saktësinë e kësaj gjëje. Atëherë thënie si: “Baza e të gjitha feve është një, feja e Allahut është një”, përmbajnë kuptimin se bazat e besimit të feve hyjnore kanë qënë të njëjta dhe duhet të jenë po të njëjta. Nga këndvështrimi i organizimit të jetës individuale dhe sociale, mund të thuhet se numri dhe përmbajtja e vendimeve, gjykimave kanë ndryshuar me kohën dhe zbatimin e këtyre ligjeve të feve të vjetra, i përkisnin një provincë të caktuar. Nga ky aspekt, dallimi ndërmjet feve është i natyrshëm. Duke u nisur nga ajo që pejgamberët, të dërguarit e mëparshëm nuk janë universalë, por provincialë, shohim që ligjet e tyre janë të ndryshme dhe mund të thuhet se është i pashmangshëm ndryshimi ndërmjet tyre. Si rrjedhim i kësaj, fenë po ta marrim nga ana e besimit (akides) na çon në përfundimin se të gjitha fetë hyjnore janë një.

Kurse po ta marrim nga ana e shariatit atë, mund të pohohet se është i natyrshëm ndryshimi ndërmjet tyre. Për këtë arsye burimi i drejtpërdrejtë i këtij lajmi është nga Allahu, kurse gjatë përcaktimit të ligjeve merren parasysh nevojat dhe mundësitë që kanë njerëzit.

Është e mundur që ligjet e feve të vjetra të aprovohen edhe nga feja e re. Me një fjalë, mund të themi që ligjet e feve të kaluara mund të kenë vlerë edhe për ne. Feja e sjellur dhe e prakti-

kuar nga Pejgamberi (a.s.) është e ndryshme nga të tjerat, sepse është fe universale.

Pastërtia dhe plotësimi i Islamit

Nga hadithet e mësipërme, shohim se burimet dhe ligjet e islamit janë larg çdo dyshimi, dhe kuptimi i kësaj është që Kur’ani dhe Synneti janë të mjaftueshme në Islam. Në këtë pikë marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të feve të tjera dhe atyre të besimit Islam nuk duhet që t’i kemi larg vëmendjes.

Në anën tjetër, gjatë kohës që Kur’ani dhe Synneti ishin duke u shkruar, të merrnin disa fjalë të feve të anuluar më përpara, që na përshtateshin, do të na sillnin probleme të mëdha. Në të vërtetë detyra që u përket myslimanëve është mësimi dhe përjetimi i urdhërave dhe i ligjeve të fesë. Që në fillimin e procesit të fesë, gjetja e shkrimeve dhe marrja e tyre, do të ishte problematike. Për këtë arsye, Pejgamberi a.s. na paralajmëroi duke na thënë kështu: “A keni rënë në dyshim edhe ju ashtu siç kanë rënë hebrejtë dhe të krishterët?”

Nuk duhet të harrojmë që simpatia ndaj feve të tjera do ta mërziste shumë Pejgamberin (a.s.)

Po të jetonte Musai (a.s.)

“Përkujtoni (o ithtarë të librit), kur Allahu mori zotimin e pejgamberëve:

Ngaqë juve u dhashë libër e urtësi, ju patjetër do ta besoni dhe ndihmoni Pejgamberin që vjen pas jush, e që vërteton atë

që ju keni pranë vetes.” {Sureja Ali Imran, 81}

Nga ajeti i mësipërm kuptojmë që pejgamberët e mëparshëm, po të jetonin në ditët e sotme, do të ishin të detyruar t’i përshtaten fesë Islame e cila është sjellur nga Pejgamberi (a.s.), ku vetë ai e ka pohuar me gjuhën e tij. Pra kuptojmë që hebrejtë dhe të krishterët janë të obliguar të jenë muslimanë. Arsyeja e emërtimit të temës “A jeni i hutuar?” është për ata të cilët pohojnë se feja dhe librat e hebrenjve dhe të krishterëve janë në fuqi akoma dhe se ithtarët e librit do të hyjnë në xhenet.

Përfundim

Pejgamberi (a.s.) në hadithet e mësipërme, na jep mesazhe për fetë e kaluara dhe për argumente të panjohura të tyre për të cilat nuk kemi nevojë. Duke pasur Kur’anin dhe Synnetin, ne nuk duhet që të mësojmë fenë nga burimet e tjera joislame.

Për ta mbështetur mendimin tonë, në hutbe apo në ligjëratat nuk është lejuar dhe e pëlqyer që të merren për bazë mendimet e jomuslimanëve apo të përmenden emrat e tyre.

* Universiteti Marmara, Dega Hadith

Nexhmije Robaj
Viti IV "Medreseja Alauddin"
Konvikti-Rabiha Hatun Prizren

Dashuri pa e parë kurrë

Poezi për Muhammedin (a.s.)

Pse o lot nuk po pushoni,
Pse si lumë rridhni e nuk ndaloni,
Pse o zemra ime po rreh kaq fort,
Se edhe mallin për të nuk e duroj dot.

Pse o dora ime po dridhesh,
Pse o gjumë nuk më merr, kur rreth meje po sillesh,
Pse o laps ngjyrë nuk po lëshon,
A thua edhe ty sa mua po të mungon.


O Zot! Ku është e fshehur kjo ndejnjë,
Ndoshta në humnerë të pafund,
Ku duke gërmuar e kërkoj me mund,
Por kot, as në ëndërr s'e shoh askund.

Nisem nga fillimi, me të ftohtë e acar,
Ku kaloj, shoh duke udhëtuar,
Dhe nuk e ndjej lodhjen aspak,
Vetëm atë për ta takuar .

Eci dhe vetëm eci.
Dua të arrij në shkretëtirë,
Dua të vrapoj aty e lirë.
Dua e zbathur në rërë të bredh,
Kur mendoj se këmba e kujt në të shklet.

O All-llah vërtet ai ishte një shembëlltyrë,
Ishte si zambaku me erën më të mirë,
Fytyra e tij shndriste si hënë,
Ku edhe rrezet e diellit nuri i tij i kishte zënë.

Edhe pse kurrë pa e parë,
Ne jemi ummeti që mallin e tij jetojmë,
Por shpresa e fundit për ne është
Që All-llahun në Xhennet me të na bashkojë.



Të takohesh me profetët

Aisa KOKICI

Kur ishim të vegjël nëna na tregonte historitë e profetëve. Atëherë s'kishte as drita dhe as televizor si tani. Të gëzuar uleshim rreth saj nën dritën e llambës së gazit.

Këto histori ishin një gëzim i madh për ne, gjatë netëve të gjata të dimrit. Tregimet e saj ngjallnin emocione të papërshkruara në zemrat tona. Me anë të tyre hynim në botë që nuk ngjasonin me ato të fshatit tonë. Përjetonim lumturinë e njohjes me njerëzit më të ndritur.

Pejgamberi i parë me të cilin u njohëm ishte Ibrahim (a.s). Lindja e tij në një shpellë... Rritja larg nga njerëzit... Pastaj vendosmëria në thyerjen e idhujve dhe në adhurimin e Allahut.... Shndërrimi i zjarrit të Nemrudit në një kopësht me trëndafila për të... Pastaj u njohëm me Hz. Jusufin. Një jetë e çmuar dhe e mbushur me vlera të mëdha. Që në vogëli u nda nga babai..U shit si skllav... Qëndroi me vite i burgosur pa e parë dritën e diellit.

Po Hz. Musai. A ndryshonte jeta e tij nga të tjerët? Sa sprova të vështira e të gjata përjetoi. Ndarja nga e ëma, pallati i Faraonit, largimi nga Egjipti dhe vendosja në Mejden, një martesë e lumtur...

Tani, kur lexoj kuptimin e ajeteve kuranore, të gjitha

këto histori i kam të freskëta në mendjen time. Emocionet dhe ngrohtësia e tregimeve jetojnë akoma brenda meje. Sa më shumë që lexoj Kur'an, aq më shumë më kujtohen emocionet e atyre ditëve. Përveç kësaj, më duket sikur i përjetoj edhe më shumë. Më duket sikur takohem përsëri me shokët e vjetër (n.q.s më lejoni të shprehem kështu), me njerëzit më të mirë. Çmallet me to duke lexuar Kur'an.

Pas pak Hz. Ibrahim do t'i thyejë idhujt dhe do të lërë vetëm më të madhin. Pastaj Hz. Ibrahim, do largohet bashkë me Sarën dhe ne do iknim bashkë me to.

Do dëgjonim thirrjet e besimit të Hz. Jusufit në mes të shokëve jobesimtarë. Pas pak do dilte në shesh e vërteta dhe ne do dilnim të pafajshëm. Do shikonim sesi shkopi i Musait (a.s) do t'i zhdukte shkopinjët e magjistarëve të tjerë. Pastaj grupe-grupe do drejtoheshim drejt detit dhe do shihnim mbytjen e Faraonit....

Në çdo lexim të Kur'anit e ndjejmë ngrohtësinë e tregimeve (rrëfimeve). Nuk e njohim lodhjen dhe mërzinë. Të mbërthejnë me mënyrën e të treguarit. Të duket sikur ngjarjet po ndodhin para syve të tu dhe ti i përjeton thellësisht. Aq të gjalla dhe aq magjepsëse!



Ndonjëherë shohim të tregohet për një varg profetësh. Hz.Nuh, Hz. Hud, Hz. Salih, Hz.Lut, Hz. Shuajp..... Tregohen një nga një shembujt e sakrificave të bëra nga vetë ato. Nga këto rrëfime kuptojmë që të gjithë profetët kanë pasur një qëllim. Të gjithë kanë qenë thirrës të besimit në një Zot. Por fatkeqësisht shumë prej popujve të cilëve u janë dërguar profetët i kanë përgënjeshtuar dhe për këtë arsye janë dënuar.

Rrëfimet erdhën në periudhën e Mekës dhe ishin si një paralajmërim për ato të cilët nuk i besuan Pejgamberit. Nga ana tjetër, tregimet kanë luajtur një rol të madh për forcimin e besimit, për ngushëllimin e sahabëve. Profetët e kaluar hasën në vështirësi, por në fund fitorja ka qenë e tyre. Edhe besimtarët e parë ashtu si profetët një ditë do arrinin suksesin.

Jeta e pejgamberëve të mëparshëm tregohet shpesh dhe në kohë të ndryshme. Pavarësisht se ka përsëritje, në secilën prej tregimeve shohim një stil të veçantë dhe mësimet që nxirren janë të ndryshme. Nuk duhet harruar ndikimi që sjell përsëritja në mendjen e njerëzve. Këto përsëritje janë të rëndësishme për të vendosur mirë rrënjët e mësimet dhe besimit në zemrën tonë. Pastaj takimi me të njëjtin pejgamber në situata të ndryshme na ngjall emocione të reja. Takimet forcojnë lidhjen shpirtërore me njerëzit e zgjedhur nga Zoti (xh.sh).

P.sh. historinë e Hz.Zekerijas dhe Hz.Jahjasë e lexojmë në suren Al-i Imran. Këtu his-

toria e tyre tregohet e lidhur me Hz. Merjemen dhe Hz. Isanë. Tregohen ndreqja e gabimeve të të krishterëve dhe hebrenjve. Jepen argumentet e fuqisë së pashoqe të Allahut. Pastaj në suren Merjem Hz. Zekerijanë e shohim të butë e të ndjeshëm. E ndjejmë dëshirën e flaktë që përjeton ai për të pasur një fëmijë. Shohim me sytë tanë sesi i janë thinjur flokët. Përjetojmë emocionin e takimit dhe të ndarjes së dhimbjes me të: *'Kur ai i drejtoi Zotit të vet lutjen e fshehtë: O Zoti im! Eshtrat tashmë më janë dobësuar, koka më ndriçon*



nga thinjat dhe asnjëherë nuk kam mbetur i zhgënjyer nga lutja ime për Ty o Zoti im! Unë u frikësova sjelljeve të të afërmeve të mi, ndërsa bashkëshortja ime është shterpë, prandaj më dhuro nga ana Jote, një pasardhës që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit. O Zoti im, bëje atë të pëlqyeshëm për Ty.” (Merjem 19/ 3-6)

Ka raste që historia e një pejgamberi tregohet nga filli-

mi deri në fund. Edhe këtu nuk ka gjëra të tepërta, theksohen gjithnjë disa pika. Historia e Hz. Jusufit është shembulli më i mirë. Është historia më e bukur e Kur’anit. Hz. Jusufi shfaqet para nesh si një thesar. Kur e pyetën një herë Pejgamberin (a.s) se kush ishte njeriu më i lartësuar, iu përgjigj: ‘Nipi i Hz.Ibrahimit, Jusufi’. (Buhari,Enbija 11) Ai është një pejgamber i mrekullueshëm në të cilin pasqyrohen durimi, nderi, virtyti, lidhja me Zotin dhe përkulja para vullnetit të Tij. Me aftësitë dhe zgjuarsinë e paparë, ai është një njeri i ndritur. Ai është një pejgamber me të cilin mund të takohemi në çdo hap të jetës sonë.

Kur shjetojmë një temë ose kur përjetojmë diçka, në jetë shoqërohemi me një nga këto histori. Menjëherë ajo kristalizohet në kujtesën tonë për të mos u harruar më.

Një temë të cilës në Kur’an i jepet rëndësi është ringjallja. Të ringjallet trupit i cili bëhet hi, është me të vërtetë një mrekulli. Njeriu e ka të vështirë besimin dhe realizimin e një mrekullie të tillë dhe ndonjëherë humbet krejtësisht në të.

Pikërisht këtu na shfaqet një tablo nga Hz.Ibrahimi (a.s), kur Ibrahim tha: “O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit?” Zoti i tha: “A nuk beson?”, -Ibrahimi iu përgjigj – “Besoj, por dëshiroj të më qetësohet zemra.” Atëherë Allahu i përgjigjet: “Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërndaji në çdo kodër nga një copë prej tyre pastaj thirri. Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu

është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.
(Bekare 260)

Në këtë ajet shohim sesi jo vetëm Ibrahim (a.s), por dhe të gjithë njerëzit shohin zgjidhjen e dyshimit të ringjalljes. Ato janë mësuesit e ndritur të njerëzimit. Ata janë një shembull i vërtetë në bindjen ndaj Allahut, në adhurimin ndaj Tij dhe në mësimin e punëve të ndryshme të kësaj bote. Ata nuk janë vetëm prijës të besimit, por edhe liderë të civilizimeve.

Prandaj kërkohet prej nesh që të marrim mësim prej tyre.

“Ti duroje atë që thonë ata dhe kujtoje robin tonë të fuqishëm Daudin që përherë i drejtohej Zotit. Kujto robtë tanë: Ibrahimin, Isakun dhe Jakubin, të fortë dhe largpamës. Ne u dhuruam atyre një virtut të veçantë, që ta kenë gjithmonë në mendbotën e ardhshme. Njëmend ata janë tek Ne njerëzit më të mirë e më të zgjedhur. Kujtoje edhe Ismailin, Eljesain dhe Dhulkiflin. Të gjithë ata kanë qenë nga besimtarët e zgjedhur e të mirë. (Sad 38/ 17,45-48)

Këtu theksohet se të gjithë pejgamberët kanë qenë njerëz të mirë e të zgjedhur. Allahu i lavdëron ata gjithnjë. Nga ana tjetër nuk duhet të anashkalojmë edhe fjalët që tregojnë aftësitë e larta udhëheqëse të tyre. Ata janë pishtarët ndriçues të rrugës së njerëzimit. Sa kanë qenë shëndoshë, i kanë thirrur njerëzit në rrugë të drejtë.

Shumicës prej tyre nuk i është dhënë rëndësia e duhur, por në librin dërguar pejgamberit të fundit, ata shfaqen si modele (shembuj)



për t’u ndjekur. Prandaj ata vazhdojnë t’i thërrasin njerëzit për gjërat që sakrifikuan dhe i vlerësuan më shumë.

Allahu u ka treguar njerëzve rrugën e pjgamberëve si rrugën e vetme të drejtë. Allahu i tregoi Nuhut rrugën e tij dhe të gjithë njerëzit duhet ta ndjekin atë: *“ Ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakubin. Që të dy nga këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë Ne punëmirët. Ne udhëzuam edhe Zeke-rijan, Jahjain, Isain, Iljazin, të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit më të mirë.*

Po ashtu udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin, secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit. (En’am 6/84-86)

Hallka e fundit e pejgamberëve, Pejgamberi ynë,

është urdhëruar me ndjekjen e rrugës së të parëve: *“Këta janë ata të cilët Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, prandaj edhe ti (Muhammed) ndiq rrugën e tyre. (En’am 6/90)*

Në të vërtetë, ky është një urdhër i dhënë edhe për ne. Hajde edhe ti o pjesëtar i ummetit musliman, hajde dhe ndiq rrugën e këtyre njerëzve të mirë. Në këtë ajet u bëhet thirrje njerëzve për t’u takuar më shpesh me pejgamberët, për të biseduar me ta dhe për t’i ndjerë më pranë. Ne si muslimanë u besojmë atyre pejgamberëve pavarësisht se u përgënjeshtroan nga popujt e tjerë. Ne na takon të ecim në rrugën e ndriçuar nga kandilët e tyre. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta!

TOLERANCA DHE E DREJTA FETARE

Zymer RAMADANI



Sado që ideologjitë dhe filozofitë e ndryshme pretendojnë se islami ka bërë krim në kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, sistemi kur'anor assesi nuk është i tillë.

mit, në sistemin e kësaj bote atij i është dhënë gjëja më e përsosur ndër gjithë krijesat tjera, e ajo është liria dhe vullneti i tij. Kështu që, pasi njeriu pranoi përgjegjësinë që të jetë udhëheqës dhe zëvendës/halife në sipërfaqen e tokës, Allahu, menjëherë i mundësoi atij që t'i mësojë emrat e çdo gjëje të kësaj gjithësie.¹

Me fillimin e zhvillimit të jetës, njeriu nuk u detyrua që t'i përmbahet vetëm një sistemi, mirëpo atij iu bë i ditur se sistem më i përsosur i fesë në të cilin ai mund të gjente lumturinë, është Islami. Kështu që Allahu në Kur'an thekson se:

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur”²

Atëherë, pasi që Kur'ani e vulosi të gjithë sistemin e hershëm, nuk bëri ndonjë dallim dhe ndarje në mes të njerëzve. I lejoi dhe u preferoi që të jetojnë në bashkësi dhe grupe në mënyrë që ta zbukurojnë edhe më mirë jetën e tyre.

Sado që ideologjitë dhe filozofitë e ndryshme pretendojnë se islami ka bërë krim në kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, sistemi Kur'anor assesi nuk është i tillë. Ata pa bërë asnjë hulumtim, analizë dhe pa gjetur ndonjë

argument bindës, këto ideologji i kanë shpërndarë në të gjithë medjat dhe literaturën botërore. Përveç kësaj, përmes shumë rrugëve tentojnë që të spërkatën mendimet e pastra të rinisë, e cila është e ardhmja e popullit³.

Mirëpo siç theksuam edhe më lart, Kur'ani assesi nuk ka bërë një ndarje të tillë, por ai gjithmonë fton në vëllazërim bashkim, prosperitet dhe bashkëpunim me njëri tjetrin dhe toleron pjesëtarët e tij gjer në atë masë sa nuk është e mundur që njeriu të mos arrijë lumturinë më të përsosur që ekziston.

A mos ndoshta njeriu nuk është në gjendje ta kuptojë apo ndoshta e ka kuptuar, por e ka harruar ajetin ku Allahu thotë:

“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...⁴, apo hadithin e Pejgamberit a.s. se njerëzit janë të barabartë në aspektin sociologjik, por se ata dallojnë vetëm në devotshmëri dhe veprat që bëjnë⁵, ose “Njerë-

3 Shih fjalimin nga Prof. Dr. Ali Bardakoğlu të mbajtur në Ankara gjatë vizitës që i bëri Papa Benediku XVI – Turqisë, Ankara, 28 Dhjetor 2006.

4 Huxhurat, 49/13

5 Ahmed ibni Hanbeli, vëll. V, no. 411.

1 El-Bekare 2/ 30,31

2 Ali İmran, 3/85

zit janë të barabartë dhe të njëjtë sikurse dhëmbët e kranit”⁶ etj.

Nëse ndalemi dhe u bëjmë një analizë këtyre thënieve të arta – e që përveç këtyre ka edhe shumë tjera – do të shohim se njeriut i është dhënë çdo e drejtë personale, fetare dhe shoqërore. Nuk u detyrua që patjetër dhe me dhunë të pranojë Islamin, sepse;

“Nuk ka dhunë në fe”⁷,

dhe

“Po qe se do të dëshironte Allahu, nuk do të kishte mbetur askush në këtë sipërfaqe pa besuar”⁸

Duhet të jemi të bindur se çdo individ, kudo që të jetë, është i lirë. Njeriu si krijesë njerëzore, vetëm pse është njeri është i lirë dhe i ndershëm, sepse Allahu atë e nderoi me shumë gjëra: “Më të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Adem-it”⁹.

Nga vetë krijimtaria e njeriut, ai është i nevojshëm për të besuar diçka, pra besimi është një ndjenjë natyrore. Nëse hulumtojmë historinë më të hershme njerëzore, do të shohim se asnjë popull nuk ka qenë pa besim.¹⁰

Pas të gjitha këtyre, kur kthehemi tek Kur’ani menjëherë përballemi me ajetet, të cilat tregojnë se përdërisa një popull nuk i dërgohet ftesa dhe njohuria e Islamit, ai popull, nuk do të jetë përgjegjës për besimin apo mosbesimin e tij.

Nëse i kthehemi sistemit modern, i cili pjesërisht prak-

tikohet sot në botë, do të vërehet se çdo kushtetutë botërore ka hartuar dhe ka cekur në planin e saj të drejtat dhe liritë e njeriut, qofshin ideologjike apo fetare. Mirëpo para se të paraqesim këto kushtetuta, menjëherë duhet të bëjmë se a janë duke u praktikuar ashtu siç janë përpiluar.

Një kushtetutë e tillë, për herë të parë – pas Kushtetutës Medines – është cekur në “Komunikatën e të Drejtave në Virgjinja” më 12 Qershor 1776, duke theksuar këto:

“Lidhur me besimin dhe fenë që i jemi borxh krijuesit tonë, duhet të bëjmë të ditur se këto duhet t’i plotësojmë dhe t’i pranojmë përmes vullnetit dhe mendjes, e jo përmes dhunës dhe përdorimit të forcës. Për këtë shkak, të gjithë njerëzit janë të barabartë në zgjedhjen dhe aplikimin e detyrimeve të veta fetare”¹¹

Po të njëjtën gjë, më 26 Gusht 1789 e kanë cekur Francezët në nenin 10 dhe 11, se populli është i lirë në pranimin dhe aplikimin e fesë. Por pak më qartë se këto, më 10 Dhjetor 1984, në Kushtetutën Amerikane të të drejtave të njeriut, në nenin 18 thuhet:

“Çdo person është i lirë në mendimin, dhe fenë e tij...”¹²

Sipas këtyre kushtetutave të këtyre vendeve të zhvilluara dhe demokratike, vërehet se të drejtat dhe liritë fetare të njeriut ndërtohen mbi katër themele:

1. **Besimi:** Çdo individ është i lirë të zgjedhë cilën fe të dojë.

2. **Vepra:** Çdo individ është i lirë të praktikojë ritet e fesë që i takon.

3. **Shkollimi :** Çdo individ është i lirë të mësojë dhe shpjegojë fenë e vet.

4. **Dhe që çdo kush ka të drejtë të formojë bashkësinë e tyre fetare e sociale.**

Nëse këto katër pika aplikohen në çdo vend të botës, atëherë mund të themi se edhe myslimanët do të kenë të drejtat e tyre që të formojnë shkollat, ndërtojnë xhamitë, ligjërojnë islamin dhe të kenë qendrat e tyre për bashkësi dhe tolerancë ndërfitare.

Ne si predikues të Islamit, jemi të detyruar, që t’ia sqarojmë liritë dhe të drejtat një individ në mënyrë sa më të mirë, duke pasur parasysh pozitën dhe shkallën e tij. Gjithmonë duke filluar nga pikat e përbashkëta që kemi me bashkëbiseduesin dhe gjithmonë duke i treguar atij shembujt e artë se si ka vepëruar Pejgamberi (paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të) me njerëzit.

* Absolventë pranë Fakultetit Teologjik në Konja të Turqisë

6 Axhluni, Keshfu’1 Hafa, no. 2847.

7 El-Bekare, 2/ 256

8 Junus, 10/99

9 Îsra, 17/70

10 Günay Tümer, Abdurrahman Küçük. Dinler Tarihi. f. 27.

11 Şeref Ünal, Avrupa İnsan Hakları Sözleşmesi, f. 206

12 Saffet Köse, İslam Hukuku Açısından Din ve Vicdan Hürriyeti. f. 14.

Një njeri, për ta quajtur i dashuri i Zotit (xh.sh.) së pari duhet të përpiqet të bëhet i dashuri i Profetit (a.s.), pra një person për të vërtetuar se është në rrugën e tasavvufit, së pari duhet që të jetojë sunnetin e Pejgamberit (a.s.) Tasavvufi dhe Islami nuk janë gjëra të kundërta, tasavvufi është ta jetosh Islamin me sinqeritet dhe me një personalitet të lartë dhe të jetosh në gjurmët e Profetit (a.s.).



TASAVVUF DO TE THOTE TE JETOSH NE GJURMET E PROFETIT (A.S.)

Naim DRILAJ

Intervistë me prof. Henry Francis B. Espiritu (Abdulgaffar)

- Do të dëshironim të dinim diçka për jetën tuaj dhe si jeni njohur me Islamin?

Jam pedagog në degën e Filozofisë Aziatike në qendrën universitare "Cebu City" në Universitetin e Filipineve. Fusha akademike me të cilën interesohem është të jetuarit e tasavvufit në Azinë e Jugut, Indi dhe Pakistan. Në të njëjtën kohë jam duke përfunduar doktoraturën në degën e filozofisë në universitetin "Ateneo Demalina". Tema e doktoraturës time është mbi tolerancën dhe pluralizmin që pasqyrohet në veprat e mendimtarëve modernë pakistanezë brenda kuadrit të filozofisë Islame.

Duke parë veprat dhe eksperiencën e mistikëve dhe afrimin e tyre që kishin ndaj Perëndisë, shprehjet dhe sjelljet e bukura të tyre, më lindi dëshira për të hyrë në Islam.

Mektubati i Imam Rabaniut ka ndikuar shumë tek unë, këshillat dhe shprehjet që citonte ai, sikur i drejtoshin vetëm zemrës sime. Imam Rabaniu në mektubatit shpirtëror, citon që kushti themelor për të qenë një besimtar i vërtetë dhe një posedues i tasavvufit, është të ecim në gjurmët e Pejgamberit (a.s.)

dhe ta respektojmë sunnetin e tij. Respekti ndaj sunnetit të Pejgamberit (a.s.) na bën ne besimtarë dhe një murid të vërtetë.

Sipas imam Rabaniut, shkurtimisht tasavvuf do të thotë: sinqeritet, moral i lartë dhe ndjekës i rrugës së Profetit (a.s.), pra të jetosh një jetë sikurse Pejgamberi (a.s.)

Një njeri, për ta quajtur i dashuri i Zotit (xh.sh.) së pari duhet të përpiqet të bëhet i dashuri i Profetit (a.s.), pra një person për të vërtetuar se është në rrugën e tasavvufit, së pari duhet që të jetojë sunnetin e Pejgamberit (a.s.) Tasavvufi dhe Islami nuk janë gjëra të kundërta, tasavvufi është ta jetosh Islamin me sinqeritet dhe me një personalitet të lartë dhe të jetosh në gjurmët e Profetit (a.s.). Sot e falënderoj Zotin që më dha mundësinë të jem musliman, pasi pranova Islam, kam marrë emrin Abdulgaffar. E lus Allahun që të ma bëjë të mundur të jetoj në këtë botë, si një musliman i vërtetë, deri në momentin e fundit të jetës time. Amin.


Si mund të njihemi pak me virtytet e Hz. Ebu Bekrit? Mund të na flisni? Dhe çfarë mësimesh mund të marrin muslimanët e ditëve të sotme?

Virtytet e shumta të Ebu Bekrit (r.a.) si morali i lartë dhe një karakter i pakrahueshëm, ka bërë që të pëlqehet e të duhet shumë nga Pejgamberi (a.s.) dhe nga sahabet. Personaliteti i tij shpirtëror për ummetin e sotëm është një shembull. Sinqeriteti, bujaria, modestia dhe ndikimi i tij kanë qenë në një nivel të lartë. Ebu Bekri (r.a.) është i pari që ka besuar mesazhin Islam dhe është ai i cili e ka mbrojtur Pejgamberin (a.s.) kundër sulmeve të mushrikëve dhe është po ai, i cili gjithë pasurinë e tij, e ka sakrifikuar në rrugën e Islamit.

Kur Ebu Bekri (r.a.) e dha të gjithë pasurinë e tij në rrugën e Allahut (xh.sh.), Pejgamberi (a.s.) e pyeti: "Ebu Bekir çfarë ke lënë për familjen tënde?"

Dhe ai i është përgjigjur duke thënë: "Allahun dhe të Dërguarin e Tij."

Në ditët e sotme ne muslimanët, vakëfet (institucionet bamirëse) dhe xhematet duhet të marrim shembull bujarinë e Ebu Bekrit. Kur mushrikët e Mekës e kanë akuzuar si gënjeshtar Pejgamberin (a.s.), i cili u tregoi për ngjarjen e Miraxhit, Ebu Bekri (r.a.) në këtë rast e ka mbrojtur Pejgamberin (a.s.) duke e përkrahur me të gjitha mundësitë e tij. Një virtyt tjetër i tij është përkrahja dhe besimi që u ka dhënë sahabeve në ndërrimin e jetës së Pejgamberit a.s.. Me përsosmërinë e drejtësisë së tij dhe modestia e përpjekjes së tij ka siguruar stabilitetin e ummetit islam. Disa sahabë nga ndërrimi i jetës së Pejgamberit a.s. dhe nga mërzia e madhe që kishin, nuk kanë mundur ta kontrollojnë veten



e tyre, por Ebu Bekri r.a. mundohet që ti forconte ata. Disa muslimanë kishin qëllimin për hilafet, por qëllimi i Ebu Bekrit ishte që t'i bashkonte besimtarët që të mos të përçaheshin mes njëri-tjetrit. Kur sahabet e panë që dëshira e Ebu Bekrit nuk ishte për pozitë, ata menjëherë e pranuan halife.

Zoti xh.sh. na e bëftë rrisk ndjekjen e gjykimeve të plota dhe zemërbutësinë e Ebu Bekrit r.a. Në botën Islame drejtuesit e xhematëve të ndryshëm në vend që të luftojnë mes njëri-tjetrit duhet që të kenë bashkim, vllazërim dhe për ta realizuar këtë mirëqenie duhet të marrin shembull Hz. Ebu Bekrin r.a. Inshallah nëse e marrim shembull personalitetin dhe virtytët e Ebu Bekrit r.a. dhe e ndjekim rrugën e tij, rinovimi në të ardhmen do të realizohet.

Si duhet ta vlerësojmë veten nëse e krahasojmë me periudhën e muslimanëve të parë?

Nëse e krahasojmë veten me sahabet dhe tabiinët, duhet të turpërohemi nga gjëndja jonë. Duke parë jetën shembullore të tyre dhe sakrifikimin që kanë bërë ata për Islamin, mendoj që duhet të pendo kemi tek Allahu xh.sh., për gabimet dhe indiferencën që kemi ne ndaj tyre. Sahabet çdo gjë e kanë sakrifikuar në rrugën e Allahut xh.sh., kur në kohën e tyre kanë qenë shumë të varfër. Mundësitë i kanë pasur të pakëta, por Islamin e kanë përhapur nga Andaluzia deri në Spanjë dhe nga Lindja e Mesme deri në Azi. Kjo përhapje e Islamit është bërë nga sinqeriteti dhe besimi i madh që kanë pasur ata. Në ditët e sotme ne i kemi të gjitha mundësitë për ta

përhapur Islamin, por përsëri nuk shërbejmë për të, aq shumë jemi dhënë pas kësaj bote, sa që edhe ahiretin e kemi harruar. Një njeri i cili e ka harruar ahiretin, nuk mund të shërbejë në rrugën e Zotit xh.sh., ajo që shikohet në tabllonë moderne, është që jemi bërë rob të vetvetes tonë, dhe fenë e përdorim për interesat tona, kurse sahabet me besimin e plotë të tyre, janë bërë të suksesshëm në përhapjen e Islamit. Ne muslimanët e kohës së sotme, në vend që të konkurojmë për të mirë, kemi mbetur mbrapa, sepse këtë botë e duam më shumë se Allahun dhe të Derguarin e Tij. Ne kemi ndërruar rrugën e Pejgamberit a.s. me një botë të shkurtër dhe kemi harruar atë rrugë, e cila na çon ne në lumturi të pafund. Duhet të kemi parasysh këtë hadith, në të cilin Pejgamberi a.s. thotë: *“Nuk do të konsideroheni besimtarë të vërtetë përderisa të mos më doni mua më shumë së çdo gjë tjetër”*. Zoti na e mundësoftë që të shërbejmë sa më mirë në rrugën e Tij!

Cila mund të jetë rruga për propogandën islame në këtë kohë kur bota është materializuar dhe kthyer në gjendjen e një shoqërie konsumatore?

Zoti xh.sh. iu ka garantuar muslimanëve në Kurantin e madhëruar, ku thotë: *“Ata duan të shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, por Allahu e plotëson (e përhapë) dritën e vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët.”* Surja Saf, ajeti 8.

Është e vërtetë se feja e drejtë e Zotit xh.sh. do të dalë në fitore. Në ditët e sotme të gjitha sulmet e kundërshtarve

si psh.: sulmet e 11 Shtatorit dhe ndikimi i madh i propagandës së medias, janë munduar që t’ia mveshin Islamit. Nga të gjitha këto imponime negative që mundohen t’ia mveshin fesë islame, përsëri ai po ndikon në zemrat e njerëzve dhe është feja ajo, e cila po përhapet më së shumtë në botë. Kjo gjë tregon që kjo fe, është feja e vërtetë e Zotit xh.sh. dhe kështu do të mbesë. Është e vërtetë që kjo botë është materializuar dhe njerëzit janë dhënë pas parësë. Gjërat e kësaj bote njeriun nuk do ta ngopin, njerëzit do të vazhdojnë të konsumojnë, por një ditë, nga ky lloj egoizmi do të mërzhiten. Përse? Sepse kjo botë për ne është një provim, nuk është qëllimi ynë final. Qëllimi ynë final është Zoti i Madhëruar. Në Kurantin Famëlartë Zoti xh.sh. thotë: *“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër, përveç që të më adhurojnë.”* Surja Dharijatë, ajeti 56.

Njerëzit duke e parë këtë botë, do të kthehen tek Perëndia. Prandaj nuk duhet të friksohemi nga kjo botë materiale, shihni shtetet të cilat janë zhvilluar nga ana ekonomike si SHBA dhe Anglia. Por njerëzit që jetojnë në këto shtete, edhe nga pasuria e madhe që kanë, përsëri janë në kërkim të një kënaqësie. Sipas studimeve të bëra në SHBA dhe në Europë, shohim një rritje të fesë Islame. Falenderimi i qoftë Allahut, që në këto vende Islami është feja e cila po përhapet më shpejt. Ne duhet të jemi të vendosur dhe të sinqertë në përhapjen e Islamit. Allahu urdhëron e thotë: *“Allahu nuk e prish gjendjen e një populli, (nuk ua largon të mirat) për derisa*

ata ta ndryshojnë veten e tyre. Surja Rad, ajeti 11.

Nëse ne do të përpiqemi të kontribuojmë në përhapjen e Islamit, Zoti do të ndihmojë për lartësimin e Islamit. Për këtë lartësim duhet të flijojmë gjërat që posedojmë, të dashurit, madje edhe vehten tonë. Nuk duhet të frikësohemi nga zhvillimi shkencor, teknologjik dhe gjërat e kësaj bote, përkundrazi, këto duhet t’i shikojmë si dhuratë dhe mirësi për përhapjen e fesë. Të gjitha mundësitë dhe zhvillimet e kësaj bote nuk janë ndaluar nga i dashuri i Zotit xh.sh.

Inshalla këto mundësi mund t’i përdorim për përhapjen e fesë Islame deri në skajet më të larta. Zoti ynë na i pastroftë qëllimet tona në mënyrë që të jemi rob të vërtetë të tij. Zoti xh.sh. na udhëzoftë dhe na dhashtë mundësi, që këto të mira t’i përdorim në rrugën e tij. Amin...



TASAVVUFI OSE MISTIKA ISLAME
nga besimi në mirësi

Osman Nuri TOPBASH



Prezantimi i librit “Mistika Islame”

Ali Bardhi

Këto ditë lexuesi shqip-tar është prezantuar me librin “Tasavvufi ose Mistika Islame”, të autorit turk Osman Nuri Topbash. Autori nuk është aspak i panjohur për lexuesin e literaturës islame në gjuhën shqipe, sepse deri tani disa nga veprat e tij kryesore, që kanë parë dritën e botimit në shumë gjuhë të lindjes dhe perëndimit, madje së fundi edhe në gjuhën kineze, gjenden të përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

Ndërsa shfletojmë fletët e librit, shohim qartë mesazhin e autorit të atyre rreshtave, i cili nuk mëton të konkurojë në shkrimin me fjalë sa më të bukura të të vërtetave mistike, por mes rreshtash lexon se me sa përvujtë-ri ai digjet nga dëshira që kjo vepër të mund të orientojë në udhë të drejtë zemrat e shastisura, duke u dhënë të pinë një pikë ujë nga oqeani i të kuptuarit mistik.

Mistika islame, apo si njihet në terminologjinë islame, **tasavvufi**, është një ndër fushat më të hulumtuara dhe studiuara si në Lindjen myslimane, ashtu edhe në Perëndimin orientalist. Një e vërtetë e pamohueshme është edhe fakti se rreth kësaj fushe janë shkruar një mori veprash si në gjuhët lindore, ashtu edhe në ato perëndimore, përkrah botimeve kritike të veprave klasike të mistikëve myslimanë, por baticat dhe zbaticat brenda jetës dinamike dhe në mënyrë të veçantë panorama e njerëzimit të sotëm që rend me të madhe pas fitimit material duke anashkaluar botën e përsjirtshme dhe prehja e qetësia shpirtërore e shkatërruar vënë përpara njeriut çdo ditë një sërë nevojash të reja. Megjithëse çështjet mbeten të njëjta në thelb, pikëpamje dhe kërkesa të reja lindin. Për të plotësuar këto nevoja ash-

tu siç ka ngjarë përherë është ndjerë nevoja që çështjet e përsjirtshmërisë mistike islame të rishkruhen sipas nevojave edukative shpirtërore. Në mënyrë të veçantë në ditët e sotme kur në hapësira të gjera gjeografike myslimane shihen një sërë prirjesh për të deformuar me anë të komenteve vetjake thelbin dhe mësimin e mistikës islame, atëherë bëhet më e kuptueshme edhe rëndësia që mbart mesazhi i një vepre të tillë.

Ndërsa shfletojmë fletët e librit, shohim qartë mesazhin e autorit të atyre rreshtave, i cili nuk mëton të konkurojë në shkrimin me fjalë sa më të bukura të të vërtetave mistike, por mes rreshtash lexon se me sa përvujtëri ai digjet nga dëshira që kjo vepër të mund të orientojë në udhë të drejtë zemrat e shastisura, duke u dhënë të pinë një pikë ujë nga oqeani i të kuptuarit mistik. Këtë të vërtetë të përluljes e shpreh qartë edhe studiuesi i mirënjohur mysliman i shekullit tonë Muhammed Hamidullahu në letërkëmbimin e tij, ku mes të tjerash shprehej se:

“Mënyra që më kishin edukuar qe ajo racionale. Studimet në fushën juridike dhe hulumtimet më kishin mësuar se duhet të refuzoja çdo gjë që nuk mund ta fusësh mes mureve të përkufizimit. Pa dyshim që detyrimet e fesë

Islame si: namazin, agjërimin etj., i kryeja me përpikmëri bazuar në urdhrat e shariatit tek i cili besojta, por nuk kisha kërkuar ndonjëherë që të gjeja në to shijen e përshpirtshmërisë, por tabloja me të cilën u ballafaqova kur nisa jetën time brenda shoqërisë perëndimore, për më tepër në një qytet siç qe Parisi, më la të shastisur. Të krishterët aty nuk motivoheshin aq shumë nga pikëpamjet e kelamit dhe shkencave juridike islame që të përqaфонin fenë Islame, aq sa ndikoheshin nga gjuha narrative e Ibn Arabiut dhe Mevlanasë.” (M. Aziz Lahbâbî, *Islâm Şahsiyetçiliği*, përkth. İ. Hakkı Akın, s. 114-115, poshtëshënimi 8. Ist. 1972. Ky poshtëshënim është teksti i letres që i dërgoi me datë 27 shtator 1967 Muhammed Hamidullahu përkthyesit. Shih Mustafa Kara, *Metinlerle Günümüz Tasavvuf Hareketleri*, s. 542-543)

Në këtë vepër, pasi është trajtuar në një pamje të përgjithshme mistika islame si një e tërë, autori është përpjekur edhe të shpjegojë temat thelbësore të mendimit dhe jetës mistike siç janë njohja hyjnore (marifetullah), dashuria ndaj Allahut, pastrimi i vetvetes, pastrimi i zemrës, metodologjia mistike e të tjera çështje si këto. Janë të shumtë edhe shembujt në sjellje të figurave të historisë islame, të cilët janë trashëgimtarët e profetëve, por mbi të gjitha shembujt më të spikatur vijnë nga jeta e peygamberit Muhammed (a.s.) Vende-vende shohim edhe se autori është përpjekur të parashtojë informacione në trajtë kundërpërgjigjeje ndaj një grup mëdyshjesh dhe kundërshtishë, që u bëhen pikëpamjeve të thella dhe të spikatura të mësimi islam, por përherë duke e trajtuar çështjen në nivel diskutimi dhe pa pasur në qe-

ndër të diskutimit individë të veçantë.

Në vepër është theksuar veçanërisht disa herë e vërteta se kjo botë e madhe shpirtërore nuk ka aspak të bëjë me praktikatat e mangëta dhe të pavend që mund të shihet se kryejnë grupe të caktuara njerëzish nga padituria, individë që janë shumë larg nga edukata shpirtërore në të cilën frymëzon mistika e pastër islame.

**“Mistikët
myslimanë i përnjajnë kompasit.
Këmba e fiksuar e kompasit për ta është sheriatit,
ndërsa me këmbën lëvizëse heqin vija në tarikat
sekush sipas thellësisë shpirtërore që ka”**

Mistika islame synon që ta përsosë njeriun dhe në këtë mënyrë të bëjë që ai të mbështillet nga lumturia e përjetshme në botën tjetër, duke e pastruar atë në përputhje me ajetet Kur’anore dhe hadithet profetike. Ashtu siç na e bën të ditur edhe Allahu në Kur’an pasi ka radhitur një sërë betimesh që i kanë hije Madhështisë së Tij: “Ai që e ka pastruar vetveten, ka shpëtuat; ndërsa ai që e ka mbytur veten në të këqija ka humbur” (Kuran, Shems, 1-10)

Vepra “Mistika islame nga besimi në mirësi” mëton të shpjegojë me bukuritë e fjalëve, sjelljeve dhe veprimeve të peygamberit Muhammed (a.s.), shokëve të tij, tabiinëve

dhe personaliteteve të historisë Islame të vërtetën e nevojës së pastrimit të vetvetes.

Mesazhi që jep autori i kësaj vepre përputhet katërcipërisht me fjalët e Xhelaledin Rumiut:

“Ne mistikët myslimanë i përnjajnë kompasit. Këmba e fiksuar e kompasit për ne është sheriatit, ndërsa me këmbën lëvizëse heqim vija në tarikat sekush sipas thellësisë shpirtërore që ka”.

Kjo vepër duke shpallur me zë të lartë se botëkuptimi që e konsideron mistikën islame si një metodologji apo rrugë të ndryshme nga mësimet themelore të fesë Islame është kryekëput i gabuar dhe qëllimkeq është shkruar me qëllim që të shprehë hapur, qartë dhe shkoqur se sa e rëndësishme është nevoja e të jetuarit të besimit dhe rregullave të tilla brenda prehjes së përshpirtshme islame.

Një tjetër synim i rreshtave të këtij libri duket të jetë edhe kurorëzimi i besimit dhe praktikimit të jetës fetare me vetëdijshmërinë që të fal ih-sani që është lëshimi rrënjë nëpër zemra i ndjesisë, se në çdo moment jemi nën kontrollin hyjnor, pasi mistika islame e vërtetë është të jetuarit brenda thellësisë së mësimëve dhe urdhrave të Kur’anit fisnik dhe traditës së bekuar profetike (sunnat) duke përjetuar nga urtësitë dhe enigmat që të shpall jeta e përshpirtshmërisë fetare. Çdo fjalë, sjellje dhe veprim që mbetet përjashta përmbajtjes së librit hyjnor, Kur’anit dhe traditës profetike është e papranueshme dhe e refuzuar.



TOLERANCA DHE DIALOGU NDERNJEREZOR E NDERFETAR NE MESIMET ISLAME

Mr. Xhabir HAMITI

Toleranca dhe barazia njerëzore janë fryt i njohjes hyjnore në formën e saj të dli-rë. Zoti na ka pajisur qëllimisht me njohuri hyjnore, në mënyrë që të kuptojmë vetetven dhe rolin tonë në shoqërinë njerëzore dhe si rrjedhojë e kësaj të zhvillojmë marrëdhënie njerëzore të bazuara në tolerancë dhe në barazi.

Larmia, ndryshueshmëria dhe llojshmëria e njerëzve është akt i qëllimshëm i Zotit për njohjen dhe afrimin mes tyre, e jo për të treguar ose shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit.

Ndjenja për besim në një fuqi absolute të quajtur Zot ka qenë pjesë shpirtërore e njeriut që nga momentet e para të daljes së tij mbi sipërfaqen e tokës. Kjo ndjenjë është dhe do të vazhdojë të jetë prezente, e pandërprerë te krijesa e quajtur njeri. Historia nuk njih njerëz të cilët nuk kanë besuar në një fuqi absolute, të cilën e kanë përcaktuar dhe emëruar sipas shkallës së pranimit të tyre. Me zgjedhjen e profetëve nga Zoti dhe librave hyjnore-qiellorë, njerëzit ftohen që të besojnë në besim të drejtë, në Një Zot.

Ithtarë të këtyre profetëve dhe këtyre librave janë sot ithtarët e tri feve më të mëdha monoteiste në botë. Përmes librave hyjnorë, krijesa njeri është ftuar që gjithnjë të jetë në shkallën e duhur të dëgjimit dhe zbatimit të porosive të Zotit, në mënyrë që të jetojë në dashuri, mirëqenie, në paqe dhe liri me veteven, familjen, rrethin dhe shoqërinë njerëzore në përgjithësi.

Toleranca dhe barazia njerëzore janë fryt i njohjes hyjnore në formën e saj të dli-rë. Zoti na ka pajisur qëllimisht me njohuri hyjnore, në mënyrë që të kuptojmë vetetven dhe rolin tonë në shoqërinë njerëzore dhe si rrjedhojë e kësaj të zhvillojmë marrëdhë-

nie njerëzore të bazuara në tolerancë dhe në barazi.

Larmia, ndryshueshmëria dhe llojshmëria e njerëzve është akt i qëllimshëm i Zotit për njohjen dhe afrimin mes tyre, e jo për të treguar ose shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit. Këtë e theksoi Kur'ani që në fillim të shpalljes së tij:

“O ju njerëz, vërtetë! Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe prej një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete. Ndërsa më i ndershmi ndër ju është ai, i cili më shumë ka frikën e Zotit. Zoti është i gjithëdijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë” (49:13)

Bazuar në këtë citat kur'anor gjeneza njerëzore ka një burim dhe një Krijues. Ndarja në fise, etnitete, popuj të ndryshëm është zgjedhje e Zotit, andaj si e tillë duhet pranuar dhe repektuar.

Liria e besimit:

Kur'ani është plot deklarata, të cilat tregojnë se besimi në këtë apo në atë besim është çështje personale e individit dhe zgjedhje tij e lirë:

1. ***“Në fe nuk ka dhunë”*** (2:256)

2. ***Thuaju njerëzve “E vërteta është nga Zoti i juaj,***



e kush të dojë le të besojë , e kush të dojë le të mohojë"

3. *"Ti je i obliguar që t'ua përkujtosh faktet dhe argumentet e Zotit njerëzve - ti nuk je mbizotërues i tyre."*

4 *"Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. E përse atëherë t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë". (Junus, 99)*

Dhuna në përgjithësi nuk është pjesë e mësimave dhe parimeve hyjnore burimore islame. Njeriu sipas mësimave kur'anore, plotësisht është i lirë të zgjedhë besimin e tij shpirtëror. Historia asnjëherë nuk ka shënuar ndonjë rast kur Muhammedi a.s. ose shokët e tij kanë përdorur dhunë ose shtrëngim ndaj njerëzve për të pranuar fenë islame. Islami nuk është identifikuar dhe nuk guxon të identifikohet në bazë të një mendimi ose

grupi të caktuar të njerëzve. Ai bazohet në parimet e Kur'anit dhe thëniet e shëndosha të Muhammedit a.s. Nëse një grup njerëzish të caktuar kanë përdorur ose përdorin fenë si mjet për të arritur ose realizuar qëllimet dhe objektivat e veta përmes dhunës, kjo asesi nuk do të lejohej që përmes atij grupi të identifikojmë të gjithë pjesëtarët e atij besimi, ose atë besim ta shpallim të tërin si fe të dhunës, intolerancës.

Pranimi dhe respektimi i feve më të hershme

Detyrë e çdo besimtari të fesë islame është që të pranojë dhe t'u besojë shpalljeve të hershme qiellore, të cilat edhe i ka emëruar me emra: Tevrat Zebur dhe Inxhil.

Kur'ani fton për besim në librat e hershëm qiellore si

dhe në profetët e dërguar para Muahmmedit a.s. Ky besim është njëri nga themelet bazë mbi të cilat ngrihet feja islame. Në gjithë literaturën islame të shkruar gjatë gjithë historisë, asnjëherë nuk do të mund të gresh fjalën më të vogël fyese ndaj pejgamberëve, profetëve të hershëm. Këtu më poshtë do të përmend disa versete të librit tonë të shenjtë në lidhje me këtë.

1. *Besimtarë të Zotit janë "Ata të cilët besojnë në atë që të shpallet ty (Muhammed) dhe në atë që është shpallur para teje (Tevrati, Zeburi dhe Inxhili)" (2: 4)*

2. *"Thuaj: Ne besojmë në Zotin dhe në atë që na është shpallur neve, dhe në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is-haku dhe të fiseve të tyre, (besojmë) në atë që i është dhënë Musait dhe Isaut, (besojmë) në gjithë atë që i është dhënë pej-*

gmaberëve të Zotit, ne nuk bëjmë dallim mes tyre dhe vetëm Zotit një i përulemi “ (2:136)

3. Ju mos fyeni ata të cilët nuk e besojnë Zotin Një – idhujtarët , e si hakmarrje ata pastaj të fyejnë Zotin nga armiqësia, duke mos ditur. Ne i kemi zbuluar çdo populli veprimin e vet, pastaj e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai shpërblen për atë që vepruan.” (6:108)

Në favor të asaj që Kur’ani i njej popujt e tjerë shkon edhe njohja e profetëve dhe librave të tyre. Kur’ani, në të vërtetë, nuk bën kurrfarë dallimi në mes të profetëve të Zotit (xh. sh.) duke filluar prej Ademit nëpërmjet Ibrahimit e Musait e deri te Muhammedi (s), ndërsa për Isain (a. s.) – të birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit, që e kanë para tyre – thotë:

“Ne dërguam në gjurmët e profetëve – Isain. Dhe ne i dhamë atij Inxhilin (Ungjillin), në të cilin ka udhëzim e dritë, vërtetues i Tevratit, të cilin e kanë para vetes – udhërrëfim dhe këshillim për ata që i druajnë Perëndisë”. (el-Maide, 46-47)

Zhvillimi i marrdhënieve shoqërore dhe bashkjetesa me pjesëtarë të besimeve të tjera

Ka pasur dhe ende ka zëra të pamatur dhe të paargumentuar, të cilët thërresin për të bojkotuar shoqërimin me pjesëtarët e besimeve të tjera. Në mësimet burimore islame nuk ka asnjë pengesë që të pengojë shoqërimin dhe zhvillimin e marrdhënieve shoqërore me pjesëtarë të besimeve të tjera. Përderisa islami lejon martesën me pjesëtarë të besimeve të tjera, atëherë si do të mund të thuhet se ndalon shoqërimin me

pjesëtarë të besimeve tjera, kur dihet se martesë është shoqërim më i fortë dhe më i afërt mes dy individëve sesa çfarëdo shoqërimi e shoqërim tjetër.

I dërguari i Zotit, Muhammedi a.s. gjatë jetës së tij kishte marrë për bashkëshorte një grua të fesë hebreje me emrin **Xhujejra bint el-Harith el-Mustalakije** dhe një të asaj krishtere me emrin **Maria El-Kibtije**. Është shumë domethënës fakti me këtë rast se që të dyja kanë mbajtur fenë e tyre gjatë gjithë jetës së tyre, pa qenë të detyruara ta ndrojnë atë.

Nga historia islame kemi shumë shembuj të rëndësishëm për respektimin e njeriut- para së gjithash si krijesë e Zotit. Në literaturën burimore islame është i njohur rasti kur Pejgamberi Muhammed ndërsa ishte ulur me shokë, pranë tij kishte kaluar një grup njerëzish, të cilët mbi supet e tyre po bartnin një të vdekur pjesëtar i hebrenjve. Në shenjë respekti është ngritur në këmbë gjersa ka parakalur kufoma. Një nga të pranishmit i ishte drejtuar:

“ O i Dërguar i Zotit! Pse u ngrite në këmbë, i vdekuri ishte jahudi, nuk ishte nga ithtarët tanë! Ai u përgjigj : A nuk ishte ai njeri- krijesë e Zotit siç jemi edhe ne ?!

Po ashtu është i njohur edhe një shembull tjetër shumë domethënës i Pejgamberit, kur një grupi të besimtarëve katolikë, të cilët kishin ardhë për vizitë në Medine nga Habeshi- Etiopia e sotme me qëllim që të kuvendojnë me të, pas një qëndrimi disa ditësh në Medine ata i kishin shtruar Muhammedit kërke-

Në këtë kontekst është me rëndësi të përmendet Karta e Medinës, të cilën e kishte hartuar Muhammedi me shokët e tij, e cila luante rolin e kushtetutës së shtetit të sotëm në atë kohë. Përmes kësaj karte siguroheshin plotësisht të drejtat e hebrenjve dhe të krishterëve, të cilët ishin banorë të Medinës.

sën që t’u sigurohet një vend për lutje. Në mungesë të ndonjë hapësire të përshtatshme Muhammedi u kishte ofruar xhaminë e tij !

Në këtë kontekst është me rëndësi të përmendet Karta e Medinës, të cilën e kishte hartuar Muhammedi me shokët e tij, e cila luante rolin e kushtetutës së shtetit të sotëm në atë kohë. Përmes kësaj Karte siguroheshin plotësisht të drejtat e hebrenjve dhe të krishterëve, të cilët ishin banorë të Medinës.

Muhammedi a.s. para se të hartonte Kartën e Medinës ishte konsultuar me ithtarët e tij si dhe me jomyslimanët. Fiset hebreje sidomos përmes kësaj karte bazuar në nenin 29-30 ishin bërë pjesë e Ummes, Bashkësisë Myslimane. Ata gëzonin të drejtën, që lirisht të shprehin bindjet e tyre fetare dhe u lejohej të merrnin pjesë në luftë përkrah mysli-manëve për të mbrojtur qytetin nga politeistët.

“Drejtësia mban qiellin dhe tokën”, thoshte Muhammedi (a.s).

Çështje të përbashkëta myslimanëve dhe pjesëtarëve të feve qiellore

Kur'an: “O ithtarë të Librit! Eja-ni të bashkohemi rreth gjërave të përbashkëta edhe për ju, edhe për ne: të adhurojmë vetëm Perëndinë e mos t’i bëjmë asnjë shok Atij dhe mos ta marrim njëri-tjetrin për Zot, në vend të Perëndisë”. (Ali Imran, 64)

Islami e sheh të rëndësishëm zhvillimin e dialogut me ithtarët e librave të hershëm qiellore, pikërisht për faktin e prezencës së shumë gjërave të përbashkëta qoftë në sferën e besimit apo të kuptimit dhe zhvillimit të jetës në përgjithësi.

Hebraizmi, Krishtërimi dhe Islamizmi janë tri degë të një rrënje. Kur i krahasojmë mësimet e tyre zbulojmë gjëra të përbashkëta, të cilat mund t’i quajmë:

E mirë e përbashkët e tri besimeve.

Nga këto të mira mund të veçojmë:

1. Besimi në një Zot
2. Shpallja nga Zoti
3. Tradita e profetëve
4. Besimi ne ditën e gjykimit
5. Jeta në varreza
6. Lutja drejtuar Zotit
7. Thirrja për bamirësi, mëshirë dhe falje
8. Organizimi dhe respektimi i jetës familjare

9. Shpresa për shpëtimin e shpirtit, duke bërë vepra të mira etj.

Përfundim

Drejtuesit e botës moderne, intelektualët kudo që janë dhe të gjithë njerëzit me influencë, duhet të japin kontribut pozitiv në ruajtjen e qetësisë dhe respektimit ndërligjioz, ngaqë së fundi duhet të kuptohet se Krijuesi i të gjithëve është vetëm një Zot edhe pse ne nuk e adhurojmë atë përmes një rruge të vetme. Sigurisht Zoti do të na gjykojë, nëse ne fusim huti dhe përçarje mes njerëzve ne emër të fesë, e cila mund të shkaktojë edhe gjakderdhje në tokë.

Si krijesë e vetme me përgjegjësi siç është njeriu mbi sipërfaqen e tokës duhet të jetë gjithmonë në nivel të duhur dhe në shërbim të së mirës njerëzore.

Ftesa për njohje, dialog dhe bashkëpunim është dety-

rë e përbashkët e gjinisë njerëzore.

Dialogu me të tjerët nuk është vetëm hap i dëshiruar, por i detyrueshëm.

Synime dhe ide humane e fisnike janë vetëm ato, të cilat për qëllim final, kanë mirëqenien dhe lumturinë e përbashkët të të gjithë njerëzve pa dallim race, kombësie e feje. Këto janë dallime të lindura bashkë me njeriun dhe në to nuk ka asgjë të keqe. Të jesh ndryshe nga të tjerët, nuk është e metë, mëkat as krim dhe askush nuk është përgjegjës për këtë. Urrejtja, e cila buron nga dallime të tilla, është njëra nga fatkeqësitë më të mëdha të njerëzimit në histori, prej nga lindi dhe racizmi, nazizmi, shovinizmi etj.



Dashuria ndaj pjesëtarëve të Familjes Profetike (Ehl-i bejt)

Osman Nuri TOPBASH

“Duajeni Allahun e Lartësuar për hir të begative me të cilat jeni furnizuar. Mua të më doni për shkak të dashurisë që keni për Allahun. Rrethin tim familjar (ehl-i bejt) duajeni, sepse ushqeni dashuri për mua.” (Tirmidhi, Menakib, 31/3789)

Dashuria dhe miqësia

Dashuria dhe miqësia burojnë nga të përbashkëtat që ndajmë në ndjesitë dhe mënyrën e jetesës. Sa më shumë të jenë pikat e përbashkëta aq më shumë shtohet edhe dashuria në varësi të tyre.

Allahu i Lartësuar i domë shumë robtë e Tij tek të cilët manifestohen cilësitë e hijshmërisë dhe u shfaq atyre afri dhe miqësi më të veçantë.

Fakti që shpirti i Jakubit anonte më shumë drejt Jusufit (a.s.) në mesin e 12 bijve që kishte, qe rezultat i daljes në pah më shumë tek Jusufi i ndjesive, këndvështrimeve, talenteve dhe karakteristikave të tjera që zotëronte Jakubi, që **do të thotë se miqësia, buron kur dashuruesi sheh tek i dashuruari veçoritë dalluese që ai vetë gëzon.**

Në analogji me këto që thamë edhe familja e nderuar e të Dërguarit të Allahut, që janë të afërmit e tij, janë personat e bekuar në të cilët dinin në pah më shumë se tek çdokush të jetuarit dhe cilësitë e Profetit tonë (a.s.), sepse pjesëtarët e familjes profetike (ehl-i bejt) qenë personalitetet e dalluara që u bënë dëshmitarë për shkak të afërsisë së tyre ndaj Tij, të dritës së fytyrës, rrjedhshmërisë së fjalës, të butësisë së sjelljeve, të elokuencës së jashtëzakonshme të ligjërimit të Profetit Muhammed (a.s.).



Ata janë më të dashurit e të Dërguarit të Allahut (a.s.), që u veshën me mënyrën e të jetuarit të Tij, u stolisën me moralin e bukur të Tij, u edukuan nën kujdesin e Tij.

Për këtë arsye, ata personalitete të larta paguan me aq dëshirë përjetimin e sa e sa vuajtjeve të rënda përgjatë jetës për hir të moshumbjes së asnjë çasti të të qëndruarit larg nga dashuria e Tij dhe për të merituar dashurinë e Zotërisë sonë (a.s.). Edhe ata kaluan përmes një rrethi të ngjashëm me atë të vuajtjeve dhe mundimeve që përjetoj Profeti (a.s.).

Pasi njeriu e paguan vlerën më të madhe për hir të gjësë ndaj të cilës ushqen da-

myslimane që janë përme-ndorja e sinqeritetit dhe përkushtueshmërisë në dashuri dhe vartësi ndaj Pejgamberit (a.s.)...

Ehli Bejt para së gjithash nënkupton pjesëtarët e familjes së Profetit Muhammed (a.s.) Në këtë kontekst ehli bejti janë profeti Muhammed (a.s.) dhe familja e tij, Aliu, Xhaferi, Akili, Abbasi dhe familjet e tyre. Ashtu siç është një detyrim mbi të gjithë besimtarët të këndojnë salavate mbi të Dërguarin e Allahut (a.s.), ashtu është edhe detyrim i përbashkët që i përfshin të gjithë ata të ushqejnë respekt dhe dashuri në zemrat e tyre ndaj ehli bejtit, sepse rezultati më i natyrshëm i dashurisë që ushqen njeriu ndaj

veshjes së personit që dashurohet me pasion krijojnë efekt mbi shpirtin. Nga ky lloj i përjetimit shpirtëror rezultojnë edhe dashuria dhe respekti që tregojmë ndaj mjekrës së nderuar dhe petkut të bekuar të Profetit Muhammed (a.s.)

Për këtë arsye, edhe dashuria ndaj Allahut përbën majën më të lartë të ndjenjës së dashurisë. Një shkallë më poshtë është dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ata që mbruhen me dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.) gjejnë prehje në jetën e bukur të mbështjellë nga gëzimi që të dhuron dashuria e ehli bejtit, brenda të vërtetave që shprehëm më lart.

Zejd bin Erkam (r.a.) rrë-

Ehli Bejt para së gjithash nënkupton pjesëtarët e familjes së Profetit Muhammed (a.s.) Në këtë kontekst ehli bejti janë profeti Muhammed (a.s.) dhe familja e tij, Aliu, Xhaferi, Akili, Abbasi dhe familjet e tyre.

shuri, por vlera më e madhe që paguhet në këtë jetë është ajo që jepet për shkak të dashurisë hyjnore.

Ja pra edhe ehl-i bejti prezanton një majë të rrallë në mesin e heronjve të Islamit që e paguan brenda një ekstaze të madhe besimi dhe me kënaqësi vlerën e dashurisë hyjnore.

Ehl-i Bejti

Pjesëtarët e oxhakut të bekuar të Dritës së Krijësive Muhammedit (a.s.)... Brezi i ndershëm që e formuan personalitetin e tyre duke u mbrojtur me moralin, diturinë, urtësinë dhe virtytet profetike... **Familja e Muhammedit**, zotërinjtë e bashkësisë

një personi të caktuar është përfshirja në këtë dashuri të çdokujt dhe çdo gjëje që ka lidhje me atë që dashuron. Ato mund të jenë individë, objekte dhe sende, sjellje, madje edhe vende gjeografike. Për shembull në qoftë se ju e dashuron shumë një person, sa herë që të shihni sjellje dhe qëndrime karakteristike të tij tek një individ tjetër, juve u vjen ndërmend njeriu që doni dhe i përfshini brenda rrethit të dashurisë edhe personat që i gëzonin ato sjellje dhe huqe vetëm e vetëm, sepse ata u kujtojnë të dashurin tuaj. Ky rezultat shfaqet sipas shkallës së dashurisë. Mënyra e të ndernjurit, të ngriturit në këmbë, madje edhe karakteristikat e

fen se:

Një ditë prej ditësh kur qemë në krye të ujërave të Humit që gjenden mes Mekkes dhe Medines, i Dërguari i Allahut u ngrit në këmbë dhe na mbajti një ligjërim. Pasi e falënderoi dhe madhëroi emrin e Allahut, na këshilloi dhe pastaj tha:

“– O njerëz! Edhe unë jam një njeri ashtu siç jeni edhe ju. Së afërmi edhe mua do të më vijë ëngjëlli i vdekjes dhe do t'i përgjigjem ftesës së tij për të shkuar në botën tjetër. Po ju lë dy gjëra të rëndësishme. Njëri është Kurani, libri i Allahut, burim dritë dhe udhërrëfyes që e shpie njeriun drejt të vërtetës. Kapuni pas mësimëve të tij dhe mos i lëshoni ato!..»

Pasi na dha edhe disa këshilla të tjera në lidhje me varësinë tonë ndaj Kuranit, Profeti (a.s.) vazhdoi dhe tha:

– *Po ju lë pas edhe familjen time. Kini frikë Allahun dhe respektojeni familjen time. Kini frikë Allahun dhe respektojeni familjen time!*

Ata që gjendeshin aty e pyetën Zejdin:

– Kush përfshihet në familjen e Profetit o Zejd? A nuk janë edhe bashkëshortet e tij pjesëtarë të familjes profetike (ehli bejt)?

Ai u përgjigj:

– Edhe bashkëshortet e Tij janë pjesëtarë të familjes profetike (ehli bejt), por në thelb në janë Aliu, Akili, Xhaferi, Abbasi dhe familjet e tyre të cilët e kanë të ndaluar kategorikisht (haram) të marrin sadaka pas vdekjes së Profetit. (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 36)

Selmani është nga tanët

Bëhet fjalë që të jesh edhe jo biologjikisht pjesëtar i familjes profetike (ehli bejt). Kështu që, Selman Persiani ekspozonte një personalitet Islam aq të bukur sa që ensarët dhe muhaxhirët kërkonte secili për vete që ta përfshinte në grupin e tij duke thënë se :

– Selman është i yni.

Pejgamberi Muhammed (a.s.) e nderoi atë kur nga buzët e tij dolën fjalët:

– *Selmani është nga tanët, ai është i ehli bejtit!* (Ibn Hisham, III, 241; Vakidi, II, 446 – 447; Ibn Sad, IV, 83; Ahmed, II, 446 – 447; Hejthem, VI, 130)

Kjo do të thotë se kushti më i rëndësishëm që të jesh pjesëtar i familjes profetike (ehli bejt) është **“përkushtimi fetar”**. Pra, përveç të qenit

pjesëtar i familjes profetike (ehli bejt) në aspektin biologjik, ekziston edhe përkatësia shpirtërore në këtë familje të nderuar, kjo është shkalla më e nderuar për shpirtërat e besimtarëve.

Në këtë aspekt edhe jeta e Muadh bin Xhebelit i njohur mes sahabeve për virtytin dhe devotshmërinë e lartë përbën një shembull të goditur.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ndërsa po e dërgonte Muadh bin Xhebelin si vali në Jemen e pat përcjellë personalisht deri në lagjet e jashtme të Medines për ta përshëndetur dhe uruar udhë të mbarë. Muadhi shkonte rrugës kaluar mbi kafshë, ndërsa Profeti (a.s.) ecte në këmbë. Pasi i dha disa këshilla Muadhut i tha:

– *O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk më sheh më në jetë! Të bie rruga dhe kalon përpara xhamisë dhe varrit tim!*

Me të dëgjuar këto fjalë Muadhin e mbytën lotët. I Dërguari i Allahut i tha:

– *Mos qaj o Muadh!* - dhe duke e kthyer fytyrën drejt Medines tha:

– *Ata që janë të afërmit e mi nga njerëzit janë të devotshmit që ia kanë frikën Allahut kushdo dhe kudo qofshin ata.*¹

Një tjetër shembull në këtë pikë është edhe Usame bin Zejdi. Një ditë Aliu dhe Abbasi erdhën tek Profeti dhe e pyetën se cilin donte më shumë nga pjesëtarët e fafësisit të tij.

Kur i Dërguari i Allahut u përgjigj:

1 Ahmed, V, 235; Heysemî, Mecmau'z-Zevâid, Beyrut 1988, IX, 22.



Sahabiun e njohur Zejd bin Erkamin e pyetën:

– Kush përfshihet në familjen e Profetit o Zejd? A nuk janë edhe bashkëshortet e tij pjesëtarë të familjes profetike (ehli bejt)?

Ai u përgjigj:

– Edhe bashkëshortet e Tij janë pjesëtarë të familjes profetike (ehli bejt), por në thelb në janë Aliu, Akili, Xhaferi, Abbasi dhe familjet e tyre të cilët e kanë të ndaluar kategorikisht (haram) të marrin sadaka pas vdekjes së Profetit.

(Muslim, Fedailu's-Sahabe, 36)

Zotëria ynë, Krenaria e Gjithësisë ushqente një dashuri krejt të veçantë për të bijën Fatimen (a.s.) Asnjë bijë nuk mund ta dojë aq shumë të atin e saj aq sa e donte Fatimeja Pejgamberin (a.s.). Asnjë at nuk mund ta dojë bijën e tij aq shumë sa e donte Pejgamberi (a.s.) të bijën Fatimën. Për këtë arsye ne mbajmë mendimin se vënia e emrit të Fatimesë njërës prej bijave në çdo familje myslimane është një burim begatish dhe mëshire nga aspekti i afërsisë me Profetin (a.s.)



– *Time bijë Fatimen. Atëherë i thanë:*

– *O i dërguar i Allahut. Ne nuk po të pyesim ty se cilën do më shumë ndër gratë!*

Këtyre fjalëve Profeti iu përgjigj duke u thënë:

– *Më i dashuri nga të mitë është personi mbi të cilin refleksuan begatia e Allahut dhe imja, Usame bin Zejd... (Tirmidhi, Menakib, 40/3819)*

Ja kështu me këto fjalë ai që pohoi se: *“Nuk ka dyshim se miqtë e mi janë të devotshmit.”* (Ebu Davud, Fiten, 1/4242)

Zotëria ynë, Krenaria e Gjithësisë, bëri të qartë se ishte **“përkushtimi fetar”** kushti më i rëndësishëm i përkatësisë ndaj Tij dhe shkak i vetëm i epërsisë në agorën e Allahut.

Hakim et-Tirmidhi bën të ditur se miqtë e Allahut janë konsideruar përherë si pjesëtarë të familjes profetike (ehli bejt) meqënëse ata përherë e angazhonin vetveten me përmendjen e Allahut, por kjo afërsi e tyre me familjen nuk qe biologjike, por shprehje e afërsisë shpirtërore dhe afektive. “Sepse i Dërguari i Allahut është dërguar të ngulë në zemrat e njerëzve përmendjen e Allahut. (Hakim et-Tirmidhi, *Kitabu Hatmi'l-Evlja*, fq. 345–346)

Atëherë në përputhje edhe me hadithin fisnik:

“Njeriu është bashkë me atë që e do”, të jesh i afërt me Zotërinë tonë, të përfshihesh brenda hallkës së miqësisë me Të dhe brenda ehl-i bejtit, na kushtëzon në krye të çdo gjëje, që zemrën ta mbushim me dashurinë dhe frikën nga Allahu, pra që zemra jonë të bashkohet me Allahun dhe

të Dërguarin e Tij. Shenja treguese më e qartë e kësaj jete shpirtërore e shpreh vetveten në adhurimet dhe sjelljet tona.

Edukata e ehl-i bejtit

I Dërguari i Allahut (a.s.) dëshironte që pjesëtarët e familjes për të cilët i dridhej zemra nga mëshira, të jetonin një jetë përkushtimi që do të ishte shembull për njerëzimin. E shtynte përherë Ehli bejtin, të cilin e konsideronte të veçantë, drejt përkushtimit të sinqertë dhe të thellë me një përpikmëri, thjeshtësi dhe butësi, që do ta përjetonin si në këtë botë dhe në botën tjetër.

Duke pohuar se **“Jeta e vërtetë është ajo në botën e përtejme (ahiret)”**, i orientonte ata më shumë se të tjerët drejt asketizmit e përshtetshmërisë edhe në çështjet që konsiderohen fakultative (mubah) fetarisht, duke patur merak se mos në ta fillonte të dhënit pas kësaj bote.

Zotëria ynë, Krenaria e Gjithësisë ushqente një dashuri krejt të veçantë për të bijën Fatimen (a.s.) Asnjë bijë nuk mund ta dojë aq shumë të atin e saj aq sa e donte Fatimeja Pejgamberin (a.s.). Asnjë at nuk mund ta dojë bijën e tij aq shumë sa e donte Pejgamberi (a.s.) të bijën Fatimën. Për këtë arsye ne mbajmë mendimin se vënia e emrit të Fatimesë njërës prej bijave në çdo familje myslimane është një burim begatish dhe mëshire nga aspekti i afërsisë me Profetin (a.s.)

Ndërsa në një anë Zotëria ynë Muhammedi (a.s.) e përgëzoi të bijën e tij si një nga gratë më të virtutshme

të xhenetit² dhe u shpreh se "Fatimeja është nga gjaku im. Kush e brengos Fatimenë është si të më ketë brengosur mua, kush e gëzon atë është si të më ketë gëzuar mua"³, nga ana tjetër i tërhiqte vëmendjen çdo çast me këto fjalë që të mos tregohej indiferente rreth shpëtimit në botën tjetër:

"O Fatime! Shih të shpëtosh veten nga xhehenemi! Unë nuk kam forcë t'ju shpëtoj nga dënimi i Allahut nëse e meritoni atë." (Muslim, Iman, 348, 351)⁴

Profeti Muhammed (a.s.), i cili dëshironte nga Fatimeja që të jetonte në përkorësi dhe në kushtet minimale të përfitimtimit nga të mirat e kësaj bote megjithëse ajo ishte anëtarja

shiti gjerdanin me paratë e të cilit pagoi lirimin e një skllavi, megjithëse vetë qe nevojtare për ato para. Profeti Muhammed (a.s.) mbeti shumë i kënaqur, kur mësoi se ç'kishte bërë e bija. (Nesai, Zinet, 39)

Fatimeja qe një zonjë e dobët fizikisht. Punët e shtëpisë ishin të shumta dhe lodhëse. Fatimeja ndizte oxhakun dhe gatuante ushqimin. Xixat që i binin mbi rrobë teksa i frynte zjarrit nganjëherë i digjnin rrobën dhe e bënë bira-bira të vogla. Teksa pastronte shtëpinë bëhej pluhur e tëra. Duart i bëheshin plagë kur shkonte të bluante miell në mulli dhe shpina i rrjepej nga shakujt e ujit që mbante.

Një herë të Dërguarit të

Fatimeja e bindur nga këto fjalë tha:

– *Jam e kënaqur me Allahun dhe të Dërguarin e Tij!*

Kështu Profeti nuk e pa me vend që e bija të kishte një shërbëtor që t'i kryente asaj punët e shtëpisë. (Ebu Davud, Haraxh, 19-20/2988)

Në një raportim, janë përcjellë edhe këto fjalë të Pejgamberit Muhammed (a.s.):

"Beto hem për Allahun se unë nuk mund të të jap një shërbëtor ty, kur nuk i kam gjetur një zgjidhje ehli suffes në xhami, të cilët lidhin gurë për barku nga uria që kanë ngase nuk kanë ç'të hanë. Paratë që do të marr nga lirim i skllëveve të luftës do t'i

Enes bin Malikū ka thënë:

"Nuk kam parë person tjetër që ishte aq i dashur me anëtarët e familjes së tij se sa profeti Muhammed (a.s.)."

më e dashur e familjes profetike, kërkonte nga e bija që të ardhurat materiale që i kalonin nevojat e përditshme t'i ndante për bamirësi. Ai nuk i linte vend as tendencës më të vogël për këtë botë, që do të lindte në shpirtin e saj duke e orientuar përherë fisniken e tij të dashur drejt Allahut dhe ahiretit.

Një ditë prej ditësh Pejgamberi pa se Fatimeja mbante të varur në qafë një gjerdan. Ajo zonjë e brishtë dhe e stërhollë nuk vonoi që të kuptonte pakënaqësinë në fytyrën e të atit. Menjëherë shkoi dhe e

Allahut i sollën ca robër lufte. Fatimeja kërkoi nga i ati që njërin prej tyre t'ia jepnin si shërbëtor që ta ndihmonte për nevojat e shtëpisë që kryhen përjashta. Profeti Muhammed (a.s.) duke e udhëzuar bijën e tij që e donte më shumë se gjithçka në këtë botë, i tha:

– O Fatime! Kije frikë Allahun! Kryeji detyrimet që të ka urdhëruar Allahu me zemër të qetë! Bëji punët e shtëpisë tënde! Kur të biesh në shtrat këndo nga 33 herë subhanall, elhamdulillah dhe 34 herë Allahu ekber, që bëjnë të gjitha së bashku 100 herë këndime. Kjo do të jetë më e vlefshme për ty se sa puna që do të kryejë një shërbëtor për ty.

shpenzoj për ehli suffen në xhami." (Ahmed, I, 106)

Ja pra, Zotëria ynë (a.s.) e ka edukuar fëmijën e tij për një jetë të përkorë. Një tjetër shembull i edukimit shpirtëror dhe parapërgatitjes së anëtarëve të familjes për në botën tjetër nga ana e profetit Muhammed (a.s.) është edhe ky rast:

Kur u shpall ajeti Kuranor:

"O bashkëshortet e Profetit! Ju nuk jeni si gjithë gratë e tjera. Po qe se ia keni frikën Allahut, atëherë mos flisni (në prani të meshkujve të huaj) me një mënyrë tërheqëse, sepse ata që zemrat i kanë të sëmura nisin

2 Ahmed, I, 293

3 Muslim, Fezâilü's-Sahâbe, 93-96

4 Ayrıca Bkz. Buhârî, Tefsîr, 26/2; Tirmizî, Tefsîr, 27/2

të shpresojnë në të paqena. Flisni në rregull! Qëndroni në banesat tuaja hijerënda dhe mos veproni si në kohën e injorancës, duke dalë të pispillosura rrugëve! Falini namazet, jepeni zeqatin dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij. O familja e Profetit (ehli bejt)! Allahu dëshiron t'u heqë mëkatet dhe në këtë mënyrë të jeni të dëlirë." (el-Ahzâb, 32-33) profeti Muhammed (a.s.) ditë për ditë për gjashtë muaj me radhë kalonte nga porta e Fatimesë, teksa shkonte për në namazin e sabahut, dhe thoshte:

– Ngrihuni për në namaz o ehli bejt! Allahu dëshiron t'u heqë mëkatet dhe në këtë mënyrë të jeni të dëlirë. (Tirmidhi, Tefsir, 33/3206)

Edhe për namazin e tehexhudit që është një ndër kapitalet më të rëndësishëm të jetës së përditshme profeti Muhammed (a.s.), përpara mundësisë që të mos zgjohen nga gjumi për shkak të lodhjes, disa netë shkonte u trokishte në derë Aliut dhe Fatimesë dhe u kujtonte se ka ardhur koha e namazit të tehexhudit.

Enes bin Maliku ka thënë:

"Nuk kam parë person tjetër që ishte aq i dashur me anëtarët e familjes së tij se sa profeti Muhammed (a.s.)."

Me këtë njëkohësisht sikur donte të thoshte se nuk ka pasur njeri që i ka edukuar pjesëtarët e familjes së tij më mirë sesa Profeti (a.s.) E pra, profeti Muhammed (a.s.) i nxiste anëtarët e familjes të jenë shembuj për ata që kishin përreth duke i bërë që të jetonin brenda kritereve më

të përkryera dhe të përpikta të jetës së përkushtimit.

Për këtë arsye ashtu sikur se profeti Muhammed (a.s.) që zotëria i të gjithë pejgamberëve, sepse u edukua më së miri nga vetë Allahu (xh.sh.) edhe ehli bejti që u edukua nga ana e vetë profetit Muhammed (a.s.) qenë meshkujt dhe gratë më të përkryera në mesin e njerëzve të tjerë.

Ja dhe një nga virtytet e panumërta të Aliut (r.a.), i cili duke u edukuar nën edukatën shpirtërore të të Dërguarit të Allahut që kthyer me sjelljet e tij në zëdhënës të jetës shpirtërore të tij.

Gjatë një beteje, Aliu e kishte vënë përposh ushtarin e armikut dhe kishte ngritur shpatën që ta vriste. Duke menduar se që i mbërthyer nën kthetrat e vdekjes ushtari armik i pështyu në fytyrën e bekuar plot nur Aliut (r.a.).

Luani i Allahut Aliu (r.a.) papritur ndali dhe duke e ulur shpatën që kishte ngritur, hoqi dorë nga vrasja e armikur të shtrirë përdhe.

Politeisti shtangu nga çudia dhe e pyeti me habi:

–O Ali! Ç'të bëri që të hiqje dorë nga vrasja ime? Çfarë ndodhi që nga mëria e ashpër u shndërrove në një qengj të urtë!.. Përse u shndërrove nga një rrufe përzhitëse në një qiell të hapët?

Aliu tha:

– Unë luftoj për xhihad vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe nuk e përziej kurrë egon time në këtë mes. Duke më pështyrë në fytyrë ti kërkoje të më nxehje dhe nevikosje edhe më shumë. Sikur në atë moment do të më kish-

te kapluar zemërimi për sjelljen tënde do ta kisha derdhur gjakun tënd për një arsye të rëndomtë që nuk i ka hije asnjë besimtari. Unë nuk luftoj për hir të krenarisë sime, por për hir të Allahut.

Si përfundim edhe zemra e armikut u ringjall në besim përballë këtij morali të lartë dhe duke marrë pjesë nga sjelljet e virtytshme të Aliut pranoi besimin.

Ja pra, një nga begatitë e panumërta të edukatës së ehli bejtit... Prandaj ata janë njerëzit që janë mbërthyer pas dashurisë së të Dërguarit të Allahut dhe që sjelljet e tyre i rregullonin sipas veprimeve të Tij.

Ashtu sikur se puhia e mëngjesit që fryn mbi një kopësht me trëndafila, karafila dhe lule të tjera të rralla merr prej aty dhe përçon në vende të tjera aromat e mira qetësuese të atij kopshti, edhe bota shpirtërore e ehli bejtit të përkryer nën edukatën shpirtërore të të Dërguarit të Allahut (a.s.) u është shpërndarë me sinqeritet dhe besnikëri brezave që kanë ardhur më pas. Ashtu sikurse flaka e një qiriu vlen për të ndezur qirinjtë të tjerë të panumërt, edhe ata janë shndërruar në kandilët e përshpirtshmërisë që përçojnë nëpër shekuj dhe breza dritën e të Dërguarit të Allahut, kurse ata që kanë patur fatin e mirë të njohin dritën nga ata kandilë, kanë shijuar një nga kënaqësitë më të mëdha që të dhuron jeta sipas rrugës së Profetit (a.s.)

Ja pra edhe ehli bejti që piedestali i rrallë që përcolli tek shekujt dhe brezat jetesën,

cilësitë dhe moralin e të Dërguarit të Allahut (a.s.)

Dashuria ndaj ehli bejtit

Në përputhje me ajetin **"...O Ehli Bejt! Allahu dëshiron t'u pastrojë nga mëkatet që të jeni të dëlirë"** (el-Ahzab, 33) Allahu na bën të ditur se ehli bejti janë të pastruar dhe të falur nga gabimet dhe mëkatet. Pra Ehli Bejtit ia shton vlerat vetë Zoti.

Edhe i Dërguari i Allahut që i donte me gjithë shpirt anëtarët e familjes së tij kërkonte nga bashkësia e tij që të ushqenin dashuri ndaj tyre. Për këtë arsye është shprehur me këto fjalë:

"Duajeni Allahun e Lartësuar për hir të begative me të cilat ju ka furnizuar. Mua të më doni për shkak të dashurisë që keni për Allahun. Rrethin tim familjar (ehl-i bejt) duajeni, sepse ushqeni dashuri për mua." (Tirmidhi, Menakib, 31/3789)

Ebu Bekri i shkrirë në të Dërguarin e Allahut është një personalitet shembullor për sa i takon respektit që duhet treguar dhe dashurisë që duhet ushqyer ndaj ehli bejtit. Ai ka thënë:

"Respektojuni të Dërguarin e Allahut edhe me anë të respektit që do të tregoni ndaj ehli bejtit. Beto hem në Allahun, në duart e të Cilit është shpirti im, se unë personalisht e dua farefisën e të Dërguarit të Allahut më shumë se sa farefisën tim."

Dashuria ndaj ehli bejtit përbën një detyrë aq të rëndësishme sa edhe në **namaz** teksa këndojmë salavatet që vijnë në radhë pas et-Tehijatit është synuar që ne të mësohemi me lutjet që duhet të bëjmë rreth

ehli bejtit kur lexojmë duatë rreth "al-i Muhammed"it.

Lutja që është caktuar si përmbyllje pas teshehydrit në namaz dhe bëhet për "ali Muhammedin" nuk ka dyshim se tregon madhështinë e pozitave të tyre në fe. Respekti i këtij lloji nuk bëhet fjalë për respekt të këtij lloji rreth ndonjë "familjeje" tjetër.


Imam Shafi, i cili është shprehur me fjalët:

"Po qe se të duash familjen e Muhammedit qenka shkak të quhesh anëtar i sektit rafidi atëherë le të dëshmojnë njerëzit dhe xhindët se unë jam rafidi" përballë akuzave të ca indiferentëve dhe njerëzve tendenciozë, në një rast tjetër i ka shprehur me këto fjalë ndjenjat e tij në këtë çështje:

"O Ehli bejti i të Dërguarit të Allahut! T'ju duash juve është një detyrim me të cilin na urdhëron Allahu në Kuran. Mjafton si boshti më i lartë i lavdërimit tuaj fakti që namazi i atij që nuk lexon salavatet në namaz të mos i pranohet." (Muhammed Parsa, Faslu'l-Hitab / Tevhide Giriş, s. 522)

Krimi që dridhi edhe qiejt (10 Muharrem, Qerbela)

Krimi i kryer ndaj Husejnit, nipit të bekuar të profetit Muhammed, të cilin i Dërguari i Allahut e merrte në prehër me dashuri, e puthte dhe e përkëdhelte me përkëdheli, madje e mbante mbi shpinë gjatë namazeve, është një nga fatkeqësitë më të dhimbshme që është përjetuar në historinë Islame. Plaga që i hapi botës Islame ky krim vazhdon ende të pikojë gjak. Secili nga ata që e kryen këtë krim shta-



Ebu Bekri thënë:

"Respektojuni të Dërguarin e Allahut edhe me anë të respektit që do të tregoni ndaj ehli bejtit. Beto hem në Allahun, në duart e të Cilit është shpirti im, se unë personalisht e dua farefisën e të Dërguarit të Allahut më shumë se sa farefisën tim."

T'u lëshosh udhë konflikteve të thata që do të prishnin unitetin dhe bashkimin e umetit të Muhamedit, të hyjmë në debate të zjarrta dhe përplasje janë ndër veprimet që do të vrisnin shpirtin e bekuar para së gjithash të atij brezi të bekuar. Veçanërisht fanatizmi i verbër përherë ka qenë i dëmshëm që në historinë e kaluar. Madje edhe fërkimi më i vogël do të thotë t'ua bësh më të lehtë punën armiqve të fesë Islame, që duan ta ndajnë copë-copë bashkësinë e Muhammedit (a.s.) Qëndrimi që duhet të përvetësojmë në këtë çështje është të jemi përherë syçelur me prehtësinë që të fal besimi dhe të qëndrojmë larg thashethemeve dhe diskutimeve të kota.



zarak kanë rënë një nga një në dënimet që i dërgon zemërata e Allahut.

Masakrimi mizor që iu bë Husejnit u prit me aq urrejtje në botën Islame, sa që emri i kalifit të asaj kohe Jezidit, u shndërrua në emër negativ, sepse zemra e çdo muslimani cilido qoftë sekti që mbështeste klithte në vaj përballë atij krimi të neveritshëm. Prandaj midis shiitëve dhe sunnitëve nuk ekziston ndonjë arsye armiqësie në lidhje me këtë pikë. Ata që pohojnë se ekziston një armiqësi e tillë në këtë pikë nuk janë gjë tjetër përveçse provokacione të njerëzve keqdashës. Prandaj këto dy grupe nuk kanë përse ta shohin njëri-tjetrin si armiq në lidhje me çështjen e vrasjes së Husejnit, madje janë të detyruar të mbërthehen me mish e shpirt pas ajetit kuranor:

“Besimtarët janë vëllezër” (el-Huxhurat, 10).

T'u lëshosh udhë konflikteve të thata që do të prishnin unitetin dhe bashkimin e umetit të Muhamedit, të hyjmë në debate të zjarrta dhe përplasje janë ndër veprimet që do të vrisnin shpirtin e bekuar para së gjithash të atij brezi të bekuar. Veçanërisht fanatizmi i verbër përherë ka qenë i dëmshëm që në historinë e kaluar. Madje edhe fërkimi më i vogël do të thotë t'ua bësh më të lehtë punën armiqve të fesë Islame, që duan ta ndajnë copë-copë bashkësinë e Muhammedit (a.s.) Qëndrimi që duhet të përvetësojmë në këtë çështje është të jemi përherë syçelur me prehtësinë që të fal besimi dhe të qëndrojmë larg thashethemeve dhe diskutimeve të kota.

Për t'ia dalë mbanë në këtë pikë duhet që përkrah Kuranit dhe sunnetit të kape mi edhe pas një dege të pathyeshme, siç është dashuria për ehli bejtin. Kjo dashuri, të cilën na e ka urdhëruar edhe Profeti Muhammed (a.s.), përbën edhe horizontin shpirtëror të çdo muslimani.

Për këtë arsye, edhe të parët tanë në mbarë botën muslimane e kanë trajtuar në mënyrë të veçantë temën e ehli bejtit dhe ashtu sikurse nuk u kanë lënë gjë mangut në respekt, kanë ekspozuar edhe shembujt e bekuar për ummetin tonë në lidhje me temën se si duhet treguar respekti dhe dashuria ndaj tyre. Madje në perandorinë osmane u krijua edhe një institucion zyrtar i quajtur Nakibu'l-eshraf për mbrojtjen e figurës së vazhdimësisë së ehli bejtit.

Të mund të meritojmë të numërohem nga bashkësia e Muhammedit (a.s.), si patsardhësit e të parëve tanë lavdiplotë, ne duhet t'i gjallërojmë zemrat tona me dashurinë ndaj Kur'anit, Sunetit dhe ehli bejtit. Të marrim shembull prej tyre për moralin e bukur dhe sjelljet tona. Për këtë gjë duhet ta peshojmë jetën dhe veprimet tona me ato të Profetit tonë, familjes së tij dhe shokëve fisnikë të profetit.

Zoti im! Dhuroji shpirtit tonë pjesë nga përshepshmëria e profetit Muhammed (a.s.), ehli bejtit, sahabeve të dalluar të pejgamberit dhe miqve të Zotit që shkojnë udhës së tyre!

Amin!..

Mevlana Xhelaleddin Rumi (1207-1273)

Ilida CANJA

Mevlana Xhelaleddin Rumi lindi më 6 Rabiulevel 604 (30 shtator 1207) në qytetin Belh brenda kufijve të Afganistanit të sotëm. Babai i tij është Muhammed Bahaeddin Veled bin Hysejin el-Bekri i njohur si Mbreti i dijetarëve. I ati, pas një ëndrre, shndërrohet në dijetarin më të madh të Belhit dhe pseudonimi "Sulltanu'l-Ulema" përhapet më shumë se emri i tij.

Thuhet se në Belh rreth 300 vetë e panë në ëndërr Bahaeddin Veledin, në një çadër të gjelbër ku ndodhej edhe Profeti ynë s.a.v., Bahaeddin Veledi dhe shumë të tjerë.

Profeti s.a.v. po e lavdëronte para tyre Bahaeddin Veledin, ndërkohë, e merr pranë dhe i vendos duart mbi supë, duke u thënë të pranishmëve: "Këtë njeri do ta quaj Sulltanu'l Ulema".

Që atë natë, kur gjithë këto, njerëz panë të njëjtën ëndërr, Bahaeddin Veledi u quajt Sulltanu'l-Ulema. Nga ana e babait të tij, lidhja e Mevlanës bëhet me fisin e Ebu Bekrit (r.a.).

Babai i nënës së tij është sundimtari i Horasanit, Alauddevle Alauddin Harzemshah. Sipas një transmetimi tjetër, ai ishte nip sundimtari. Sulltanu'l-Ulema kundërshtonte në predikimet e tij rreptësisht Harizmshah Alaeddin Muhammedin si dhe dijetarët e ndikuar nga filozofia greke, Fahreddin Razi dhe Zejn Kishi. Disa burime të tjera, tregojnë se pas këtyre kritikave dhe pasi e mund në diskutim Fahreddin Raziun, rreth Sulltanu'l-Ulemasë lind një armiqësi, saqë e detyron të largohet nga Belhi pikërisht në vitet 1212-1219. Ai largohet me zemër të thyer dhe mungesa i tij ndihet thellë në qytetin e Belhit, i cili do t'i nënshtrohet pushtimeve mongole. Në këtë kohë Mevlanai ishte 5 vjeç.

Sulltanu'l-Ulema, gjatë udhëtimit me familjen e tij, ndalet në zonat e banuara dhe takohet me dijetarët dhe njerëzit e urtë të atij vendi. Në fillim shkon në Nishabur dhe takohet me Attarin.

Ky i dhuron "Esrarnamen" dhe i tregon se në të ardhmen ka për t'u bërë një sundues shpirtëror.

Pas kësaj, vjen në Bagdad dhe pasi qëndron për një periudhë kohe, nisat në rrugën e Kufes për në Hixhaz. Aty kryen detyrat e tij, qëndron

pak në qytetet që viziton dhe vazhdon udhëtimin. Shkon në Sham dhe takohet me Ibn Arabiun. Në 1217 viziton Malatjan, në 1219 Sivasin dhe nga aty kalon në Akshehir. Aty jep mësim 4 vjet në medresenë e ndërtuar në emrin e tij.

Pastaj shkon në Karaman (Loreda). Në këtë kohë Mevlana ishte 14 vjeç. I kërkohet të qëndrojë aty për të dhënë mësim. Sulltanu'l-Ulema pranon dhe qëndron shtatë vjet. Ndërkohë kur Mevlana ishte 18 vjeç martohet në Karaman me vajzën e dijetarit Sherefuddin Lala, zonjën Gevher.

Në 1226 atij i lind djali i parë, Sulltan Veledi dhe në vitin 1227 lind djali i dytë, Alaeddini.

Mevlana përfundon medresenë në Karaman dhe në të njëjtën kohë, i vdes edhe e ëma. Sundimtari Alaeddin Kejkubat e fton Sulltanu'l-Ulemanë në Konja. Familja e tij vendoset në Konja, në medresenë Altun Aba. Sulltanu'l-Ulema në të cilën jep mësim gjer në 1231.

Pas vdekjes së gruas së parë, zonjës Gevher, Mevlana martohet me zonjën Kerra, e cila ishte e vejë dhe kishte një fëmijë. Nga kjo martesë vjen në jetë Muzafferuddin Alim Çelebi dhe zonja Melike, e cila më pas do të ndërtojë një medrese në Ankara, ku do të marrë mësim Haxhi Bajram Veledi.

Tregohet se pas vdekjes, Sulltanu'l-Ulemai i shfaqet shpirtërisht zëvendësit të tij Burhaneddin Muhakkik Tirmidhi, që ndodhej në Kajseri dhe e urdhëron të shkojë menjëherë në Konja dhe të kujdeset për edukimin shpirtëror të Mevlanait. Me të ardhur në Konja, Burhaneddini kontrollon njohuritë e Mevlanait, e kupton se është përgatitur mirë dhe i thotë: "Nga ana e dijes nuk ke shok, je njeri i përzgjedhur, por për t'u bërë njeri i veprave si babai yt, nuk mjaftojnë vetëm fjalët, por duhet të marrësh dhe nga veprat e tij. Pasoje atë dhe ndrite botën sikur dielli."

Mevlanai vazhdon studimet dhe pas nëntë vitesh plotëson arsimimin e tij në të gjitha fuqishat.

Në 1233 Burhaneddini e dërgon Mevlananë në Haleb për të shtuar njohuritë. Mevlanai vazhdon medresenë Halavije dhe aty merr mësim nga Kemaluddin Ibnu-l Adim. Më pas shkon në

Damask dhe merr mësim katër vjet në medresenë Mukadimije. Gjatë jetës, Mevlanës i krijohet mundësia të takojë njerëzit e nderuar si Ibn Arabi, Osman Rumi, Sadreddin Konevi, Evhaduddin Kirmani, Sa'deddin Hamevi. Në medrese ai merr mësim prej mësuesve të ndryshëm për hadithet, gjuhën arabe dhe letërsinë e saj.

Kthehet në Kajseri dhe nga aty shkon në Konja bashkë me Burhaneddinin. Pas këtij arsimimi të mundimshëm, udhëheqësi i tij, Burhaneddini, i tregon Mevlanës se ka ardhur koha të fillojë detyrën e tij dhe të kthehet i vetëm në Konja, dhe vdes pikërisht aty pas pak kohe.

Sipas të birit të Mevlanës, në fillimin e viteve 1240, pas vdekjes së Burhaneddinit, ai mbeti i vetëm. Por përpjekjet për të përsosur sa më shumë veten vazhdojnë edhe pesë vite të tjera.

Me 29 nëntor 1244 në Konja vjen Shemseddin Tebrizi që kishte shërbyer dhe kishte marrë mësim nga shumë njerëz të nderuar si Ebubekir Seibat, Baba Kemaleddin Xhendi etj. Këtu ai takohet me Mevlanën dhe bisedojnë bashkë për të parën herë. Ky takim bëhet shkak për lindjen e një miqësie të thellë mes tyre. Mevlana fillon të bisedojë shpesh me të, derisa vjen një kohë dhe ata janë vazhdimisht bashkë. Tashmë Mevlana shkëputet plotësisht nga medreseja, nxënësit e tij, mësimdhënia dhe kontakti me popullin. Njerëzit rreth tij i shqetëson kjo situatë dhe përfundimisht lind një ndjenjë e papëlqyeshme për Shemseddin Tebrizin. Kur kjo ndjenjë kalon në armiqësi të fortë, Shemseddini largohet krejt papritur nga Konja, por meqë kjo i sjell Mevlanës dhimbje, bën që ai të mbyllet më shumë në vetvete. Të mërzhitur nga kjo që shkaktoan, njerëzit i kërkuan falje Mevlanës. Pas largimit të tij, Mevlana vesh rrobat e zisë dhe

fillon kuvendet fetare. Nuk kalon shumë kohë dhe përhapet lajmi se Shemseddini është në Sham.

Mevlana dërgon të birin atje dhe kërkon me këmbëngulje që Shemseddini të vijë në Konja. Duke mos mundur të refuzojë këto lutje të përzemërta, Shemseddini kthehet. Tani bashkë me Mevlanën hyjnë në bisedime për gjashtë muaj rresht, në lidhje me çështjen e marifetullahit. Gjatë këtyre shërbimeve nuk mund t'u shkonte afër askush, pos Sulltan Veledit dhe Selahaddin Zerkobit.

Mevlana marton Shemseddinin me vajzën që e kishte rritur vetë, zonjën Kimja. Kjo ngjarje u jep shkas përgojimeve. Situata rëndohet keqas. Shemsi i thotë Veledit se njerëzit duan ta ndajnë nga Mevlana dhe këtë herë ai do largohej pa lënë gjurmë. Në 1247 Shemseddini zhduket krejt papritur. Sipas disa transmetimeve, ai ra viktimë e një atentati. Sot varri i tij gjendet në xhaminë që mban të njëjtin emër. Allahu e mëshiroftë!

Sulltan Velede tregon se pas zhdukjes së dytë të Shemseddinit, babai i tij fillon të shkruajë vazhdimisht poezi.

Pasi përjeton këtë dhimbje, atë që e kishte gjetur te Shemseddini, Mevlana e gjeti te Selahaddin Zerkobi dhe deri në 1258 diskutonte shpesh me të. Pasi vdes edhe ky, Mevlana i vazhdoi bisedat me Çelebi Hysameddinin. Pa të ishte e pamundur të gjeje Mevlanën të lumtur dhe entuziast në bisedat e tij. Mevlana fillon ta shkruajë Mesnevinë e tij si rezultat i këmbënguljes së këtij miku të nderuar. Në libër ai e tregon shpesh se Çelebi Hysameddini ishte shkak për t'u shkruar ky libër. Sulltan Velede tregon se babai i tij e përngjasonte Shemseddin Tebrizin me diellin, Selaheddin Zerkobin me hënë dhe Çelebi Hysameddinin me yllin.

Libri "Mesnevi" përfundon. Është viti 1273. dhe Mevlanën e zë një sëmundje e rëndë, që i shkakton shumë temperaturë. Me 17 dhjetor 1273, ditën e dielë, kur po përendonte dielli, Mevlana jep këshillat e fundit, braktis këtë botë materiale dhe i bashkohet Zotit.

Namazin e xhenazes e fali një xhemat shumë i madh. Atë ditë u duk sikur u tund toka. Të gjithë qanin. Sipas zakoneve të asaj periudhe, njerëzit presnin kurban dhe ua ndanin të varfëve. Sadreddin Konevi kaloi përpara, për të udhëhequr namazin, por atij i bie të fikët nga mërziya dhe të qarët. Në vend të tij kalon Kadi Siraxheddin Urmevi dhe udhëheq namazin. Pas Mevlanës, e vazhdon detyrën e tij, Çelebi Hysameddini për dhjetë vite rresht. Pasi vdes edhe ai, në vend të Mevlanës kalon i biri, Sulltan Velede.

Pasuesit e Mevlanës në përgjithësi ishin nga populli i thjeshtë, por rreth tij gjendeshin edhe njerëz të ditur dhe drejtues të ndryshëm. Nën ndikimin e veprave të tij çdo vit, shumë njerëz njihen me dritën e Islamit dhe bëhen muslimanë.

Ai është ende i gjallë, ende ndikues...

Allahu e mbuloftë këtë njeri me mëshirën e Tij.

Veprat e tij janë: Mesnevi, Divan-i Kebir, Fihi Ma Fih, Mexhalis-i Seb'a, Mektubat.



MEVLANA, UDHERREFYESI I DASHURISE

Rabia Christine BRODBECK

Mevlana na mëson se vlera e njeriut është sipas kapacitetit që ka për të dashuruar. Në këtë kontekst, njeriu duhet ta mësojë veten të dëgjojë, të vështrojë dhe të ndjejë të vërtetën. Gjithashtu kjo vlerë matet edhe me ngarkesën shpirtërore që mund të mbajë. Pikërisht në këtë pikë vërejmë se kapaciteti i njerëzimit është konsumuar në rrugë të ndryshme të pavlera. Mevlana thotë që: “Një shtëpi që nuk ka dritare është si ferr. O njeri, esenca e fesë është hapja e dritareve.”

Me mënyrën e jetesës së tij, Mevlana na paraqet shembullin e një miku të Allahut (veli). Nga jeta e tij kuptojmë se miqësia e vërtetë me Allahun (velajeti) nuk është e ndarë nga dashuria. Në fakt, dashuria nuk ka qenë asnjëherë e shkëputur prej bukurive hyjnore, prej përkushtimit në Islam e as prej udhëzimit të saktë. Pasuria e thellë e tij dhe shpirti i pastër, do t’ua largojë urinë udhëtarëve të kësaj udhe dhe do t’ua zbukurojë jetën e tyre shpirtërore.

Duke thënë “*Bize leyl ü nehar olmaz.*” (Për ne nuk ka as natë e as ditë.) kanë treguar se janë veli të së vetmes fe universale, të cilët kanë prezantuar diellin e së vërtetës dhe kanë hedhur hapa përmbi universin, duke tejkaluar kështu edhe konceptin e universales. Për arsye se përdorin një gjuhë universale, duhet të dëgjohen ato sepse fjalët e tyre janë erëra jetëdhënëse, që fryjnë nga klima e pavdekshmërisë. Ato i drejtohen të gjithë njerëzve, të gjitha kohërave, të gjitha kulturave, të gjithë besimeve dhe të gjitha kombeve.


Universaliteti është një gjë e lidhur direkt me nurin e tevhidit të Allahut. Ata që nuk e arrijnë këtë nur, ngaqë

janë vëngëroshë çdo gjë e shohin “dy”. Të gjithë velitë për shkak të këtij nuri janë bërë veli dhe velajetin e tyre e shfaqin me po këtë nur; Ata vërejnë me nurin e të Vërtetit! Kur flasin velitë, njerëzit ndihen sikur po dëgjojnë lajme të freskëta për Profetin (s.a.s.).

Gjithësinë mund ta ndryshojë vetëm pa-unësia. Tashmë ka ardhur koha të njihemi me velitë, t’i dëgjojmë ata, se zgjidhja e problemeve të shekullit XXI është tek velajeti. Ata i mësojnë njerëzimit jetën e brendshme, dashurinë hyjnore, e cila gjendet si potencial në brendësinë tonë, si rezultat i jetës së brendshme. Tek ata gjendet ilaçi që do shërojë plagët dhe sëmundjet tona shpirtërore, sepse çdo qelizë e tyre është e ndriçuar dhe e stolitur me nurin e tevhidit e të Lartmadhëruarit. Mistikët islamë, veçanërisht murshidët, ndryshe nga mësuesit e thjeshtë, japin ilmu’l-jekin, u mësojnë irfanin dhe dashurinë. Ka disa njerëz që Allahu i ka zgjedhur, e që ne atyre mund t’u themi ashikë. Ata na dhurojnë ne perla nga urtësia, na edukojnë, na zbukurojnë, na ushqejnë shpirtin tonë, na udhëzojnë, ose thënë ndryshe ata na duan si dashuria që ka shërbëtori ndaj zotërisë së tij, për të cilën Profeti ynë

i dashur (s.a.s.) na ka thënë: *“Sejjidu’l-kavmi khadimuhum”* – *“Zotëria i një populli, është ai që i shërben atij populli.”*

Pa dyshim, Mevlana është një veli universal. Ai është edhe një mësues i përkryer, edhe përtej saj, është edhe murshidu’l-kamil. Mevlana ashtu sikur na lajmëron për zbulimet ontologjike të natyrës njerëzore, të cilat nuk mund të dihe-shin nga mjekësia në ato kohë dhe ato që janë zbuluar në shekullin e kaluar,



ai ndan me ne edhe thesaret shpirtërore dhe thesaret e brendësisë së tij. Ndoshta nuk mund të gjendet asnjëri në histori që të jetë detajuar sa ai në çështjet trupore, sipas kuptimit tokësor, përveç profetëve të cilët në një mënyrë, kanë hapur rrugën edhe të mbretërimit tokësor. **Ilmi jekta(?)** është ajo që ka hyrë thellë në psikologjinë e njeriut. Po shkunden me mendime të qarta lidhur me mënyrën e gabuar të sjelljes tonë, e cila ka infektuar mendimin e njeriut të prishur dhe ka depërtuar në unin tonë:

“Turp! Të gjitha këto tregojnë gjendjen tuaj të mjerë, por ju fajsoni Faraonin. Kur njeriu nuk është i informuar nga ngjyra dhe nga gjendja e shpirtit të tij, le të përgjigjet si të dëshirojë.”

Kush shikon me dobësinë e tij njerëzit e së vërtetës, atëherë qeshni për sytë e tij të shtrembëta. Filozofi gjithnjë mohon ekzistencën e shejtanit, ndonëse shejtani në çdo moment luan në gishtat e tij.

A nuk e ke parë shejtanin? Atëherë shih veten tënde! Nëse gjendja jote aktuale nuk është e shejtanosur, atëherë përse e ke fytyrën kaq të errët?”

Thënëndryshe, ndërkohë që Mevlana na ushqen mendjet tona me një perceptim të lartë, ai edhe zemrën tonë na e ngop me perla urtësie në një mënyrë të bukur. Ai gjithnjë thekson rëndësinë e unitetit të botës së brendshme me atë të jashtme. Të bashkosh të përshpirtshmen me formën, shpirtin me trupin, gjë të cilën kush e re-

alizon, atij i thonë “veli”. Ja, kjo është gjëja për të cilën ka nevojë bota e sotme, sepse për arsye të shkëputjes nga bota shpirtërore po ndizen llambat e alarmit.

Mevlana na mëson se vlera e njeriut është sipas kapacitetit që ka për të dashuruar. Në këtë kontekst, njeriu duhet ta mësojë veten të dëgjojë, të vështrojë dhe të ndjejë të vërtetën. Gjithashtu kjo vlerë matet edhe me ngarkesën shpirtërore që mund të mbajë. Pikërisht në këtë pikë vërejmë se kapaciteti i njerëzimit është konsumuar në rrugë të ndryshme të pavlera. Mevlana thotë që: *“Një shtëpi që nuk ka dritare është si ferr. O njeri, esenca e fesë është hapja e dritareve.”*

Njeriu i kohëve të sotme, është i zënë vetëm me veten dhe me ato që fiton materialisht. Ai ka harruar heshtjen. Prandaj edhe fama e Mevlanës në Perëndim, ndonëse shumica e njerëzve nuk e kanë vënë re, është për arsye se i përgjigjet të gjitha nevojave tona.

Bota nuk ka nevojë për fjalime akademike, për dhënien e mësimit nga katedra ose podiumi, apo për oratori, gjëja që i nevojitet botës është përmirësimi dhe dashuria. Njerëzit e ndjejnë nevojën për të dashuruar dhe simpatizuar, sepse akti i krijimit është një akt dashurie, bukurie dhe prehje shpirtërore.

Mevlana u përgjigjet këtyre nevojave themelore.

Të gjitha veprat e tij, vërtetojnë se dashurinë, frymëzimin dhe ushqimin i

merr nga thelbi i gjithësisë, direkt nga burimi i nurit, nga perla e njerëzve, nga profeti Muhammed (a.s.). Kështu Mevlana është babai ynë shpirtëror dhe ndihmës i ngushtë i jetës sonë.

Mevlana vazhdimisht u tërheq vëmendjen, u bën vërejtje njerëzve, që të mos jetojnë si një makineri, të mos bëjnë pazar me Allahun. Nëse nuk jemi të pasionuar pas bukurisë së Allahut, nuk mund ta realizojmë kaderin tonë, s'mund të arrijmë në gradat e pastërtisë, ndriçimit shpirtëror dhe dashurisë. Nëse nuk do jemi kuresh-tarë dhe të mahnitur për pafundësinë mahnitëse të Zotit tonë, do ta kemi të vështirë ta kuptojmë Atë. Xhelaleddin Rumi u bën një shpjegim të tillë:

“Dervoishi dëshiron të jetë si një peshk në tokë. Faktikisht në formën e një peshku është, por i largohet detit. Allahun e don për ta fituar pëlqimin e Tij. Shpirti i tij nuk është brenda dashurisë së përkryerjes dhe bukurisë së Allahut. Turp atyre që janë mbi tokë! Pa shihni këta hajdutë injorantë të jashtënjëzores, kur shihni pamjen e tyre të bukur, i mendoni asketë, por brenda tyre nuk ekziston Allahu!”

Nëse njeriu bëhet pre i imagjinatave të veta, nëse mashtrohet pas pamjes së jashtme të botës, nëse njeriu nuk interesohet të ngrihet sa më lart, nëse njeriu nuk e tërheq përkryershmëria dhe bukuria hyjnore e Krijuesit të tij, ai do ngelë larg dashurisë, mëshirës dhe dhuntive të Zotit.


Mevlana duke na tre-guar mangësitat, plasaritjet, paafësitë, gabimet, pasukset, paditurinë dhe ndjenjën e revoltës sonë dhe duke na bindur për to, na udhëzon në mënyrën më të përkryer. Të gjitha pjesëve të prishura të njeriut ia drejton projekto-rin, më pas ata që dëshirojnë edhe mund t'i operojnë.

“Pa mbylli vetëm për një çast këto sy të djallëzuar. Edhe për sa kohë do vazhdosh të shohësh vetëm paraqitjen e diç-kaje? Edhe për sa kohë? Edhe për sa kohë?” – thotë ai.

Ja, se si e shpjegon ai se si mohuesit, injorantët dhe blasfemuesit torturojnë veten e tyre, mohojnë veten e tyre, pra janë armiq të vetvetes:

“Gjen difekte në fytyrën e hënës, e në xhennet mundohesh të gjesh gjëmba. Nëse hyn në xhennet për të kërkuar gjëmb, s'gjen tjetër përveç vetes tënde. Mohuesit janë armiq të e vetvetes; duke mohuar vazhdojnë të plagosin veten e tyre. Lakuriqi i natës, i mjeri, nuk është armik i diellit, por i vetes së vet. Shndritja e diellit e bën të vdesë atë; po ai, vallë, si mund ta dëmtojë diellin?”

Është tepruar me identi-fikimin e Mevlanës me Sema-në. Aq sa njerëzit mendojnë se tasavvufi është i barabartë me sema-në. Sërish këtu çështja qëndron tek ekster-nalizimi. Ngaqë është diçka që mund ta përfundojmë vetëm me shikim, njerëzit mbesin tek paraqitja. Bëhen simpatizantë të Mevlanës në dimensionin ekternal, por nuk i njohin doktrinat e tij. Mirëpo kjo është pikërisht e kundërta e përpjekjeve të tij



për të zgjuar njerëzit nga gjumi i mosperceptimit. Një ekspert i Mevlanës thotë kështu: *“Mos i pyet ata se si u kthyen, por pyeti përse u kthyen?”*

Udhëtim me Mevlanën për në thellësitë e Ku'anit

Adem PIZGA

Kur'ani është udhëzim për të gjithë besimtarët, ku çdokush mund të përfitojë nga ai. Ata që përfitojnë më shumë janë njerëzit e ditur. Kur'ani duke qenë fjalë e Allahut, thellësitë e kuptimeve të tij nuk kanë fund. Ai i përgjigjet çdo vendi, çdo kohe dhe sa herë që e lexon, të duket sikur ka zbritur tani.

Një ndër ata njerëz që është munduar të futet sa më në thellësi të këtij libri të madh, është edhe Xhelaledin Rumi i njohur si Mevlana.

Sipas tij, Kur'ani është më tepër se sa një fjalë që thuhet me gjuhë apo që shkruhet me dorë. Ai nuk ka thjesht një kuptim, por më shumë. Sikur të ishte kështu atëherë nuk do të ishte e nevojshme që deti të bëhej bojë dhe pemët pendë, për të zbërthyer fjalën e Allahut. Do të shkruhej me gjysëm oke bojë, por fjala e Zotit nuk ka fund.

Sipas Mevlanës, Kur'ani përveç kuptimit të parë, të dukshëm, ka edhe një kuptim të dytë, të padukshëm ku jo çdokush mund ta kuptojë. Sipas tij, kuptimi thelbësor i Kur'anit është pikërisht kuptimi i padukshëm.

Tregohet që një ditë disa njerëz po rrëfenin për një person i cili e këndonte Kur'anin në shtatë mënyra dhe që nuk

flinte asnjë natë pa e bërë hatme gjithë Kur'anin. Kur e dëgjoi këtë Mevlana tha: Po! Ai e lexon në mënyrë sipërfaqësore pa e ndjerë në brendësi shijën e tij dhe pa u thelluar në kuptimin e tij.

Gjithmonë sipas Mevlanës, kuptimet e Kur'anit, qoftë ajo e dukshme apo e padukshme janë hak (të vërteta), sepse Kur'ni është si një stof me dy anë. Disave u pëlqen njëra anë, disa të tjerëve ana tjetër. Që të dyja janë të sakta, sepse Allahu ka dashur që të dy grupet të përfitojnë nga ai.

Në një ligjëratë, ai thotë se sahabet e Pejgamberit mësonin ajete nga Kur'ani pak nga pak, sepse ata kur mësonin diçka nga Kur'ni, e zbatonin dhe nuk mësonin ajet tjetër pa e zbatuar atë që e kishin mësuar. Sipas Mevlanës, ata të cilët e lexojnë Kur'anin pa e kuptuar atë, është njësoj si ai, i cili fut në gojën e tij dhe nxjerr shumë ushqim pa e kaluar poshtë. Të merresh me anën e dukshme është shumë e lehtë, e vështirë është të merresh me anën e padukshme, por që fundi i saj është i ëmbël. Në shikim të parë, kuptimi i Kur'anit nuk duket shumë tërheqës, por sa më shumë që të futesh në brendësitë e tij aq më shumë e ndjen ëmbëlsirën e tij.

Sipas Mevlanës, shumë tefsire janë shkruar, por pak prej tyre kanë arritur të shpjegojnë qëllimin e vërtetë të Kur'anit.

Në kohë të ndryshme shumë njerëz janë munduar të shpjegojnë Kur'anin. Një pjesë e tyre është munduar që me anë të shpjegimeve të bëra nga Kur'ani të mbështesë mendimet e tij, por Mevlana është i mendimit se është e pamundur që Kur'ani të kuptohet në këtë mënyrë. Sipas tij Kur'ani kuptohet vetëm atëherë kur njeriu ia dorëzon veten këtij libri të madh, zhveshet nga çdo paragjykim me zemër dhe me mendje të kthjellët të përpiqet për ta kuptuar atë sa më saktë.

Të kuptosh Kur'anin nuk është njësoj si të lexuarit apo të kuptuarit e librave të tjerë. Për të kuptuar Kur'nin duhet që t'ia japësh të gjithë qenien tënde atij, të zhytesh në brendësinë dhe në thellësitë e tij...

Mevlana në disa ligjërata të mbajtura, ka bërë tefsirin e disa ajeteve të Kur'anit të madhërueshëm. Ndër ta mund të përmendim: Ajeti 125 i surës Bekare:

“Dhe kur shtëpinë (Qaben) e bëmë vendkthimi dhe vend sigurie për njerëzit, (u thamë) vendin ku qëndroi

Ibrahimi pranonie për vend-faljeje!...”.

Mevlana pasi e lexoi këtë ajet tha: Këtë ajet dijetarët në përgjithësi e kanë komentuar në këtë mënyrë:

“Me fjalën bejt është për qëllim Qabja, kush shkon atje është i sigurt. Atje është e ndaluar gjuetia dhe nuk lejohej që të shqetësohet askush. Allahu atë vend e ka bërë të përsosur”.

Pastaj tha që ky komentim është i saktë dhe i bukur, por kjo është vetëm ana e jashtme e Kur’anit, ana e dukshme. Ai e komenton në këtë mënyrë këtë ajet:

“Bajt është brendësia e njeriut. Prandaj duke u nisur nga kuptimi i brendshëm i ajetit do të thotë që njeriu bën dua (lutje) në këtë mënyrë:

“O Zot! Ma pastro brendësinë time nga të gjitha vesveset dhe mendimet e këqia derisa të mos më mbesi aspak shqetësim. Atje të dali hapur siguria, të jetë vendi i vahjët (revelatës hyjnore). Shejtani dhe vesveset të mos gjejnë rrugë për atje”.

Një ditë Mevlana po fliste mbi kuptimin e ajetit 78 të surës Shuara:

“Zoti që më krijoi, Ai më udhëzon mua” dhe tha:

- Kuptimi i këtij ajeti është kështu: Ai që mua më ka krijuar për t’i shërbyer Atij, më tregon rrugën për të mësuar rregullat e të shërbyerit.


Këta ishin disa shembuj të shkurtër në lidhje me komentimin e ajeteve Kur’anore nga Mevlana, ku sipas tij Kur’ani është një pasuri e pashtershme.



Mevlana dhe batuta

Fatmir Sulaj

**“Mesnevia është një dyqan unik,
rruga më e ndritshme e Allahut,
shërim për zemrat, heqës i brengave
dhe udhëzues në rrugën e drejtë.”**



Sipas Mevlanës shakaja dhe batuta janë për të mësuar diçka. Për këtë arsye duhet t'u japim rëndësi. Nuk duhet të gjënjehemi nga pamja e jashtme e tyre. Sipas tij, i rëndësishëm është konceptimi i tyre.

Një njeri maskara nuk i vlerëson gjërat serioze, çdo gjë për të është poshtërsi, ndërsa njerëzit e mençur nuk mendojnë kështu, sipas tyre edhe shakaja dhe batuta janë gjëra serioze.

“Strofa ime nuk është strofë, por një shtet. Shakaja ime nuk është shaka, por diçka edukative.”

Shakaja dhe batuta janë të dobishme për të mësuar diçka... dëgjoje atë seriozisht. Mos shiko vetëm pamjen e jashtme. Çdo gjë serioze sipas të poshtërit është poshtërsi dhe shaka, ndërsa sipas të mençurve edhe batuta është serioze.

Mevlana, në një vend ku shpreh se ç'është Mesnevija, thotë:

“Ky libër është përrallë për ata që thonë se është përrallë, por për ata që e gjejnë veten në këtë libër, i thuhet ushtar. Mesnevija është si uji nivin. Popullit të Faraonit i duket gjak, por për popullin e Hazretit Musa nuk është gjak, por është uji i jetës.”

Mevlana është një poet që dëshiron t'i shprehë mendimet e tij me tregime. Mesnevija, që nga fillimi deri në fund, është e mbushur me tregime dhe histori, por qëllimi i tij nuk është që të tregojë histori dhe të argëtojë njerëzit, në Mesnevi thotë kështu për historitë (tregimet mësimdhënëse):

“Kur Pejgamberi a.s. thërrret nga jashtë, shpirti i ummetit bën sexhde nga brenda. Kur trupi bëhet sy, mund ta shikojë fytyrën e të dashurit të tij edhe nëse sytë janë mbyllur. Por ti supozo se nuk e ke parë as me syrin që ke në ballë, as me syrin e zemrës. Çfarë sheh? O medituës, mundohu të marrësh mësim nga historia, përndryshe:

Si t'ua shpjegojë memeci Dimnes dhe Keliles? Si mund ta kuptojë Kelile qëllimin e atij?

Këta ua tregojnë njëri-tjetrit qëllimet e tyre, por si mund ta kuptojë njeriu se çfarë duan të thonë kafshët?

Mos thuaj: “ Historia e Dimnes dhe e Keliles është komplet gënjeshtër, përndryshe si mund të luftojë sorra me lejlekun? ”

Vëlla! Tregimi i ngjan një peshoreje, ndërsa kuptimi u ngjan farave që ka në të. Njeriu i mençur merr farat që ka në të dhe nuk shikon ka apo nuk ka peshore.”

Sipas Mevlanës, tregimet janë për të marrë mësim. Shumica e tyre janë shpifje të nje-

rëzve. Për tregimin e Bilbilit dhe trëndafilin thotë kështu:

“Nuk ka ndonjë libër që flet për to, por çfarë thua për aventurën e Bilbilit me trëndafilin?!”

Në fakt tregimi i “Bilbilit me Trëndafilin” është aventura më klasike e kulturës së lindjes. Çdo poet flet për tregimin e tyre. Ata i shprehin mendimet, ndjenjat dhe aventurat me gojën e tyre. Poetët mjeshtrë të fantazisë, vendosjen e trëndafilin me gjemba për ta mbrojtur bilbilin nga gjarpërinjtë dhe nga zogjtë grabiqarë dhe strehimin e tij në hijen e trëndafilin për t’u mbrojtur nga dielli, e kanë lidhur me dashurinë e bilbilit që kishte ndaj trëndafilin.

Mevlana nuk tregon histori boshe, për të qeshur dhe të pavlera. Tregimet dhe historitë e tij janë të vlefshme, mësimdhënëse dhe të bëjnë të mendosh.

Ja disa prej tyre:

Mishin e hëngri macja

Një burrë kishte një grua gënjeshtare, të papastër dhe të keqe. Ajo e harxhonte kot çdo gjë që burri i saj i sillte në shtëpi. Ky harxhim e pati vënë burrin në vështirësi. Një ditë burri i varfër mori me shumë vështirësi pak mish, për mikun që do t’i vinte në shtëpi. Gruaja e bëri meze mishin dhe e hëngri me pije. Ajo u mundua ta bindë burrin e saj me gënjeshtër. Kur burri i tha:

“-Ku është mishi sepse miku erdhi. Ku është ushqimi? Duhet t’i nxjerrim ushqim mikut.” gruaja tha:

- “Mishin e ka ngrënë macja. Nëse të duhet merr mish tjetër.

Burri tha:

- “Atëherë më sill peshoren që ta peshoj macen dhe të mos kem më dyshim.” Ai e peshoi macen dhe ajo erdhi tre kilogram.

Atëherë burri i thotë gruas:

- “I gjithë mishi ishte tre kg.. Unë e peshova macen dhe ajo erdhi po aq. Nëse kjo është macja, ku është mishi? Nëse ky është mish, atëherë ku është macja?”

Mësoje nga udhëheqësi se si furnizohet robi

Robërit e udhëheqësit të Horosanit shëtisnin në Herat, të veshur me rroba të zbukuruar me florinj dhe me zukurime të ndyshme mbi kuajt arabë.

Një burrë i varfër pyet:

- “Kush janë këta padishahë dhe këta udhëheqës?”

Kur njëri që ishte aty pranë i tha:

- “Këta nuk janë udhëheqës, por janë robërit e udhëheqësit të Horosanit”, njeriu i varfër e ngriti kokën nga qielli dhe me lakmi tha:

“-O Zot! Mësoje nga udhëheqësi se si furnizohet robi!”

Mevlana, pasi e tregon këtë histori, na këshillon ashtu si në çdo fund të çdo historie. Ai duke na treguar se ai që i tha Zotit kështu në një mënyrë të papërshtatshme ishte lakuriq, kishte nevojë për një fetë bukë dhe se dridhej nga të ftohti, na sqaron se ai guxoi të thotë kështu për këtë shkak. Menjëherë pas këtij sqarimi ai e këshillon lexuesin.

Sipas tij, nëse të tjerët janë lakmitarë, robi i mirë nuk duhet të jetë. Robi i vërtetë duhet të mendojë se Allahu i ka dhënë “belin” i cili është më i vlefshëm se sa rripi dhe se i ka dhënë “kokën” ku në të vihet kurora.

Miqësia e vërtetë është të ndash mes njëri-tjetrit dobinë dhe përfitimin

Njëri nga nxënësit e Mevlanës, transmeton këtë kujtim në lidhje me Mevlanën:

Një ditë po shkonim të shëtisnim bashkë me një shokun tim. Nga larg pamë Mevlanën që po ecte vetëm. Edhe ne e ndoqëm duke i shkuar nga pas. Mevlana pa nga mbrapa, na shikoi ne dhe tha: “Vetëm ju ejani pas meje, asnjë tjetër të mos vijë. Unë nuk e dua kallaballëkun. Unë iki nga populli që të shpëtoj nga ata, sepse ata të puthin dorën dhe të respektojnë duke u përulur.”

Me të vërtetë, Mevlana lëndohej shumë nga puthja e dorës dhe nga përulja e kokës. Ai ishte shumë zemërbutë ndaj njerëzve të klasave më të ulta, ndaj fatkeqëve dhe përulej përpara tyre.

Pastaj Mevlana vazhdoi rrugën. Pasi eci pak, përpara i doli një rrënojë. Aty ishin disa qen duke fjetur bashkë, pranë njëri-tjetrit. Shoku im tha:

‘Sa bashkim të bukur që paskan bërë këto të shkretët, sa bukur po flenë dhe sa bukur qenkan ulur pranë njëri-tjetrit.’

Mbi këtë Mevlana tha:

- “Nëse ti dëshiron të dish se sa i sinqertë është bashkimi dhe miqësia që kanë ndërmjet

tyre, hidhu një kockë ose një copë mushkëri. Atëherë do të shohësh se çfarë miqësie është kjo. Ja, e tillë është edhe miqësia e njerëzve që duan këtë botë dhe e atyre që adhurojnë pasurinë e kësaj bote. Ata janë miq me njëri-tjetrin përdërisa ndërmjet tyre nuk ka ndonjë interes apo dobi, por kur ndërmjet tyre hyn diçka e kësaj bote, nuk e mendojnë fare nderin e shumë viteve dhe hakun e ushqimit që hanin bashkë, por e hedhin në një qoshe.”

Udhëheqësi duhet të jetë roje dhe jo ujk

Një ditë Sulltan Izzeddin Kejkavusi II kishte ardhur për të vizituar Hazreti Mevlanën dhe i thotë: “Më jepni një këshillë o Hazreti Mevlana.”

Mevlana tha:

“Çfarë këshille të të jap ty? Ty të kanë urdhëruar për të qenë çoban, dhe ti je ujk. Ty të kanë urdhëruar të jesh roje, dhe ti je hajdut. Allahu të ka bërë sulltan, ndërsa ti vepron me fjalën e shejtanit.”

Mbi këtë sulltani doli jashtë duke qarë, u pendua para medresesë dhe tha:

“O Zoti im! Nëse Hazreti Mevlana më tha fjalë të ashpëra, m’i tha për hirin Tënd. Unë këtë butësi po e shfaq për shkak të sundimit Tënd dhe po të përgjërohem Ty. Më mëshiro për hir të këtij robi të sinqertë.” Dhe pastaj tha këtë varg poezie:

“Mëshiroje zemrën time gënjeshtare dhe të brengosur për hir të dy syve të lagur me lot.”

Në këto momente Hazreti Mevlana doli jashtë me res-

pekt dhe duke i marrë zemrën, i tha:

“Shko, Allahu i madhërueshëm të ka mëshiruar dhe të ka falur!”

Shakaja ime nuk është shaka, por është udhëzim dhe mësim për popullin

Në kohën e Mevlanës, një njeri kishte hypur në pemë për të mbledhur fruta. Befas pronari i pemës e dëgjoi këtë, shkoi pranë tij dhe i tha: “Zbrit poshtë!”



Njeriu i cili ishte në pemë tha: “Nuk zbres poshtë.”

Kur pronari i pemës filloi të këmbëngulte, njeriu u inatos dhe tha:

“Nëse zbres nga kjo pemë, gruaja ime le të divorcohet!”

Ai u mund prej zemërimit, por nga goja kishte nxjerrë një fjalë të madhe. Si mund të kthehej kjo fjalë prapa? Ai qëndroi aty tri ditë dhe tri net. Së fundi dikush tha: “Këtë

çështje duhet t’ia parashtrijmë Hazretit Mevlana.”

Një grup i sinqertë prej tyre, ia treguan Mevlanës këtë situatë.

Mevlana u thotë:

- “Që të mos i prishet betimi, ai le të kalojë nga ajo pemë në një pemë tjetër dhe të zbresë nga aty. Nëse nuk ka pemë afër asaj peme le të zbresë mbi një kalë dhe pastaj në tokë. Në këtë mënyrë nuk i prishet betimi.”

Njeriu bëri siç e porositi Mevlana dhe shpëtoi nga prishja e betimit. Mbi këtë të gjithë hoxhallarët e përgëzuan Hazreti Mevlanën.

Gjithçka është në Kur’an

Një burrë e donte shumë gruan e tij. Një ditë gruaja e tij, duke i bërë naze, i tha:

“O i nderuar! Eja dhe be-tohu se do të më japësh çfarë të dua, përndryshe do të ndahem prej teje.”

Burri i cili e donte shumë gruan e pa se ajo e kishte seriozisht, u detyrua t’i bindet këtij propozimi.

Atëherë gruaja tha:

“Dua të më sjellësh përpara meje çdo gjë që ka krijuar Allahu i madhërueshëm në këtë botë.”

Burri i shkretë nuk mundi t’ia plotësonte këtë dëshirë dhe filloi të mendojë. Së fundi shkoi te Hazreti Mevlana dhe ia tregoi atë që i kishte ndodhur.

Mevlana duke u menduar i thotë:

“Shko, merr librin e Allahut, Kur’anin, mbështille me shami dhe jepja gruas tënde, sepse në këtë mënyrë, ti i ke

sjellë asaj çdo gjë që ka në këtë botë, sepse në Kur'anin Fisnik, (në Suren En'am, ajeti 59) thuhet: **“Nuk ka asgjë që të mos jetë në Kur'an.”** kështu që nuk ndaheni dhe nuk divorcoheni. Në këtë mënyrë burri nuk u divorcua me gruan që donte.

Nga dy tregimet e fundit kuptohet se Mevlana i dinte shkencat Kur'anore dhe fetare po ashtu këtë dije e përdorte për të zgjidhur problemet që lindnin në kohën e tij. Edhe ai ishte specialist për të gjetur zgjidhje të përshtatshme dhe praktike ndaj fesë dhe mendjes.

Për këtë njeri të pashok ka me dhjetra tregime si tregimet e mësipërme në Mesnevinë e Mevlanës. Molla Xhami ka thënë për Mevlanën:

“Ai nuk është peygamber, por libër.” Kjo fjalë shfaq vendin dhe rëndësinë e Mevlanës dhe të Mesnevisë së tij në botën tonë kulturore.

Mevlana thotë:

“Mesnevija është një dyqan unik. Është rruga më e ndritshme e Allahut. Është shërim për zemrat, i heq bren gat dhe udhëzon në rrugën e drejtë.”

Uroj që festimet e 800 vjetorit të jenë shkak për ta lexuar dhe kuptuar Mesnevinë e këtij njeriu të madh.



E rëndësishme është dashuria dhe zemërgjerësia

A. Yasin DEMIRCI

Aliu, i biri i Halifes Me'mun ishte një i ri që jetonte në një pallat me gjitha të mirat. Atij nuk i mungonte asgjë nga pasuria e dynjasë. Një ditë prej ditësh duke shikuar nga ballkoni i ra në sy një njeri, i cili punonte me shumë vullnet gjithë ditën nën rrezet e forta të diellit. Kur vinte koha e namazit shkante në breg të lumit merrte abdest, falte namazin dhe pastaj kthehej përsëri dhe vazhdonte punën. Djali i Halifes pasi e shikoi disa ditë këtë njeri në të njëjtën gjendje, një ditë e thirri. Ky njeri kishte një familje normale të përbërë nga: gruaja, dy motra, dhe nëna. Ditët i kalonte me agjërim dhe me atë që fitonte gjatë ditës, hapte agjërimin. Djaloshi kur e dëgjoi historinë e jetës së këtij njeriu e pyeti atë nëse ishte i lumtur apo jo me jetën që bënte dhe mori përgjigjen se ishte shumë i lumtur. Transmetohet se pas kësaj, ky djalë braktisi sarajin e të atit dhe gjithë pasurinë që zotëronte dhe vite më vonë tregohet se ishte gjendur i vdekur në një punishte marangozërie.

Kjo ndodhi më kujton ngjarjen e As'habul-Kehfit. Edhe ata jetonin në saraje, por nuk ndiheshin aspak mirë. Në brendësinë e tyre ndjenin ngushtim dhe shqetësim, sepse ata i kishte rrethuar kufri (mosbesimi). Për këtë arsye ata i braktisën sarajet e tyre dhe shkuan e u strehuan në një shpellë.

Siç e thotë edhe Allahu (xh.xh) në Kur'an: **"Derisa jeni izoluar prej tyre dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos Allahut, atëherë strehoni në shpellë, e Zoti juaj ju dhuron nga mëshira e Tij e gjerë dhe ju lehtëson në çështjen tuaj atë që është në dobinë tuaj"**. (Kehf,16)

Nga kjo kuptojmë se vende, të cilat duken të ngushta apo shqetësuese, me besim të pastër, dashuri e bindje të plotë, bëhen vende të gjera dhe gjithashtu bëhet e lehtë përballimi i sprovave të ndryshme që mund të ketë njeriu.

Ti, vëlla e motër me zemër të plagosur, këto sihariqe janë për ty:

Allahu xh.xh. disa njerëzve u merr pjesë të ndryshme të trupit si: syrin, dorën, këmbën etj. Ai njeri vuan nga mungesa e këtyre organeve, por për këtë do të shpërblehet nga Allahu xh.sh. nëse bën sabër (durim) për këtë.

Pejgamberi (a.s) jep sihariqe për ata që i kanë zemrat e plagosura, jep sihariqe shumë të bukura:

Kur njeriut i vdes fëmija, Allahu xh.sh. i thotë Melekëve:

- A ia morët shpirtin e fëmijës së robit tim?

Melekët përgjigjen:

- Po.

- A ia morët loçkën e zemrës?

- Po.

- Robi im çfarë tha?

- Ai duke të falenderuar Ty, tha: "Ne jemi të Allahut dhe tek ai do të kthehemi".

Atëherë Allahu xh.xh. tha:

- Përgatitni për robin tim një shtëpi në xhennet dhe vendosni emrin shtëpia e falenderimit.

Prandaj, besimtari duhet të bëjë durim sprovave të ndryshme dhe duhet të pajtohet me caktimin e Allahut (xh.sh)...Duhet ta dijë mirë se edhe pasuria edhe fëmijët janë amanete, të cilat një ditë do t'i kthehen.

La-tahzen / mos u brengos:

Një ushqim i mirë është lumturia e ditës.

Një shëtitje e mirë është lumturia e javës.

Një martesë e mirë është lumturia e muajit, ndërsa pasuria është lumturia e vitit.

La-tahzen / mos u brengos:

Vizito sa më shumë spitalet që t'ia dish më shumë vlerën shëndetit.

Vizito burgjet, që t'ia dish vlerën lirisë.

La-tahzen / mos u brengos:Një besimtar i mirë nuk brengoset për dynjanë, sepse ai e di se nuk është e përvetshme.

La-tahzen / mos u brengos:

Mendoje pak mëshirën e pafund të Allahut xh.xh. Ai i fal të gjitha gjynahet sado të mëdha që të jenë, mjafton pendimi i sinqertë.

Komentimi i sures Tekathur

Mr. Gëzim DUNGAJ

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

أَلْهَكُمُ التَّكَاثُرُ * حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ * كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ *

ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ * كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ * لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ *

ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ * ثُمَّ لَتَسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

“Juve ju mundoi përpjekja për shtimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)! Derisa të vizitoni varrezat (të bëheni banues të tyre - të vdisni). Jo, nuk është ashtu! Gjithsesi këtë do ta kuptoni më vonë! Përsëri jo, jeni gabim! Më vonë do ta kuptoni! Jo, pse, sikur ta dinit me një dije të sigurtë (nuk do të bënit ashtu). Ju patjetër do ta shihni Xhehennemin. Madje, atë do ta shihni të bindur plotësisht. Pastaj, në atë ditë, do të pyeteni për të mirat (e dynjasë).”¹

Jo pa qëllim zgjedha të bëj një shpjegim të shkurtër për këtë sure, sepse në kohën që po jetojmë ajo tregon shumë bukur dhe qartë një fakt të rëndësishëm të jetës sonë.

Kjo sure, e cila ndodhet në citatin e parë, ka zbritur në Mekke dhe emrin e ka marrë nga fjala “Tekathur” (shumim). Sipas disa mendimtarëve surja ka zbritur në lidhje me dy fise: Abdu Menaf dhe

bijtë e fisit Sehm, fise këto në grindje mes njëri-tjetrit. Ata mburreshin për njerëzit me pozitë të lartë që kishin në fisin e tyre, duke thënë:

- Fisi ynë është më i lartë se i juaji, ndërsa tjetri përgjigjej:

- Jo nuk është e vërtetë, ne jemi fis me më shumë njerëz dhe jemi me pozitë më të lartë se ju.

Pas këtij debati ata kishin rënë dakord të shkonin në varreza për të numëruar të vdekurit e tyre, ku u gjet se fisi i bijve të Sehmit ishte fis më i madh se ai i Abdu Menafit. Pas kësaj ndodhie zbriti kjo sure.

Një e dhënë tjetër në lidhje me shkakun e zbritjes së kësaj sureje na vjen nga Aliu -Zoti qoftë i kënaqur me të- i cili ka thënë: “Ne dyshonim në ndëshkimin e varrit, andaj zbriti kjo sure, duke na e bërë

të ditur se një ditë do të besonim këtë gjë.”²

Ibn Kethiri dy ajetet e para i komenton kështu: “Juve ju mundoi dashuria e dynjasë, bukuria dhe begatia e saj, në të njëjtën kohë ajo ju largoi nga të menduarit për botën tjetër, ahiretin, derisa ju erdhi vdekja, shkuat në varreza dhe u bëtë banorë të tyre.”³

Sipas disa mendimtarëve fjala “الهالك” që ndodhet në ajetin e parë do të thotë “harresë”.⁴ Atëherë kuptimi i citatit është: “pasuria, begatia e kësaj bote ju bëri që të harroni botën tjetër.” Me të vërtetë, siç dihet, kjo gjendje vazhdon të ekzistojë ende sot. Shohim se njerëzit janë zhytur aq thellë në botën materiale, ku kanë gjetur një strehë të gënjesh-

2 Suyuti, Esbabun-Nuzul Lubabun-Nukul, Bejrut: Shtëpia Botuese Daru Ihjau>l-Ulum, f. 234.

3 Ibn Kethiri, Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim, Bejrut: Shtëpia Botuese Daru'l-Fikir, 1981, Vëll. 4, f. 545,

4 Kurtubi, el-Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an, Kahire: Shtëpia Botuese Darush-Sha'b, 1953, Vëll. 20, f. 168.

tërt, saqë harrojnë se ajo do t'u shembet një ditë. Në këtë ditë këta njerëz, që u mbështetën vetëm në këtë strehë, do të mbeten pa të, madje ata nuk do të marrin me vete as edhe një rrobë të tyre të pëlqyer që e vishnin në këtë botë. Atë ditë secili prej nesh do të dalë përpara Allahut të Madhëruar me punët e tyre; qofshin ato të mëdha apo të vogla.

Hasan el-Basriu ka thënë: "O njeri, ty mos të të gënjejë malli dhe pasuria që të rrethon, sepse do të vdesësh vetëm, do të ringjallesh vetëm dhe para Allahut do të dalësh po vetëm, për të dhënë llogari për punët e tua të mira apo të këqija.⁵ Sipas Razit, Allahu i Madhëruar e përforcon këtë mendim duke thënë: "E kur të vijë ushtima (krisma e kiametit), atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet, prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet."⁶

"Dhe Ne e trashëgojmë atë (në pasurinë e fëmijë) që të thotë ai, e ai ka për të na ardhur i vetmuar."⁷

"Në të vërtetë ju na erdhët një nga një (të vetmuar), ashtu si ju krijuam së pari: keni lënë prapa shpinës atë që u patëm dhënë, e nuk po shohim se i keni me vete ndërmjetësuesit tuaj, të cilët i mendonit se për ju janë ndihmëtarë (i shoqëronit Allahut). S'ka dyshim, është këputur lidhja mes jush dhe mbaroi ajo çka mendonit (ndërmjetësues apo zotëra tjerë)."⁸

Fjala "علم اليقين" e cila ndodhet në citatin e pestë ka për kuptim besimin e plotë dhe të sinqertë në ekzistencën e shpërblimit dhe ndëshkimit në botën e ahiretit. Ai që beson në këto dy gjëra sinqerisht duke qenë i bindur, e kupton më mirë se sa e rrezikshme është të zhytesh thellë në botën materiale dhe të harrosh botën e pafundme, ahiretin. Kurse sipas disa mendimtarëve fjala "اليقين", e cila ndodhet në citatin e shtatë ka për qëllim "vdekjen" ose "ringjalljen".⁹ Meleqet do t'u tregojnë në kohën e vdekjes ose të ringjalljes xhehenemin mushrikëve apo kafirave. Atëherë, pasi ta shohin, do ta kuptojnë dhe besojnë se kanë qenë në rrugë të gabuar. Në fund Allahu i Madhëruar do t'i pyesë se si e fituan dhe si e harxhuan pasurinë. A e fituan duke i bërë Atij shirk apo duke ju bindur ligjeve të Tij?

A fituan dhe e harxhuan në rrugën e hallallit apo të harmit?

A e falënderuan Allahun për begatitë që u dha?

A e dhanë zekatin, a ndihmuan të vobektin dhe fukaranë? Do të pyeten për mënyrën se si janë argëtuar... etj. Pra, për çdo gjë do të pyetet njeriu...

Ebu Hurejre -Zoti i qoftë i kënaqur me të- tregon se i dërguari i Allahut një ditë, nga uria që kishte, doli për të gjetur ushqim, kur në rrugë takoi Ebu Bekrin dhe Omerin që njësoj kishin dalë për të njëjtën gjë. Pejgamberi bashkë me këta dy sahabë të nderuar

shkuan te një shtëpi e dikujt. Pasi këta mysafirë u pritën mirë nga i zoti i shtëpisë hëngrën dhe pinë, i dërguari i tha Ebu Berkit dhe Omerit:

«والذي نفسي بيده! لتسألن عن هذا النعيم يوم القيامة، أخرجكم من بيوتكم الجوع، ثم لم ترجعوا حتى أصابكم هذا النعيم»

Pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim, ju do të pyeteni ditën e kiametit për këtë begati. Juve ju nxori nga shtëpia uria dhe nuk u kthyet derisa ju kapi ajo (begatia).¹⁰

Ky hadith na tregon shumë qartë se njerëzit në përgjithësi do të pyeten për mirësitë që u ka dhënë Allahu i Madhëruar. Atëherë besimtarët nuk duhet të harrojnë ahiretin, duke u marrë me gjëra, të cilat janë kalimtare dhe të përkohshme. Besimtari nuk duhet të mburret me mall, pasuri, autoritet, bukuri, fëmijë, fis, popull, etj. Të gjithë njerëzit besimtarë e jobesimtarë, do të pyeten për çdo begati që u është dhënë, qoftë ajo e vogël apo e madhe, etj. Allahu na faltë për të metat tona dhe na bëftë prej njerëzve modestë që punojnë për këtë botë si edhe për botën tjetër, ahiretin. Amin!

5 Razi, Mefatihul-Gajb, Bejrut: Shtëpia Botuse Darul-Kutubi'l-Ilmijje, 2000, Vell. 32, f. 75.

6 Kur'an, Abese, 80: 33-37.

7 Kur'an, Merjem, 19: 80.

8 Kur'an, En'am, 6: 94.

9 Kurtubi, el-Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an, Kahire: Shtëpia Botuse Darush-Sha'b, 1953, Vell. 20, f. 173

10 Vehbe Zuhajli, Tefsiru'l-Munir, (Përktheu në turq. Hamdi Arslan dhe të tjerë) Shtëpia Botuse Risale, Vell. 15, f. 614-617.

E pamposhtura Havva binti Zejd

Elvira PUKA

E lindur në Medinë, bijë e Zejd ibni Seker el-Evsi ve Akreb binti Muadh, motër e Rafi ibni Jezid dhe nëna e Thabitit, ra shehid në luftën e Bedrit

Duke mos u mposhtur nga mundimet që i jepte bashkëshorti i saj idhujtar, vazhdoi të jetonte gjithnjë pa u ndarë nga rruga e Pejgamberit (s.a.v).

Havva binti Zeyd nga fisi i Ensarëve u përgëzua me Islam para Hixhretit, duke mos u dekurajuar asnjëherë nga pengesat, nuk iu zbeh emri si **muḥahidine**.

Kjo grua e madhe, me shumë durim, nuk u lëkund nga betimi që kishte bërë para Simbolit të Besnikërisë (s.a.v), duke i bërë ballë çdo vuajtjeje.

Thirrja Islame u shoqërua me mundime...

A mos vallë hapat e parë në Islam do ndiqeshin gjithnjë nga vuajtjet?!

Idhujtarët për t'i bërë pengesë përparimit shpirtëror të muslimanëve, thurën kurthe, që mendja njerëzore i konsideron abstrakte.

Edhe Havva (r.a) do përballej me mundimet që i jepte bashkëshorti Kajs ibni Adij, me të cilin ishte martuar përpara se t'u shpallte Islami.

Pavarësisht se Kajs i ftonte gjithnjë në adhurimin e idhujve, në sytë e Havvasë (r.a) nuk shuhej asnjë çast feneri që e udhëzonte Islami. Në zemrën e saj mbizotëronte dashuria ndaj Allahut dhe Pejgamberit, dashuri e cila i jepte forcë për të mos u mposhtur përballë vuajtjeve.

Pejgamberi (s.a.v) shumë i mërzitur nga gjendja e Havvasë (r.a) mendonte gjithnjë se si ta shpëtonte atë nga këto sakrificat.

Ishin ditët e para të Islamit... i Dërguari i Allahut merrte pjesë në panairët e organizuara në Mekkë me shpresën për të ftuar në Islam fiset e ardhura.

Kështu, një herë ndodhi që Pejgamberi i mëshirës të takohej me Kajsin, në panairin Dhul-Mexhaz. Me dëshirën që edhe ai si bashkëshortja e tij Havva, të ndriçohej me dritën e Islamit, filloi ta ftonte në rrugën e drejtë, por Kajs me kokëfortësinë e idhujtarit duke refuzuar thirrjen e të Dërguarit të Allahut (s.a.v) u mundua të justifikonte veten: "Me të vërtetë feja në të cilën po më fton është e bukur, por përgatitjet për luftë

dhe preokupimet ndaj saj, nuk më japin mundësinë të bëhem pjesë e juaja."

Pejgamberi (s.a.s) duke e nxitur për të pranuar Islamin me fjalët: "Ej Eba Jezid! Po të thërras në rrugën e Allahut!"

Në zemrën e Kajsit u ndez një shkëndijë dashurie ndaj Pejgamberit, por duke shprehur të njëjtin justifikim, nuk pati fatin të zbukurohej me nurin Islam.

I Dërguari i Allahut i zhgënjyer nga refuzimi i Kajsit, kujtoi gjendjen e vështirë të Havva binti Zejdit dhe iu drejtua:

"Me sa kam dëgjuar, gruan e nxitke të braktisë fenë Islame. Frikësoju Allahut dhe më jep fjalën se do të bësh kthesë!"

Kajs i ndikuar nga këto fjalë të ëmbla, u betua se nuk do të vepronte më si më parë.

Sapo Kajs i kthye në Medinë, sjelljet e tij ndaj bashkëshortes, Havvasë ndryshuan rrënjësisht. Ndryshe nga herët e tjera nisi të sillej njerëzishëm dhe Havvasë iu drejtua duke i thënë:

"Në Mekkë u takova me Udhëzuesin tënd (s.a.v). I dhashë fjalën se nuk do të të çenoi më të drejtën tënde. Do të jesh e lirë për të jetuar fenë Islame."

Tashmë Havva (r.a) do të shijonte e lirë bukuritë e Islamit.

Kajs me të vërtetë po e mbante fjalën e dhënë. Mushrikët duke parë këtë ndryshim rrënjësor të Kajsit, iu drejtuan:

"Ej Eba Jezid! Gruaja jote po ndjek rrugën e Muhammedit!",

Kajs iu përgjigjet:

"Unë i kam dhënë fjalën Muhammedit se do të respektoj të drejtat e saj."

Allahu e kishte shpërblyer durimin e Havvasë duke i dhënë mundësinë ta jetonte e lirë fenë e saj.

Ajo u bë shembulli i parimit:

"Pas çdo vështirësie ka një lehtësim!"

Le të shpresojmë dhe të dëshirojmë shumë që secili nga ne të marrë mësim nga përpjekjet e Havvasë (r.a).

Allahu qoftë i kënaqur prej saj...AMIN!

MEDRESEJA E MADHE E GJAKOVËS NË 300 VJETORIN E SAJ

Pleurat ef. Krasniqi



Medreseja (nga arab. vendi ku mësohet dija) zë një vend të rëndësishëm në kulturën shpirtërore dhe materiale të myslimanëve.

Qysh nga "Medreseja e parë"- shtëpia e sahabiut Zejd bin Erkamit e deri më sot, këto institucione arsimore fetare shënuan gjithnjë një rritje dhe shtrirje të gjerë hapsinore - kohore në drejtim të përmbushjes së nevojave të besimtarëve për dituri dhe emancipim. Kështu, pothuajse nuk ekziston asnjë zonë urbane që të mos e ketë së paku një medrese e të mos flasim për mektebe (institucione të ulta arsimore).

Në trevat tona njihen Medresetë e Shkupit, Shkodrës, Prizerenit, Tiranës, Gjakovës, Beratit, Gjirokastrës, etj.

Medresja e Madhe e Gjakovës.

Sivjet mbushen 300 vjet nga themelimi i Medresesë së Madhe të Gjakovës, e cila njihet ndryshe edhe me emrin e burrit të madh Murat Begut, sipas asaj që ishte themelues i po kësaj medreseje, por më vonë në Gjakovë u themelua edhe një medrese tjetër nga Evliau i madh Tahir effendi Gjakova, që ishte më e vogël, prandaj njëra medrese quhej e madhe, ndërsa tjetra e vogël,

por të dyja ishin institucione të larta arsimore.

Sipas orientalistit Nehat Krasniqi gjithnjë i bazuar në silsilnamen e ruajtur, figuron se Murat Begu, i biri i Adem Pashës mytesarrif i Sanxhikut të Ohrit, Elbasanit, e së fundmi edhe i Shkodrës, ishte një bamirës tejet i madh. Po sipas këtij dokumenti me vlerë historike del se, Murat Begu ndërtoi edhe disa objekte të tjera sakrale dhe profane.

Murat Begu ishte një mecen i artit dhe i kulturës dhe gjithnjë mblidhte pranë vetes intelektualë dhe poetë p.sh.: në dorëshkrimin më të vjetër të gjetur në Kosovë, të vitit 1347, që ruhet në arkhivin e Bibliotekës Kombëtare në Prishtinë, figuron emri në myhyrin e Murat Begut dhe shkrimi i tij si dëshmi e dhurimit të këtij libri myderizit të parë të Medresesë së Madhe Uvejs efendiut. Medresja e madhe u ngrit rrëzë kodrës legjendare të Çabratit, jo larg Xhamisë së Hadumit. Sipas arkitekturës ishte e ngjashme me medresetë e tjera të Ballkanit, ishte e tipit të mbyllur me mure dhe përbëhej nga Dersehanet (Klasat), Mesxhidi (faltorja), Konvikti, Kitabhane (Biblioteka), dhe Shatërvani (Fontana).

Historikisht kishte kuadër myderrizësh të njohur si psh.: Vejsel efendiun, Ali Fikri Jakovën, Ali efendiun, Iljas efendiun, Hasan Hysni Shllakun, Fahri efendiun etj.

Studimet në Medresenë e madhe zgjasnin prej 8-12 vjet. Me rastin e përfundimit të studimeve lëshohej Ixhazetnameja (Diploma). Këtu studionin studentë nga i gjithë rajoni edhe më gjerë. Sipas Myderrizit të njohur të Kosovës Hafiz Muhamed Gashit, i diplomuar në Medresenë e Madhe, planprogrami i kësaj Medreseje ishte kështu:

LEXIMI I KUR'ANIT

Në Medresenë e madhe bëhej specializimi i leximit të Kur'anit. Hifzi apo thënë ndryshe, memorizimi i Kur'anit nuk ishte i detyrueshëm, por rëndom mësohej vullnetarisht.

TEFSIRI (Komentimi i Kur'anit)

Librat bazë të kësaj shkençe Kur'anore ishin:

"Tefsiri Xhelalejn bi sherhi Xhemelejn", "Tefsiri Kuran el 'Adhim" nga Kadi Bejdaviu.

HADITH (Transmetimet nga i Dërguari Muhamed a.s.), mësohej nga "Fet'h el Bari" i Hafidh Ibn El-Haxherit.

FIK'HU (Prakikat e adhurimeve në Islam) bëhej sipas medhhebit dominues në ishperandorinë Osmane. Librat kryesorë ishin këto: "Reddul Muhtar" nga Ibni Abidini, "Fet'hul Kadir" dhe "Mexhme'ul Ebhur" nga Shejh Zade Damad efendi dhe "Multeka Ebhur" nga Muhamed Halebiu.

'AKAID (Shkenca rreth besimit Islam) MA'TURIDI. "Akidetu et- Tahavie" –Sherh Taftazani, Umeri Nesefij.

Mësoheshin edhe gjuhët kryesore orientale si: arabishtja, osmanishtja, persishtja, gjithashtu mësohej edhe filozofi, logjikë, histori, matematikë, gjeografi, astronomi etj.

Kuadri i cili formohej në këtë Medrese me rastin e përfundimit të saj angazhoheshin në detyrat për Imam, Myderriz, Kadi (Gjyqtar sheriat), Administratë etj., ndërsa të tje-



rët, që vazhdonin specializimet kryesisht në Stamboll apo Kajro rekomandoheshin të ndaleshin aty si p.sh.: Ali efendi, profesor në Universitetin e Stambollit, Tahir efendi Lluka po ashtu profesor Hasan efendi Shllaku kadi në Stamboll.

Puna në këtë medrese zgjati pandërprerë për afro 250 vjet deri me mbylljen e saj të dhunshme nga pushteti ish-komunist në fund të vitit 1948. Në këtë kohë në krye ishte myderrizi i njohur Fahri efendi, i cili edhe për disa kohë vazhdoi ilegalisht.

MEDRESJA E MADHE SOT

Ashtu siç mbin lulja në pranverë, pas stinës së dimrit

u rindërtua edhe Medreseja e Madhe. Dhurimet nga vëllezërit e Katarit, angazhimi i personelit të Bashkësisë Islame bënë që Medresja përsëri të marrë frymë. Formën e vet të duhur kësaj Medreseje ia dhanë Vëllezërit e Shoqatës me renome botërore Istanbul nga Turqia, të cilët me përvojën e tyre disa dekadëshe në përkrahjen e arsimit fetar, posaçërisht në Shqipëri me medresët në Shkodër e Gjirokastrë, në bashkëpunimin me kuadrot vendore gradualisht po mundohen gjithnjë e më tepër t'ia kthejnë namën e dikurshëm kësaj Medreseje.

Bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës me shoqatën Ndërkombëtare Humanitare dhe Kulturore "Istanbul", ka bërë që Medreseja e Madhe në Gjakovë të nisë rrugëtimin e saj të dikurshëm me nostalgji dhe me vështirësitë e saj. Në këtë medrese tashmë, sivjet pritet të bëhet edhe regjistrimi i brezit të tretë pranë kësaj medreseje, për "Hifz", për aftësimin në memorizimin e Kur'anit përmendësh. Gjithashtu, kjo Medrese funksionon njëlloj me planprogramin e Medresesë së mesme "Alauddin" në Prishtinë me degët e saja në Prizren dhe në Gjiilan.

Në medrese mësohen të gjitha lëndët, të cilat janë në planprogramin e Medresesë "ALAUDDIN" në Prishtinë, në varësi të së cilës funksionon edhe Medreseja e Madhe në Gjakovë. Shkollimi zgjat katër vjet dhe është falas. Gjatë këtyre katër viteve mësohet

Kur'ani përmendësh dhe në fund nxënësi merr diplomë për "Hafiz". Paralelisht me këtë, secili nxënës mund të marrë edhe diplomë në Medresenë "ALAUDDIN", duke dhënë provimet me korespondencë në Prishtinë ose në Prizren. Diploma njihet dhe pranohet në të gjitha qendrat universitare të botës. Kështu pra nxënësi mbaron medresenë dhe merr dy diploma.

Gjithashtu për dhënien e provimeve me korespondencë, nxënësve u është

lehtësuar dëgjimi i ligjëratave gjatë tërë vitit në mënyrë që të mos hasin në vështirësi gjatë provimeve. Të gjitha shpenzimet për provimet në Prishtinë dhe për Prizren i përballon Medreseja, e financuar nga Shoqata "ISTANBUL".

Personeli edukativo-arsimor është i kualifikuar me arsim të lartë dhe superiorë në qendra të ndryshme universitare. Në brendi të shkollës funksionon edhe konvikti me të gjitha shërbimet që u nevojiten nxënësve FALAS.

Ndërsa ajo që është mjaft premtuese nga kjo Medrese dhe të cilën jemi duke e pritur me padurim është se sivjet pritet të dalin edhe Hafizat e parë të Medresesë së Madhe nën mbikqyrjen e drejtuesit të Medresesë zotëri Hafiz Idris Keskin dhe Kryetari i KBI Z.Fatmir ef.Iljazi. Medresja e Madhe historike ka filluar të ecë hapave të lavdisë dhe tani vazhdon ta fitojë famën dhe madhështinë e saj shekullore me ndihmën e Allahut të Gjithdijshëm dhe Fuqiptotë.

Mësimdhënës pranë Medresesë së Madhe Gjakovë

APLIKIMI KUSHTET :

- 1 Kandidati duhet të ketë kryer klasën e 9-të të shkollës fillore,
- 2 Të mos jetë më i ri se 15 vjeç dhe më i vjetër se 16 vjeç,
- 3 Të jetë i shëndoshë fizikisht dhe psikikisht.

Dokumentacioni:

1. Dëftesa e shkollës fillore,
2. Çertifikata e lindjes,
3. Çertifikata e mjekut,
4. Deklarata e prindit apo kujdestarit për përgjegjësi morale dhe materiale,
5. Propozim-referenca nga KBI- së së vendit ku jeton.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e duhur duhet të dorëzohen në Medresenë e Madhe në Gjakovë, Rr. "Tahir Efendia" nr.41 në lagjen e Hadumit ose pranë zyrave të KBI-së Gjakovë,

Rr. "Ismail Qemali" nr.109 në Xhaminë e Hadumit.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është prej dt. 01 Qershor deri më 25 Gusht 2007.

Aplikimet, të cilat vijnë pas këtij afati dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

Për infomacion më të hollësishëm mund të kontaktoni në numrat e telefonit, si në vijim:

Zyra e KBI-së Gjakovë, tel.039/ 21 590 dhe mob. 044 / 336 799, ose 044 / 684 829

Adresa :

Medreseja e Madhe në Gjakovë, Rr. "Tahir Efendia" nr.41 në lagjen e Hadumit ose pranë zyrave të KBI-së Gjakovë.

Rr. "Ismail Qemali" nr.109 në Xhaminë e Hadumit.

Shëndeti & Familja

Naim DRIJAJ

Pirja e lëngjeve të frutave në vend të ujit shndërrohet në yndyrë

Pirja e tepruar e koka-kolës dhe e lëngjeve të frutave në trupin e njeriut shkakton energji negative dhe i hap rrugë yndyrës. Sipas ekspertit të të ushqyerit dhe të dietës Shengyl Sangu Talak, një person brënda ditës për një shëndet të mirë duhet që të pijë 1,5 - 2 litra ujë. Shumica e atyre që dëshirojnë të dobësohen, në vend të ujit në ditë pinë 1,5 litra kola ose lëngje frutash. Për një trup të shëndoshë pirja e ujit ka një rëndësi shumë të veçantë. Megjithatë, shumë prej njerëzve më qëllim për tu dobsuar pinë ujë shumë pak. Mospirja e ujit dhe gabimet në të ushqyer shkaktojnë prishjen e ekulibrit të metabolizmit gjë që rezulton në shtimin e tepruar të yndyrës në trupin e njeriut.

Për një trup të shëndoshë, njeriu duhet të ushqehet në kohë të caktuara, njëkohësisht gjatë ditës duhet të pijë 1,5-2 litra ujë



dhe duhet të bëjë lëvizje sa më të shpeshta si ecja, ushtrime etj. Më lënjën e kilove të tepërta ulet shpejtësia e metabolizmit. Mos bërja e ushtrimeve hap rrugë për humbjen e muskujve.

Kripa e tepërt shkakton kancer



Sipas një studimi të bërë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Universitetin Marzyand, thuhet se përdorimi i tepërt i kripës bëhet shkak për përbërjen e ulçerës. Eshtë zbuluar se bakteri i quajtur helicobacter pylori i cili dihet se shkakton ulçerën në stomak shumëohet në ambientet me përqindje të madhe kripe. Gjithashtu në këtë studim është vërtetuar se përhapja e bakterit në fjalë shton rrezikun e kancerit në stomak. Ekspertët i këshillojnë të sëmuret me ulçer që t'u rrinë larg ushqimeve të kriposura.

Doktorët Amerikan i besojnë forcës së besimit



Sipas një studimi që është bërë në Amerikë në universitetin Çikago nga 4 mjekë 3 prej tyre i besojnë një feje dhe një fuqie natyrore në kurimin e të sëmurëve dhe mendojnë që kjo gjë ka një ndikim pozitiv. Mjekët kanë pohuar që besimi ndihmon për kurimin e sëmundjeve dhe u jep shpresë më shumë të sëmurëve. Sipas studimit rezulton që nga 5 doktorët dy prej tyre janë të mendimit që rënia e infarktut dhe sëmundjeve vdekjeprurëse parandalon çuarjen në përfundim të keq.

Shumica e mjekëve besojnë që në ndërhyrjet mjekësore shërimi vjen nga ana e Zotit xh.sh. Disa mjekë tregojnë që disa të sëmurë edhe pa ndihmën e ilaçeve janë

përmirësuar. Në këtë studim mjekët kanë pohuar që besimi dhe lutjet luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Në të njëjtin studim njëri nga tre mjekët bënë të qartë se të sëmurët që i lidhin shpresat e tyre pas forcave të mbinatyrshme mund ta refuzojnë kurën dhe mos ta pranojnë injektimin e ilaçeve. 45 % e mjekëve kanë pohuar që feja dhe fuqia e mbinatyrshme mund të bëhet shkak për ndjenjat negative dhe të sëmurit mund t'ia rrisin mërzinë.

Shumica e mjekëve besimin e pranojnë si ndikim pozitiv

- Në përgjithësi, 85% e mjekëve besimin dhe fuqinë mbinatyrore e besojnë si ndikim pozitiv
- 54% e mjekëve besojnë së në shërimin e të sëmurëve besimi në fuqinë mbinatyrore ka ndikim pozitiv.
- 76% e mjekëve mendojnë që besimi në Allahun xh.sh. u forcon moralin të sëmurëve dhe ndikon në lehtësimin e sëmundjeve.
- 74% e mjekëve mendojnë që besimi në Zotin xh.sh. për të sëmurët është shpresë shëruese.

Shkrimet Otomane



و انما كان الله في السماء
لا في الارض ولا في الماء
و انما كان الله في السماء
لا في الارض ولا في الماء
و انما كان الله في السماء
لا في الارض ولا في الماء

المعلم
عبد الله بن محمد
هذا الكتاب
هو من كتب
الشيخ
المعلم
عبد الله بن محمد
في سنة
السنه
السنه

Ermal Nurja *

Po të mbështetemi në llojet e shkrimeve që janë konstatuar deri tani në mesin e dokumenteve dhe regjistrave që gjenden në arkivin ottoman të Stambollit, në të cilin ruhet edhe numri më i madh i dokumenteve që sipas burimeve të kësaj arkive zënë shifrën prej 100 milion dokumentësh, përkrah numrit të madh të regjistrave që ruhen në këtë arkiv, atëherë

mund të themi se ekzistojnë rreth 19 lloj shkrimesh të cilat mund të grupohen në 5 lloje kryesore të shkrimeve.

Për nga leksiku osmanishtja paraqet një përzjerje të gjuhës arabe, perse, turqishtes së vjetër me dialektet e saj. Pas periudhës së Tanzimatit shohim që në gjuhën otomane zënë të hyjnë edhe shumë fjalë nga gjuha franceze,

por ndikimi i tyre në osmanishtë që tepër i kufizuar për shkak të shtrirjes së pakët që kishin.

Turqishtja e vjetër përbën lidhjen e materialit kryesor të gjuhës otomane, i cili është i mbështetur në ndikimin e gjuhëve arabe dhe perse. Por edhe këto të dyja nuk i hasim njësoj në të gjitha fushat e shkrimeve. Ndërsa persishten e ndeshim me teprim

në letërsinë klasike osmane dhe shkrimet letrare të periudhës së Tanzimatit, arabishten e shohim të përdoret mjaft në dokumentacionin zyrtar, nisur edhe nga fakti që e drejta e perandorisë bazohej pjesërisht mbi të drejtën islame (shariat) dhe kështu përdorte në masë terminologjinë arabe të të drejtës me të gjithë nëndegët e saj. Një përdorim të përafërt të këtyre dy gjuhëve, arabishtes dhe persishtes, shohim në letërsinë historike që nga fillimet e saj deri në veprat më të fundit të historisë turko-otomane.

Megjithë nevojën për t'u konfirmuar në bazën e të dhënave dhe studimeve të mëtejshme në literaturën islame dhe atë orientale është shprehur përherë mendimi se moszhvillimi i arteve figurative në botën islame do ta orientonte shpirtin artistik të kësaj bashkësie të madhe fetare që të zhvillonte modele të shumëllojshme të kaligrafisë.

Shkrimet kryesore janë:

1- Sulus

Në mesin e dokumenteve të shkruara me këtë shkrim në arkhivin ottoman numri është shumë i pakët. Arsytet janë vështirësia e shkrimit nga ana e artit dhe përdorimi i tij drejtuar personave në poste të vecanta dhe të caktuara. Megjithëse nuk haset së tepërmi në shkrimet arkivore për shkak të vështirësisë së shkrimit të tij me shpejtësi, shembuj mjaft të hijshëm të këtij shkrimi i hasim nëpër biblioteka, muze dhe faltoret të ndryshme nëpër Turqi. Megjithatë bie në sy dallimi i madh midis llojeve të hershme dhe atyre më të zhvilluara të shkrimit sulus. Emërtimi më i mëparshëm i këtij shkrimi është pena sulus (sulus kalemi), që na ndihmon të kuptojmë se origjina e këtij shkrimi ka të bëjë me

trajtën që i jepej lapsit. Sulus do të thotë 1/3. Sipas kësaj gërma e fjalëve të shkruara me shkrimin sulus formohen me tre lëvizje dhe duke mbajtur një lakim prej një të trete. Më pas shkrimi Nesih paraqet një përvijim të ri në këtë stil shkrimi.

2- Divan

Ky shkrim sipas traditës është krijuar pas pushtimit të Kostantinopojës nga Sulltan Fatih Mehmeti për të regjistruar vendimet administrative të perandorisë. Në gjendjen e sotme të dokumentacionit arkivor divani është përdorur në shkrimet shtetërore ku është marrë parasysh fakti që në tekstele njëherë të hartuara të mos lejohej mundësia e ndërhyrjes dhe deformimit të gërmave sic ishin fermanet dhe beratet e sulltanëve. Në periudhat në vijim e shohim të jetë përdorur edhe në disa akte të tjera juridike sic janë huxhetet, vakfijet dhe ilamet. Nga tre llojet e Divanit (xheli, kirma dhe ince) një vend të rëndësishëm zë divani xheli për faktin se me këtë lloj shkrimi shohim të jenë gdhendur mbishkrimet mbi objektet e kultit islamo-turk siç janë xhamitë, mesxhidet, teqet, tyrbet, urat e gurta, kervansarajet, medresetë, hamamet etj. Shkronjat në divanin xheli në të shumtën e rasteve janë të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe të shkruara në një apo dy rreshta. Në shkrimin divan mungojnë me përjashtim të një apo dy të tillave të gjithë shenjat sinkretike.

3- Talik

Ky shkrim ndryshe është quajtur edhe shkrimi i ulema-ve pasi të gjitha aktet fetare në mënyrë të veçantë fetvatë janë shkruar me këtë lloj shkrimi. Në një gjuhë të rëndomtë shkrimi talik është përngjasur edhe me rro-

bat e varura të cilat kapen në të dy anët e tyre për t'u tharë pasi që edhe në shkrimin talik fjala duket sikur është varur në dy cepet e saja për tu lakuar në mes.

4- Rika

Ky shkrim është përdorur gjerësisht në dokumentacionin administrativ otoman pas shpalljes së Periudhës së Tanzimatit. Shquhet për një shkrim të lehtë e cila lejon një deformim të shkri-meve, lidhje mes tyre nëpërmjet lakimeve të gërmave që në fakt në alfabetin arab shkruhen më vete.

5- Sijakat

Ky shkrim paraqet pjesën më të madhe të dokumentave të shkruara që gjenden në arkhivin otoman. Arsyeja është mëse e kuptueshme. Shkrimi sijakat është përdorur më së shumti në dokumentat e natyrës ekonomike dhe regjistrat e tyre. Arsyeja që ky shkrim është ndër më të vështirët ka të bëjë edhe me faktin që regjistrat e ekonomisë nuk duheshin kuptuar aq thjesht po të binin në duart e njerëzve të thjeshtë apo të armikut. Nga ana tjetër fakti që të ardhurat ekonomike përbënin burimet kryesore me të cilat mbahej shteti dhe individit në perandori është e kuptueshme fakti se përse pjesa më e madhe e dokumenteve dhe regjistrave arkivore janë të shkruar me këtë shkrim. Për nga lloji me këtë shkrim janë shkruar regjistrat dhe dokumentat e financës, tapitë dhe regjistrat e vakfeve. Këtu jo vetëm që nuk shënohen shenjat sinkretike, por shkronjat janë deformuar jashtëzakonisht shumë dhe u mungojnë edhe pikat në të shumtën e rasteve.

* Student Magjistrature Universiteti Marmara Dega Histori Islame

Aktualitet i Menduar

Arjan Ymeraj



Pas pohimeve të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë turke Yaşar Büyükanıt se “Po të më pyesni mua si ushtarak në duhet të hyjmë në Irak, u përgjigjem po. Po të më pyesni a ia vlen, unë u them po, ia vlen” dhe deklarates së tij disa ditë më pas se: “Qeveria duhet të na dorëzojë me shkrim se çfarë duhet që të bëjmë ne si ushtri po qe se ndërhyjmë ushtarakisht në Irak, të merremi vetëm me PKK-në apo kemi për të bërë ndonjë gjë edhe me Barzanin” i gjithë opinioni ndërkombëtar me në krye politikën amerikane nuk vonoi asnjë

çast që t’i bëjë të qartë Turqisë se ndërhyrja ushtarake në Irak nuk do të qe në të mirë të saj. Ngjarjet e Qipros pa dyshim që i kanë dhënë një mësim të mirë atasheve ushtarakë të akredituar dhe qeverive se Turqia nuk toleron asnjë situatë që do të përbëjë kërcënim për të, prandaj është mëse e natyrshme pësjtjellimi që shkaktojë në mendjet e tyre deklaratat e numrit 1 të ushtrisë turke.

Nga ana tjetër, pas bllokimit të zgjedhjes presidenciale në Turqi, gjë që e shpuri vendin drejt zgjedhjes së parakohshme, duket se qëndrimet e forcave politike në Turqi nuk janë të njëjta. Ndërsa partia në pushtet, AKP-ja, me kryeministrin e saj Tajip Erdogan, po përpiket që të mbajë situatën nën qetësi deri në realizimin e zgjedhjeve parlamentare të 22 korrikut. Në mënyrë të veçantë pas takimit shumëpalësh në Ankara qeveria edhe njëherë pohoi se do t’i jepte më shumë gaz luftës me militantët e armatosur të PKK-së brenda

Turqisë, sesa ata që ndodhen përjashta saj.

Nga ana tjetër, njëri nga dy liderët kryesorë kurdë në Irak, Barzani duket se ka marrë përsipër që të jetë zëdhënësi i vendimit të popullsisë kurde në Irak për të refuzuar konfederatën dhe për ta çuar Kerkukun drejt referendumit, i cili në rast se realizohet dihet shumë mirë se do të krijojë një zonë të pavarur brenda vetë Irakut. Kontradiktore dhe shumë tendencioze duken edhe qëndrimet e dy udhëheqësve kurdë, të cilët ndërsa në një anë pohojnë se janë gati t’i kundërpërgjigjen qoftë edhe me armë Turqisë duke shitur kështu trimëri para mediave botërore, shprehen se nuk mundën të përzihen me punët e PKK-së brenda Irakut dhe se nuk duan të hyjnë në konflikt me këtë organizatë terroriste.

Ajo që i mungon opinionit ndërkombëtar dhe që nuk dihet përjashta Turqisë, është fakti se si rezultat i minave që






vendosen anës rrugëve nëpër Turqinë Lindore, gati nuk ka ditë që Turqia të mos humbasë një nga bijtë e saj në ushtri. Madje aktet terroriste goditën edhe brenda në zemët të Ankarasë duke shkaktuar 8 vdekur dhe shumë të plagosur. Pikërisht kjo situatë duket se ndikon në animin e turqve ndaj partive opozitare që shprehen haptazi për një ndërhyrje ushtarake në Irak. Në mënyrë të veçantë anketat parashikojnë hyrjen në parlamentet pas zgjedhjeve të 22 korrikut edhe të partisë së nacionalistëve turq, MHP-ja, e cila duket se po fiton popullaritet përherë e më shumë në Anadoll. Se çfarë parlamenti do të krijohet pas zgjedhjeve të 22 korrikut përbën temën më të nxehtë të analizave brenda dhe jashtë Turqisë. Ndërsa shumëkush mendon se sërish partia në pushtet AKP-ja do të kryesojë në zgjedhje, gati-gati të gjithë analistët e shohin të pamundur mundësinë që ajo të marrë një numër të madh



vendesh në parlament, sepse këtë radhë përveç partisë opozitare CHP-së, të paktën edhe dy parti të tjera mund të kalojnë kufirin 10% të zgjedhjeve, pa llogaritur edhe deputetët e pavarur dhe shanset e tyre për të fituar. Ndërsa një koalicion qeveritar konsiderohet konfigurimi i afërm që do të marrë qeveria turke, ditaditës trupa të shumta ushtarake dislokohen në kufirin me Irakun, duke e rritur përherë e më shumë mundësinë e një ndërhyrjeje ushtarake, që do të sillte shumë të reja në historinë politike të rajonit më të nxehtë të konfliktit, lindjes së Mesme.

Evropa 24 orë në muaj «online»



Me shumë se 122 milion evropianë që i përkasin moshës 15 vjeç e sipër, janë përdorues të rregullt të internetit si në shtëpi, shkolla, vende pune etj. Sipas raportit të dhënë nga Kompania "ComScore" e cila jep informacione në lidhje me internetin

global pohon se evropianët 16.5 ditë të muajit hyjnë në internet dhe se gjatë orëve të ditës përdorin deri në 2662 web site. Sipas raportit në fjalë, thuhet se hollandezët hyjnë më shumë në internet se shtetet e tjera evropiane në mbi 83 %, kurse rusët janë përdoruesit më të pakët të tij me 11%.

Nga anketa e bërë në gjashtëmbëdhjetë shtetet evropiane rezulton se rreth 221 milion njerëz hyjnë në internet çdo muaj dhe se Gjermania përbën numrin më të madh të popullsisë që e përdor atë me 32.5%.

Gjithashtu, sipas këtij raporti, thuhet se 70% e moshës 15 vjeçare e më sipër janë përdorues të tij nga Norvegjia dhe Danimarka, 65% nga Finlanda dhe më pas 62% vjen Anglia.

ComScore thotë që në Shtetet e Bashkuara të Amerikës numri i përdoruesve të internetit është afro 156 milion njerëz, kurse 121 milion e tyre hyjnë për çdo ditë.

Gatimi i ushqimeve me energji diellore



Qendra e kërkimeve të Universitetit Haxhetepe ka zhvilluar një program për gatimin e ushqimeve duke përdorur energjinë diellore. Këtë ide e kanë hedhur në pah studentët e këtij universiteti dhe e kanë marrë përsipër realizimin e kësaj gjëje.

Prof. Dr. Demir Inal ka për qëllim që me energjinë diellore t'u bëjë të mundur njerëzve t'i përgatisin ushqimet duke mos përdorur zjarrin e druve. Profesori është i mendimit se me realizimin e këtij projekti grave dhe atyre që përgatisin ushqimet do t'ua lehtësojë

punët e tyre. Ky sistem i energjisë diellore është në përputhje me parimet e vendosura nga UNESCO. Profesori thekson gjithashtu se ky sistem i mbron njerëzit nga helmimi prej tymërave dhe nga konsumimi i gazit natyror. Sipas profesorit.

Kabllo dhe prizat elektrike do të mbesin në histori

Ekspertët e Institutit teknik të Masaçusetsit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë prodhuar një mjet elektrik që bën të mundur përcjelljen e energjisë elektrike nga kabina elektrike pa përdorimin e kabllave.

Në sajë të këtij studimi ekspertët kanë bërë të mundur që të ndriçojnë një llampë 60 Wat pa ndihmen e kabllave në largësi dy metër nga burimi energjistik. Studiuesit janë të mendimit se me anë të valëve elektromagnetike mund të bëhet transferimi i energjisë elektrike nga largësia tre metër. Shkencëtarët mendojnë se në të ardhmen largësia e përhapjes së valëve elektromagnetike do rritet më shumë.


Dalja e baterive nga përdorimi

Ekspertët e WiTricity-së theksojnë që me zhdukjen e kabllave dhe prizave nga përdorimi, do t'u bije vlera edhe baterive të telefonëve celularë dhe kompjutrave. Dr. Marin Soljacic ka zhvilluar një projekt edhe për ata të cilët vazhdimisht harrojnë



që t'i karikojnë bateritë e celularëve, ku me anë të këtyre valëve elektromagnetike do të kenë mundësi të marrin pa ndonjë problem ata. Por disa shkencëtarë të tjerë pohojnë që kjo metodë mund t'i hapë rrugë sëmundjes së kancerit, dhe nëse përdoret shpesh kjo gjë rrezikon edhe sëmundje më të mëdha në shëndetin e njeriut.

Anijet do të lundrojnë me energji diellore



TUBITAK ka zhvilluar shumë projekte me qëllim që njerëzve t'ua lehtësojë sa më shumë jetën e tyre. Kësaj radhe ai ka vendosur që të bëjë anijen e parë që lundron me anë të energjisë diellore. Profesor Rashit Gyrdëlik i cili pohon se projekti do të zbatohet veçanërisht me të rinjtë thotë se: "Jemi duke u marrë me konceptin e një anijeje me gjatësi 20 metra. Detyra kryesore që projekti të realizohet nuk ka dyshim se do t'u bjerë përsipër studentëve të degëve projektimi anijesh, elektrike elektronike, kimi, materiale, inxhinierisë së lëndëve, inxhinierisë fizike dhe studiuesve të këtyre fushave.